



KOMUNA E OBILIQIT



INSTITUTI PËR SHKENCË DHE TEKNOLOGJI - INSI

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR PËR PROJEKT HARTËN ZONALE KOMUNALE - OBILIQ 2023-2031

PËRMBAJTJA

Historiku i Zhvillimit.....	8
KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE.....	9
Direktiva VSMe BE-së	9
Direktivat tjera të BE-së.....	9
Strategjia 2020 e BE-së.....	10
Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB dhe Objektiva për Zhvillim të.....	10
Qëndrueshëm (OZHQ)	10
Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit.....	11
Konventa Århus	11
Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit.....	12
Historiku legjislativ, organet administrative përgjegjëse.....	13
Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor	13
Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit.....	13
Planet dhe programet e tjera të rëndësishme.....	14
PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së	14
POZITA GJEOGRAFIKE	18
KUSHTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE.....	19
Hipsometria dhe topografia	19
Gjeologjia dhe tokat	19
Kushtet klimatike	20
Hidrografia.....	20
Biodiversiteti, Flora dhe fauna	21
Rreziqet natyrore.....	22
Rrëshqitja e tokës.....	23
Diellosja	24
Erërat.....	25
Sipërfaqet me ndotje të lartë (Hot spotet).....	25
Popullsia	27
Shfrytëzimi i tokës.....	27
Asetet e Trashëgimisë Kulturore.....	28
Asetet e Trashëgimisë Natyrore.....	31
Asetet Turistike	32
Bujqësia.....	32

Industria.....	33
Transporti	34
Infrastruktura e energjisë elektrike.....	35
Energjia termike	36
Infrastruktura e Ujërave të Zeza	37
Infrastruktura e varrezave	38
Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave	38
Zonat me Probleme Mjedisore	42
Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore.....	42
Argumente të Analizës SWOT	43
Përparësitë	43
Dobësit	43
Mundësitë.....	43
Kërcënimet	44
Vizioni i Komunës së Obiliqit	Error! Bookmark not defined.
Qëllimet dhe objektivat e zhvillimit hapësinor të komunës së Obiliqit....	Error! Bookmark not defined.
Zhvillimi ekonomik.....	Error! Bookmark not defined.
Infrastrukura teknike	Error! Bookmark not defined.
Infrastrukura e transportit.....	Error! Bookmark not defined.
Infrastruktura publike dhe sociale	Error! Bookmark not defined.
Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri	Error! Bookmark not defined.
Trashëgimia natyrore dhe kulturore	Error! Bookmark not defined.
Vendbanimet	Error! Bookmark not defined.
Vendbanimet jo- formale	Error! Bookmark not defined.
Banimi	Error! Bookmark not defined.
Shfrytëzimi i tokës.....	Error! Bookmark not defined.
Disa nga aspekte Kryesore të Gjendjes Aktuale Mjedisore.....	47
Popullsia dhe Shëndeti publik.....	47
Shëndeti	48
Çështje Ekzistuese Mjedisore të Lidhura me Popullsinë dhe Shëndetin.....	48
Veçori Natyrore Kryesore të Komunës dhe Zonat që Ndikohen.....	48
Zoonimi i territorit të komunës së Obiliqit	49
Zona të Mbrojtura	49

Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale	49
Pyllëzimi, Zhvillimi i Pyjeve, Zonat e Gjellbërta dhe Rekreative.....	49
Çështje Mjedisore që Lidhen me Mjedisin Fizik	50
Tipet e Habitaveve.....	51
Rreziqet Natyrore në Mjedisin Fizik	52
Cilësia e Ajrit	53
Zhurma dhe Kundërmimi	53
Çështje Mjedisore që Lidhen me Ujin e Pijshëm	54
Grumbullimi i Mbeturinave.....	54
Menaxhimi i Mbetjeve të Lëngëta dhe Kullimi i Ujërave të Shirave	54
Furnizimi me Energji	55
Aktivitetet Ekonomike dhe Sociale.....	55
Parimet e Përgjithshme për Planifikim Hapësinor	57
Objektiva Strategjike	58
Veprime Operacionale në Mbështetje të Objektivave Strategjike	59
Kriteret Mjedisore që Kufizojnë Zhvillimin Komunal	60
Kritere të Forta Mjedisore-Shëndetësore.....	60
Kritere të Trashëgimisë Kulturore.....	61
Kritere Peizazhike.....	61
Kritere Inxhinierike dhe të Infrastrukturës	61
Trajtimi i Çështjeve Mjedisore në Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal	64
Analiza e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të HZK-së	65
Masat e Nevojshme në HZK për Mbrojtjen e Mjedisit	71
Konceptet Urbane të Përdorimit të Tokës, përfshirë Zhvillimin e Qendrave	71
Ndikimi në klimë.....	72
Mbrojtja e Pyjeve, Zonave të Gjellbra Ekzistuese dhe Zhvillimi i Zonave të Reja	72
Cilësia e Ajrit	72
Propozimet për Rrugë	73
Probleme të Mjedisit në Obiliq dhe Përgjigja që Jepet përmes HZK-së	79
PËRFUNDIME.....	97

LISTA E SHKURTIMEVE

MMPHI Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

AMMK Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

BE Bashkimi Evropian

dB Decibel

GIS Sistemit i Informacionit Gjeografik

GNP Grimcat e Ngurta Pezull

HZK Harta Zonale Komunale

IHMK Instituti Hidrometeorologjikë i Kosovës

KK Komuna e Obiliqit

NOQ Ndotës Organike të Qëndrueshëm

OBSH Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ Organizata Jo Qeveritare

OZHM Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

PRRH Plani Rregullues i Hollësishëm

PZHK Plani Zhvillimor Komunal

TeR Termat e Referencës

UNDP Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara

UNEP Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara

VNM Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

VSM Vlerësim Strategjik Mjedisor

ZVM Zona të Veçanta të Mbrojtura

Lista e Figurave

Harta 1. Pozita Gjeografike e komunës së Obiliqit	19
Harta 2. Ndjeshmëria ndaj erozionit.....	22
Harta 3. Shtrirja e zonave sizmike dhe të rrezikuara nga rrëshqitja e tokës.....	23
Harta 4. Harta e shfrytëzimit të tokës.....	27
Harta 5. Shtrirja e tokave bujqësore sipas klasave tëbonitetit të tokave bujqësore.....	32
Harta 6 Shtrirja hapësinore e zonave industriale dhe ekonomik.....	33
Harta 7. Koncepti kryesor për zhvillim të ardhshëm hapësinor të komunës së Obiliqit.....	54
Harta 8. Ndikimi i HZK-së në ekosistemet natyrore.....	86
Harta. 9. Parashikimi i ndikimeve të HZK-së në aspektin hapësinore.....	86
Figura 1 Trëndafili i Erës	25

Lista e Tabelave

Tabela 1 Veçoritë gjeologjike	20
Tabela 9 Shfrytëzim i tokës sipas sipërfaqeve (ha) dhe përqindjes.	28
Tabela 11 Monumentet arkitekturale, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore, 2018.....	29
Tabela 13 Zonat e Veçanta te Mbrojtura, sipas njësive kadastrale dhe emërtimeve, dhe shtrirjes hapësinore, 2018.....	30
Tabela 19 Vendbanimet me varreza dhe sipërfaqja e tyre (ha).	38
Tabela 17. Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të HZK-së në komponentët mjedisore	77
Tabela 18. Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas HZK-së	80
Tabela 19. Monitorimi	93

HYRJE

Historiku i Zhvillimit

Ky studim i Vlerësimit Strategjik Mjedisor është përgatitur me qëllim vlerësimin e mjedisit të Hartës Zonale Komunale të Obiliqit. Ky hulumtim ndjek të gjitha udhëzimet dhe rregulloret e Ligjit Nr. 03/L-230 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", i cili është hartuar si pjesë e Direktivës Evropiane 2001/42 KE. Struktura e këtij studimi zbaton gjithçka që është propozuar në Ligjin Nr. 03/L-230 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor". Sipas Ligjit Nr. 03/L-230, ndiqen procedurat që do të shpjegohen në kapitujt e këtij raporti.

Harta Zonale Komunale e Obiliqit ka karakter rregullativ dhe strategjik për zhvillimin e hapësirës dhe do të shërbejë si bazë për Planet Rregulluese të Hollësishme, si dhe për planet tjera sektoriale dhe strategjive tjera për nivelin lokal. Komuna e Obiliqit ka një përvojë të mëparshme në Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, i cili do të shërbejë edhe në Vlerësimin Strategjik Mjedisor të këtij Dokumenti të Planifikimit Hapësinor. Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një proces që synon të integrojë konsideratat mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe politikave. Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale Komunale të Obiliqit (HZK) është një detyrim ligjor, i cili parashihet në nenin 23 të Ligjit të Planifikimit Hapësinor nr. 04/L-174.

Qëllimi i raportit të VSM-së për Hartën Zonale Komunale të Obiliqit është të identifikojë, përshkruajë dhe vlerësojë ndikimet e mundshme që mund të rezultojnë nga zbatimi i projekteve strategjike të PZHK të cilave ju jepen kushtet zhvillimore dhe kushtet tjera të përgjithshme, si dhe të ofrojë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja hapësinore dhe mjedisore. Në raportin e VSM-së përfshihen gjithashtu propozimet për masat e nevojshme për të shmangur dhe zvogëluar ndikimet negative që dalin nga projektet Kushtet Zhvillimore dhe kushtet tjera HZK.

Metodologjia e përdorur në këtë VSM është në përputhje me Direktivën e BE: 2001, si dhe me direktiven INSPIRE.

KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Direktiva VSMe BE-së

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktivë nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlamenti Evropian..., 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legislative, rregulluese ose administrative.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

- Përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & vendit ose shfrytëzim të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);
- Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve'. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejnë një procedure të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse ka në efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmbledhet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Kur të aprohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet paparashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

Direktivat tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve (dhe të programeve) poashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme'.

Strategjia 2020 e BE-së

Për veç dokumenteve të sipërpërmendura legislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha¹ është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor meqë bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si njëri prej prioriteteve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet e strategjisë janë “zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve* dhe *Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nisma të tjera si *Agjenda digjitale për Evropën*, *Unioni i përtëritjeve*, *Rinianë lëvizje*, *Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune* dhe *Platforma evropiane kundër varfërisë* do të mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t’i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjërat e ripërtëritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB dhe Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ)

Kombet e Bashkuara-KB kanë një rol aktiv në zhvillimin shteteve të ndryshme në botë . Edhe pse Kosova nuk është anëtare e kombeve të bashkuara, KB-ja aktualisht vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK, në mënyrë që t’i sigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në NjuJork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo ishte bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit². Të cilat ishin 8 objektiva ndërsa, një prej objektivave i kushtohej qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosje e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;

¹http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

²http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetëte sëpaku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

Edhe pse në këto 15 vitet e fundit u bë një progres i dukshëm në arritjen e OZHM-ve, shumë objektiva nuk u arritën. Për të përshpejtuar progresin dhe avancuar zhvillimin përtej vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 25 shtator 2015 miratoi axhendën e zhvillimit të post 2015, duke vendosur objektivat dhe pikësyzimet e reja për 15 vitet e ardhshme. Axhenda e re përcakton shtatëmbëdhjetë Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) ose Sustainable Development Goals (SDG), të cilat kanë si afat vitin 2030 dhe kërkojnë të ndërtojnë e plotësojnë atë që OZHM nuk e arritën. Në këtë axhendë të re të zhvillimit, mjedisi konsiderohet të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa qështjet mjedisore kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore dhe në cilësinë e jetës së njeriut. Kjo është arsyeja pse mjedisit i janë dhënë objektiva të posatshme (OZHQ nr. 11, 13 dhe 15) por edhe objektiva tjera substancialisht përmbajn çshtjet mjedisore. Këto objektiva janë të rëndësishme që të kenë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe adresimin e problemeve globale të mjedisit.

Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollit i Kievit

Konventa Århus

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNECE mbi Qasjen...,1998) Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartojnë dispozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaj i pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinion të influencuar dhe organizatave joqeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;
- të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.

Konventa Espoo dhe Protokollin e Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi.....Mjedisor,1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Poashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet e mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pa favorshëm në mjedis përtej kufijve. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997. Siç thekson Marsden (2008), Protokollin e Kievit është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, me që do të mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokollin është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën Espoo, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi strategjik i mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (VNP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokollin poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokollin kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillim rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzimit të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

Historiku legjislativ, organet administrative përgjegjëse

Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjinr. 03/L-106), ndërkaq në korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;

Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;

Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet

Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (Qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. HZK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton kushtet zhvillimore dhe masat për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 4 vjetëve dhe ta përfshijë një Plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Te gjitha nivelet e Planeve duhet te përfshijnë zhvillimin e qendrueshëm si dhe për secilin Plan obligohet përgaditja e raportit të VSM paralelisht me Planin.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikat për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin zhvillimet urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmonime politikat dhe programet nacionale si dhe duke rrespektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit

Ky ligj nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të planeve dhe të programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e planeve dhe e programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM. Nëse mendohet që VSM nuk nevojitet vendimi përkatës duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet t'i përfshijë arsyet tij. Raport i NMV identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikime të mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i planit ose programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Kërkesat përcaktohen në ligj në mënyrë që t'i u ofrojnë qasje në dokumentet VSM organeve këshilluese dhe opinionit të përgjithshëm. Projekti i dokumenteve VSM është një objekt për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesa te posaçme për rastet e këshillimeve ndërkufitare. Para se të aprovohet raporti

VSM, ministria duhet ta shqyrtojë atë dhe të pajtohet me të. Poashtu janë përcaktuar procedurat për informimin lidhur me aprovimin e vendimeve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen. Shtojcat e ligjit përmbajnë kritere të caktuara për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të ndikimeve në mjedis dhe informatat e nevojshme që duhet të ofrohen në raportet VSM si edhe kriteret për vlerësimin e raporteve VSM.

Planet dhe programet e tjera të rëndësishme

Përveç legjislacionit raporti i VSM-së duhet të merr parasysh edhe Planin Hapësinorë të Kosovës 2010-2020+, Strategjinë për mjedisin dhe Planin e veprimit në Mjedis, si dhe disa plane, programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së

Hartimi i raportit të VSM-së për programe, plane zhvillimore dhe projekte të mëdha është detyrim ligjor. Qëllimi i raportit të VSM-së për Hartën Zonale Komunale të Obiliqit është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Hartës Zonale Komunale, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet për kushtet zhvillimore dhe tjera të Hartës Zonale Komunale.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktiven e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis“ dhe ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë, i cili është transpozimi i direktivës së BE 2001/42/EC.

Mbështetur në si mësipërm VSM-ja duhet të përfshijë pikat e mëposhtme:


- Një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
- Përshkrim të Vizionit, prioritet dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal të zilat do të zbatohen edhe në Hartën Zonale komunale dhe marrëdhëniet e tij me politikën, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- Përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk zbatohet plani;
- Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me HZK;
- Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;
- Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.

- Një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

HZK për numrin e madh dhe diversitetin e gjere te problematikes qe trajton, kërkon konsultimin e një game te konsiderueshme dokumentacioni. Behet fjale për plane, raporte, projekte, studime dhe literature teknike nga sektorë te ndryshëm ekonomik dhe social. Ky dokumentacion përveç materialeve që dispononte vete grupi hartues i VSM-s, u siguria nga komuna e Obiliqit, institucione të tjera publike dhe kërkimet në internet.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut të shkaktuara nga zbatimi i planit, programit ose dokumenti tjetër strategjik. Në raportin e VSM përfshihen edhe masat e rekomanduara për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e planit. Për të siguruar efektivitetin e procesit të VSM, është thelbësore që dokumentet strategjike të marrin në konsideratë disa opsione alternative për arritjen e qëllimeve të identifikuar. Në këtë rast VSM lejon vendimmarrësit të marrin në konsideratë opsionin më miqësor ndaj mjedisit.

Fazat kryesore të procesit të VSM me bazë mbi praktikatat ndërkombëtare:



Nevojshmëria	Përshkrimi
Përfshirja/qëllimit të VSM-së	Identifikimi i çështjeve që do të përfshihen në studimin e VSM-së do të orientojnë vlerësimin e gjendjes bazë të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve më të gjera mjedisore apo sociale në zonë dhe konservimin e të gjitha aseteve më rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese përbën bazën për vlerësimin e ndikimeve dhe përpilimin e skemes së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme të konsiderohen tendencat e mundshme të zhvillimit. Qëllimi i analizës së gjendjes ekzistuese është që të orientojë drejt një specifikimi me të mirë të çështjeve kyçe, dhe një identifikimi me të mirë të problemeve kryesore që lidhen me planet, programet apo projektet përkatëse.
Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse	VSM analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. VSM mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të planit, dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme kumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve ose planeve të tjera në afërsi të zonës. VSM do të analizojë specifikisht masat adekuate përmirësuese që do të rezultojnë nga plani. Duke konsideruar, bashkërisht, ndikimet dhe raportin benefit/cost të veprimit ose mos veprimit do të analizohen opsionet dhe përzgjidhet ai që rezulton më i miri në planin ekonomik dhe mjedisor.
Hartimi i raportit të VSM-së	Raporti i VSM përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë gjithë procesit të VSM dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit. Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në mënyrë të qartë, dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit.
Adoptimi	Jepet informacion mbi përputhshmërinë e objektivave mjedisor me elementët kyçe të planit, të identifikuar paraprakisht. Mos përputhshmëria e objektivave mjedisor me planin nevojitet të rishikohen dhe propozohen ndryshime të mundshme në plan.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisor dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese/zbutëse për çdo efekt mjedisor të konsiderueshëm të paparashikuar në këtë studim.

Tabela 1 Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtra të punës

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar dokumente strategjike, plane, raporte, projekte, studime dhe literature teknike nga sektorë të ndryshëm ekonomik dhe social. Përveç materialeve në dispozicion janë siguruar informacione edhe nga Komuna e Obiliqit, institucione të tjera publike dhe hulumtime në internet.

ANALIZA E
GJENDJES
EKZISTUESE

POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën skajore të rrafshit të pasur të Kosovës, 10km në veri-perëndim të Prishtinës, qendër administrative, politike dhe universitare e Republikës së Kosovës. Ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kufizohet me pesë komuna të tjera: komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Podujevës. Magjistranja Prishtinë-Mitrovicë (M2), Autoudha „Ibrahim Rugova“, e cila ka hyrje dhe dalje në fshatin Mazgit, (Aeroportin ndërkombëtar „Adem Jashari“ 23km, Porti i Durrësit 264km, Porti i Shëngjinit 233km. Dy linja hekurudhore (Fushë Kosovë-Shkupë, Fushë Kosovë-Pejë, Fushë Kosovë-Mitrovicë).

Territori i komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe prej 104.84 km² dhe zënë një hapësirë rreth 1% të territorit të Kosovës. Këtë sipërfaqe e përbënë një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica dhe lumit Llap, ndërsa pjesët tjera të relievit në perëndim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në kodra e lugina të malit të Kopaonikut (Albanikut). Territori i Komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe prej 105 km² dhe zë një hapësirë rreth 1 % të territorit të Kosovës dhe pozitë qendrore të Rrafshit të Kosovës, përkatësisht në pjesën veriore të saj. Obiliqin e definojnë koordinatat 42o 41' të gjerësisë veriore gjeografike dhe 21o 5' të gjatësisë lindore gjeografike.

Në tërë komunën gravitojnë 20 vendbanime të shtrira në 18 zona kadastrale: Obiliqi (i ri dhe i vjetër), Mazgiti i ultë, Mazgiti i Lartë, Llazareva, Millosheva, Bakshia, Raskova, Baimofci, Breznica, Kozarica, Plemetini, Hamidia, Sibovci, Grabofci i Epërm, Shipitulla, Hadja, Dobrosellë, Leshkoshiq, CërkvenaVodicë dhe Kryshefc, që janë të banuara me komunitete të përkatësive etnike si: Shqiptar, Serb, Rom, Ashkali, Egjiptas, Boshnjak, Turk, Goran.

Obiliqi gjendet 10 km larg kryeqendrës së Kosovës , Prishtinës. Është i vendosur në mes të rrafshit të Kosovës afër lumenjve Sitnicë dhe Llap. Territori i Komunës së Obiliqit përbëhet prej formave të llojllojshme duke filluar nga fushat, terrenet e rrafshëta rreth lumit Sitnica dhe Llapi, kodrinave të ulëta , rrafshnaltave e deri te kodrat dhe malet.


Pjesa qendrore e territorit të Komunës shtrihet rreth lumit Sitnicë, që është një teren fushor me një pjerrtësi mesatare prej 0,7m/km,ndërsa pjesët tjera të relievit në lindje shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në perëndim po ashtu në kodra dhe lugina, male të degëve të malit të Albanikut (Kopaonikut).

Nga tërë territori i Komunës afro 75 % është sipërfaqe e rrafshët dhe kodrinore ndërsa diku 25 % janë teren malor dhe atë kryesisht pjesët periferike territorit të cilat edhe kufizojnë komunën e Obiliqit me Komunën e Glogocit dhe të Podujevës.

Komuna e Obiliqit është një qendër ekskluzivisht industriale, ku gjenden rezerva të mëdha të thëngjillit e cila shtrihet në mes të luginës së lumit Sitnicë dhe lumit Drenicë në një gjatësi prej rreth 32 km në drejtim veri-jug dhe një në gjerësi rreth 12 km. Deri më tani janë konstatuar rezerva rreth 13 miliardë tonelata.

Këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rrethlumit “Sitnica” dhe lumit “Llap”, ndërsa pjesët tjera të relievit në perëndim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në veri, po ashtu, në kodra e lugina të malit të Kopaonikut (Albanikut).

Komuna e Obiliqit , shtrihet në afërsi të gjigantit të KEK-ut dhe si e tillë është një qendër ekskluzivisht industriale me rezerva të mëdha të linjtit. Kjo bën qe Obiliqi te jete një ndër komunat më të ndotura në Kosovë.



Harta 1. Pozita Gjeografike e komunës së Obiliqit

KUSHTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE

Hipsometria dhe topografia

Komuna e Obiliqit ka kontraste relievore pasi që pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica, ndërsa pjesët tjera të relievit në lindje shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në perëndim po ashtu në kodra e lugina (male të degëve të maleve të Albanikut (Kopaonikut)).

Rrjedhë se 75% e sipërfaqes së komunës është sipërfaqe e rrafshët dhe kodrinore, ndërsa diku rreth 25% janë terrene malore. Pika më e lartë e territorit të komunës është në fshatin Kozaricë me 740 m lartësi mbidetare, kurse pika më e ulët është tek ura në mes të fshatit CërkvenaVodicë dhe qytetit të Obiliqit me 530 m lartësi mbidetare. Në qoftë se marrin piken me të lartë dhe piken më të ulët të Komunës së Obiliqit atëherë lartësia mesatare e Komunës së Obiliqit është 635m .

Komuna e Obiliqit shtrihet rreth koordinatave gjeografike: 42° 41 24 V dhe 21° 04 40 L. Territori i Komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe 105m² dhe zen një hapësirë rreth 1% të Territorit të Kosovës. Kjo sipërfaqe përbën një reliev të ndryshëm me terrene malore dhe sipërfaqe të rrafshëta dhe me tokë pjellore.

Gjeologjia dhe tokat

Sa përket përbërjes gjeologjike të tokës në territorin e Komunës, me 43.98% dominon përbërja balta, rëra, zhavorri, marlina, pjesërisht e linjtit, pastaj 21.79% është përbërje lymore dhe 12.04% është përbërje proluvium.

Kategoritë gjeologjike	Sipërfaqja (ha)	%
Albite diorite	4.57	0.04%
Alluvium	1098	10.47%
Balta, rëra, zhavorri, marlina, pjesërisht e linjtit	4611	43.98%
Diabase, spilite, bazalt	4.86	0.05%
Gabro	17.65	0.17%
Heterogeneousbreccia	31.74	0.30%
Sedimentet e liqenit dhe lumenjve	20.46	0.20%
Mermer	17.94	0.17%
Mermer, rreshpe gëlqerore	116.4	1.11%
Gur mermeri, gur ranor, gur gëlqeror, tuffite, pjesërisht linjit	65.15	0.62%
Mica quartzite, metasandstone, metamudstone	34.38	0.33%
Proluvium	1262	12.04%
Pyroclastiteof the andesitegroupwithtuff, lappilli, breccia	180.8	1.72%
Quartzite, metaquartzsandstone, conglomerate	17.09	0.16%
Reeflimestone, breccias, sandyflyschwitholistoliths	58.19	0.56%
Lymore	2285	21.79%
Sandstone, phyllite, marble, calcareousschist	49.57	0.47%
Sandstone, siltstone, marlstone, mudstonewitholistoliths (sandyflysch)	56.08	0.53%
Serpentinite	34.89	0.33%
Volcanic-sedimentaryseries	518.5	4.95%

Tabela 2 Veçoritë gjeologjike

Kushtet klimatike

Komuna e Obiliqit duke qenë e vendosur në fushëgropën e Kosovës, sikur mbahet mbi supet e maleve të Qyqavicës dhe Shalës së Bajgores. Kjo komunë përshkon tërthorazi këtë fushëgropë prandaj edhe ka një fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore prej 1,0531ha, që përbën 48% e territorit të komunës së Obiliqit, gjersa 37% është tokë pyjore.

Miniera e re e Sibovcit do marrë më së shumti tokën e bukës, diku rreth 13% e territorit të komunës së Obiliqit. Në këtë fushë të paraparë për minierësipërfaqësore, 86% e territorit është tokë e bukës ose ara kurse pjesa tjetër vendbanime, rrugë dhe pyje.

Dukuria e ndërtimit përgjatë akseve rrugore është e theksuar edhe në komunën e Obiliqit, një sipërfaqe e konsiderueshme e kësaj pasurie është duke humbur nga ndërtimet e pakontrolluara kryesisht me përmbajtje biznesi. Sipas një analize të bërë në qendrat e mëdha urbane, për periudhën 1980 deri në vitin 2000 kur janë bërë fotografimet ajrore, është konstatuar se zonat urbane nëse një zonë urbane ka pasur sipërfaqe prej 1.000 ha, pas periudhës së përmendur zona në fjalë është rritur në 2.700 ha, që do të thotë janë humbur 1.700 ha.

Hidrografia

Në territorin e Komunës ekzistojnë tre lumenj natyror që janë: "Sitnica", "Drenica" dhe "Llapi". Si dhe një kanal artificial që është Kanali Ibër - Lepenc, i cili vjen nga liqeni akumulues i Ujmanit nga rrjedha e lumit "Ibër". Lumi "Sitnica" përshkon territorin e Komunës nga jugu në veri dhe është ujëmbledhësi i 80 % të ujërave në drejtim të veriut. Lumi "Sitnica" derdhet në lumin "Ibër" në Mitrovicë.

Lumi "Drenica" rrjedhë në perëndim dhe derdhet në lumin "Sitnicë" para hyrjes në jug në territorin e Komunës. Lumi "Llap" rrjedhë në lindje, i cili derdhet në lumin "Sitnicë" në veri të territorit të Komunës. Lumi "Sitnicë" është lumë fushor me pjerrtësi të vogël, me shtrat të gjerë, të cektë dhe me gjarpërime, veçohet me prurje të vogla vjetore të ujit. Gjatë stinës së verës nuk ka prurje më të madhe se 2.5 m³/s, kurse gjatë stinës së dimrit dhe në pranverë, kur bëhet shkriuara e bores, kjo prurje është 15 herë më e madhe, përkatësisht 37.5 m³/s. Gjatë

prurjeve të mëdha të ujit, lumi "Sitnica" del jashtë shtratit dhe përmytë sipërfaqe të tokave punuese për rreth, duke i shkaktuara dëme të mëdha bujqësisë.

Vetë fusha e mihjeve mbulon gjashtë zona ujëmbledhëse të zonave më të vogla ujore; katër prej tyre që rrjedhin në drejtim të lumit "Sitnicë" në lindje dhe dy në drejtim të lumit "Drenica" në perëndim. Përgjatë lumit "Sitnicë" shtrihet një fushë, që përmytet me ujë në sezonin e reshjeve të mëdha, në të cilën gjendet lokacioni i zonës industriale ku janë vendosur dy (2) blloqet e TC "Kosova B".

Lumi "Sitnicë" është i ndotur nga shkarkimet në rrjedhën e mesme të tij nga shkarkimet urbane, e përveç tyre edhe nga efluentët nga termocentralet dhe mihjet e KEK-ut, të cilat shkarkohen direkt, pa ndonjë trajtim adekuat, si dhe rrjedhat e ujërave nga deponitë e hirit.

Përveç këtyre, lumenjtë pranojnë përmbajtje të madhe të materieve organike, pasi që nuk ka fare ose fare pak trajtim të ujërave të zeza. Të dhënat e përpiluara së mbi pikat e shkarkimit dhe marrjes së mostrave të cilësisë së ujit tregojnë që uji i lumit "Sitnicë" duhet kategorizuar si Ujë i Klasës IV, sipas sistemit të klasifikimit (pra, "ujë që mund të përdoret vetëm pas një trajtimi special") dhe është larg nga standardet evropiane të cilësisë.

Biodiversiteti, Flora dhe fauna

Në territorin e Komunës, gjer me tani, nuk ka ndonjë zonë që është shpallur e mbrojtur në bazë të legjislacionit në fuqi për shkak të vlerave të biodiversiteti apo ekosistemeve me rendesi.

Ekosistemet natyrore në një pjesë të territorit të Komunës në masë të madhe është i ndikuar nga minierat, deponitë e djerrinave, termocentralet dhe deponitë e hirit të "TC-A dhe TC-B", kështu që kemi një pamje të ashpër të peizazhit natyror. Në pjesët tjera të territorit të Komunës kemi një pamje të mirë të peizazhit natyror.

Në planet e ardhshme, zona e mihjeve ekzistuese, depozitat e hirit dhe depozitimet e djerrinës do të pastrohen, ri-kultivohen dhe mbillen, rrjedhë që vazhdimisht do të përmirësohet pamja vizuale peizazhi natyror.

Në territorin e Komunës ekzistojnë vetëm disa monumente natyrore siç janë:

- Burim i ujit mineral në Grabofc të Epërm;
- Burim/krua në qendër të fshatit Caravadicë (CërkvënaVodicë);
- Trung druri i vetëm bliri (*Tilia spec.*), i vjetër rreth 200 vjet, në lagjen Nicak (Sibovc) dhe;
- Grup trungjesh druri të bungut (3x *Quercus spec.*, 1x *Quercuscerris*), diku rreth 300 vjeçar, në lagjen e Megjuanëve (Sibovc).

Në afërsi të fshatrave mund të gjendet vegjetacion i vrazhdë. Biotopet natyrore gjenden afër lumit "Sitnica" dhe përfshijnë livadhet e lagështa, komunitetin e llojeve të bimëve barishtore, dhe llojet e drurit të ahut, lisit, shkurret etj., që gjinden në perëndim.

Ndër shpendët e egër të malit e të fushës që ndeshen më shumë janë shqiponja e malit, petriti, grizhlat, sorrat, harabeli, kulumbria, bufi, lakuriqi i natës etj. Ndër kafshët e egra që gjenden veçojmë dhelprën, lepurin, ujkun, derri i egër, buklën, iriqin, breshkën etj.

Në ujërat e lumenjve e të kanaleve veçojmë rosat, patat, lejlekun, gjarpërinjtë e ujit, bretkosat, breshkat e ujit, etj.

Nga dëmtimi i pyjeve po dëmtohen gjithashtu si flora ashtu edhe fauna e egër. Disa prej tyre janë në zhdukje e sipër si lepuri i egër, thëllëza e malit, shepka e malit, sidomos nga gjuetia e pakontrolluar, si në sezonin e gjuetisë ashtu edhe jashtë sezonit.

Rreziqet natyrore

Vërshimet

Komuna e Obiliqit përshkohet nga 3 lumenj : Sitnica, Drenica dhe Llap.

Në komunën e Obiliqit janë 130.91 ha sipërfaqe ujore apo 1.25% e tërë sipërfaqes së territorit të komunës. Prej tyre janë: lumenj 61.22 ha, përroje 21.43 ha, jazë 2.49 ha, kanale 42.68 ha, mullinj 0.01 ha dhe kënetë 3.08 ha. Nga vërshimet janë të rrezikuara vendbanimet: Kastrioti, Kryshefc, Cërkvena Vodicë, Plemetini dhe Hamidija.

Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet shtrihen në të dy anët e lumit Sitnicë dhe Llap. Përveç faktorëve natyror edhe faktori njeri ndikon në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet përmes disa aktiviteteve si :

- Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve)
- Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet
- Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve
- Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetë rritura pran brigjeve të lumenjve etj.
- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.

Thatësira

Thatësia mundë të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla.

Shkalla e erozionit


Erozioni rrezikon natyrën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon në sipërfaqet bujqësore dhe në vendbanime. Rreth 6.000 km² ose 56 % e territorit të Kosovës është e rrezikuar nga kjo dukuri natyrore që i takon shkallës së I, II, III të erozionit, (I erozion shumë i fortë, II erozion i fortë dhe III erozion i mesëm).

Vetëm në pellgun e Sitnicës nën ndikim të erozionit janë rreth 1.400 km² ose rreth 48 % e sipërfaqes së pellgut të lumit (kategoria I, II, III). Edhe në territorin e komunës së Obiliqit është prezent dukuria e erozionit që rrezikon me humbje të tokës bujqësore dhe dëme të mëdha në ekonominë familjare. Në bazë të analizave të paraqitura në hartë janë ndarë këto kategori të erozionit.

Në bazë të të dhënave, nga shkalla e lartë e rrezikshmërisë erozive janë përfshirë rreth 535 ha ose 6 % e sipërfaqes së territorit të komunës, ku shkalla e rrezikshmërisë është në rritje si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri.

Nr.	Përshkrimi	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja %
1	Pa erozion	4996.30	47.66%
2	Erozion shumë I dobët		
3	Erozion i dobët		
4	Erozion shumë I fortë	4951	47.23%
5	Erozion i fortë	381.76	3.64%
6	Erozion shumë I fortë	153.37	1.47%

Tabela 2 Sipërfaqet dhe përqindja e territorit e rrezikuar nga erozioni




Harta 2. Ndjeshmëria ndaj erozionit

Rrëshqitja e tokës

Në territorin e komunës së Obiliqit nga rrëshqitja e tokës (dheut) janë të prekura zonat rreth KEK-u si fshati Hade, Lajthishte, Sibovc, Shipitullë, Babimoc, Hamidi.

Tërmetet

Territori i komunës është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS. Për zonat mikrosizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo veri-lindore. Sizmika - Kosova i nënshtrohet lëvizjeve tektonike vertikale dhe është në një zonë aktive sizmike të shtrirë përgjatë Rripit Orojenik - Alpine - Himalaje. Në hartën e më poshtme, si në hartën 9, paraqiten zonat me shkallë sizmike në Kosovë bazuar në magnitudat që janë vëzhguar deri me tani me epiqendrat e tërmeteve të regjistruara gjatë periudhës një shekullore. Regjistrimet historike tregojnë se kanë ndodhur 534 tërmete, prej tyre 82 të intensitetit më të madh se 6° MSK (kategori sipas shkallës së Merkalit), 12 të intensitetit >7° MSK, 10 të intensitetit >8° MSK dhe 3 të intensitetit >9° MSK.



Harta 3. Shtrirja e zonave sizmike dhe të rrezikuara nga rrëshqitja e tokës

Dielllosja

Në Komunën e Obiliqit ka ekspozicion qendror si Komunë ku dominon relievi kodrinor-malor që përfshin lindjen, perëndimin dhe pjesa qendrore e komunës është pjesë fushore që shtrihet rreth Lumit Sitnica . Kodrat janë me pjerrtësi më të ulët, përveç në lindje dhe perëndim ku pjerrtësia është relativisht më e madhe. Peizazhi natyror i territorit Komunës së Obiliqit është i ndryshueshëm dhe i pa eksploruar. Prerja dhe djegia e drurëve, dhe hedhja e mbeturinave rrezikojnë këto burime nga degradimi i resurseve natyrore.

Dielllosja (insolacioni) është e rëndësishme për botën e gjallë (bimët, kafshët, njerëzit), për bujqësi, turizëm, shëndetësi etj. Në diellosje ndikon gjerësia gjeografike (këndi i rënies së rrezeve të diellit), relievi (lartësia, ekspozicioni), vranësia, erërat. Në gjerësitë tona gjeografike (42-43 shkallë) diellosja vjetore do të duhej të zgjaste 4450-4460 orë në vit ose 12,20 orë në ditë.

Në të vërtetë diellosja në Kosovë zgjatë 2079 orë ose 5,7 orë në ditë, që është 47% nga diellorja e mundshme. Diellosja më e vogël është në viset malore dhe afër tyre dhe gjatë muajve të dimrit. Diellosja në muajin dhjetor është mesatarisht 54 orë gjithsej ose 1,7 orë në ditë, kurse gjatë muajve të verës (mbi 250 orë në muaj ose 8,3 orë në ditë). Diellosja është diçka më e lartë në Rrafshin e Kosovës se të Dukagjinit, sepse malet ne Rrafshin e Kosovës janë me te ulëta se ne Rrafshin e Dukagjinit.

Erërat

Sipas vlerave të dominimit të drejtimit të erës dhe qetësisë së tyre mund të konstatohet se qetësisë lajmërohen më së shpeshti kur nuk ka ndryshime të shtypjes atmosferike dhe temperaturës me 32.7%. Prej erërave më së shpeshti është era frontale nga:

- Veri-Verilindja me 20.3%;
- Veriu me 19.4% ;
- Perëndimi me 4 %; dhe
- Jugu me 5%.

Era nga drejtimi Verilindje më së shpeshti lajmërohet në pranverë e më rrallë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin Gusht e më së paku në muajin Prill. Shpejtësia mesatare më e madhe e erës është matur gjatë muajit Mars në shumë vite dhe ka vlerën 3.2 m/sekondë, ndërsa më e vogla në muajin Shtator 1.8 m/sekondë.




Figura 2 Trëndafili i Erës

Sipërfaqet me ndotje të lartë (Hot spotet)

Kosova A dhe B - Burimet kryesore të ndotjes së mjedisit janë kapacitetet për prodhimin e energjisë elektrike termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B", Gjatë prodhimit të energjisë elektrike në termocentrale vjen deri te djegia e thëngjillit me ç' rast lirohen gazrat dhe pluhuri fluturues në formë të tymit dhe nëpërmjet të tymtarëve lirohen në atmosferë, ndërsa elementet tjera të cilat janë në përbërje të thëngjillit lirohen në formë të hirit dhe në formë të ujërave pas proceseve teknologjike.

Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në territorin e Komunës së Obiliqit. Niveli i lartë i imitimeve të gazrave nga termocentralet me përqendrim të madh të materieve acidike, pluhurit dhe vetëndezja e thëngjillit, shkaktojnë ndotjen e madhe të ajrit.

Deponia e Mirashit - Kjo deponi e mbeturinave është regjionale dhe mbeturinat sillen nga Prishtina, Podujeva, Lipjani, Graçanica, Fushë Kosova dhe Drenasi. Deponia lëshon erëra të rënda dhe ndikon negativisht në gjendjen e ambientit. Kjo është konstatuar edhe nga ana e eksperteve të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë. Në pjesën dërmuese të kohës mbeturinat digjen duke shkaktuar tym të vazhdueshëm. Komuna e Obiliqit ka kompetenca

për të obliguar përgjegjësit e deponisë që shkalla e mirëmbajtjes së saj të brendshme të jetë në përputhje me standardet e kërkuara duke pamundësuar kështu ndezjen e mbeturinave dhe shpërndarjen e tyre jashtë diametrit të deponisë.



Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

Zonat malore në fshatin Kozaricë, Breznicë, Shipitullë, Sibovc, Grabovc si dhe korporata e KEK-ut që paraqet rrezik permanent për shfaqjet e zjarrit.

KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE

Popullsia

Analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillim socio-ekonomik në të ardhmen. Në bazë të rezultateve të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 numri i banorëve në Komunën e Obiliqit është rreth 21,549 banorë, shumica prej tyre të moshës së re. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik, ekonomik dhe social. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik. Komuna e Obiliqit ka popullsi kryesisht të re, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Mbi 35% e popullsisë së përgjithshme në këtë zonë janë në moshë të re 0 deri 18 vjeç. Ndërsa, grup-mosha 19–35 vjeç e përbën mbi 25% të popullsisë, grup mosha 36–65 vjeç përfshin rreth 35% dhe mosha mbi 66 vjeç e popullsisë përfshin 4.9% të popullsisë së përgjithshme. Këto të dhëna më së miri tregojnë se kjo zonë si edhe e tërë Kosova ka një popullsi të re me rreth 60% të saj nën moshën 35 vjeçare.

Trendët dhe prognozatat demografike bazohen në të dhënat e regjistrimeve zyrtare të popullsisë 1948 - 2011, gjatë kësaj periudhe vërehet një dyfishim i numrit të banorëve prej 57.01% apo 0.90% në vit.

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Baimofc	686	746	745	894	1077	1150	392
Bakshi	215	248	263	365	483	617	602
Breznicë	874	910	1051	1337	1606	1810	1302
CërkvenaVodicë	697	820	1037	1214	1510	1535	733
Dobrosellë	35	40	62	:	:	:	:
Grabofc i Epërm	264	282	356	442	554	766	341
Hade	986	1127	1407	1833	2105	2193	534
Hamidi	102	120	113	134	203	223	147
Kozaricë	:	:	:	:	:	:	469
Kryshefc	503	831	1055	1412	1750	1912	1053
Leshkoshiq	446	542	632	744	930	1081	703
Llazarevë	100	69	98	136	196	230	429
Mazgit	387	508	6 69	1188	1837	2218	2886
Millosevë	583	616	758	976	1306	1588	1819
Minierë e Kosovës	311	442	479	404	262	255	:
Obiliq	1217	1613	3646	6906	8769	11612	6864
Plemetin	656	754	929	1203	1593	1840	1381
Raskovë	199	234	279	350	452	518	640
Sibovc	675	747	942	1189	1480	1632	963
Shipitullë	327	362	440	461	482	447	291
Gjithsejtë	9263	11011	14961	21188	26595	31627	21549

Tabela 8. Numri i banorëve në vitet 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe 2011


Shfrytëzimi i tokës

Sipërfaqja e përgjithshme e Komunës është 10.492Ha, 5ari e 19m² (105 km²). Në këtë tërësi si pronë private është e evidentuar sipërfaqja 5683Ha, 38ari dhe 81m². Prej kësaj sipërfaqeje me shfrytëzim pyje është 469ha,35ari dhe 82m² ndërsa pjesa tjetër është zonë e banimit dhe tokë bujqësore.

Në Komunën e Obiliqit me 62.08% dominon toka bujqësore, pastaj zona minierë sipërfaqësore me 11.61%, toka pyjore me 11.11% dhe banimi me 8.76%.

Banim	Zonë Bujqësore	Zonë e Shërbimeve	Zonë e mbrojtur-	Zonë Industriale	Zonë Komerciale	Zonë komunikacioni, transporti	Zonë e mbrojtur arkeologjike - historike	Zonë Pyjore	Zonë rekreative-turistike	Zonë minierë sipërfaqësore
920.72ha	6524.43ha	83.76ha	21.41ha	276.67ha	74.85ha	172.56ha	21.41ha	1168.04ha	26.09ha	1220.22ha
8.76%	62.08%	0.80%	0.20%	2.63%	0.71%	1.64%	0.20%	11.11%	0.25%	11.61%

Tabela 3 Shfrytëzim i tokës sipas sipërfaqeve (ha) dhe përqindjes.



Harta 4. Harta e shfrytëzimit të tokës

Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Asetet e Trashëgimisë Kulturore

Trashëgimia arkeologjike, arkitektonike dhe historike është shumë e rëndësishme për të kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm, sidomos me pjesëmarrjen e saj në llojllojshmërinë (diversitetin) e zhvillimit të zonave rurale.

Në disa pjesë të Komunës sonë ka gjurmë të vendbanimeve të lashta. Ndonëse nuk janë bërë hulumtime arkeologjike të mirëfillta, megjithatë tashmë dihet që në Majën e Zezë në fillim të Qyqavicës, midis fshatrave Graboc i Epërm, Shipitullë e Sibovc janë gjetur themele shtëpish, gurë të gdhendur, elemente metalesh, madje edhe grurë i karbonizuar, të gjitha këto gjetje që dëshmojnë për një vendbanim shumë të lashtë. Shumë nga objektet (dhe veçanërisht gurët) janë dëmtuar.

Është e nevojshme të bëhen hulumtime arkeologjike në territorin e Komunës.

Asetet e Trashëgimisë Kulturore të shpallura nën mbrojtje nga niveli qendror

Komuna e Obiliqit karakterizohet me disa lloj të trashëgimisë të cilat janë nën mbrojtje.

Kategoritë	Numri
Trashëgimi arkitektuale	6
Trashëgimi arkeologjike	9
Peizazhet kulturore	2
Zonat e veçanta të mbrojtura	2
Gjithsej	19

Tabela 10 Trashëgimia kulturore nën mbrojtje, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore, 2018

Trashëgimia arkitektuale: Në territorin e Komunës shtrihen gjashtë monumente arkitektuale të cilat janë nën mbrojtje nga MKRS-ja.

Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Tyrbja e Muratit	X		350.00m ² / ~3440.04m ²
Selamllëku Shtëpia kulturore Promovuese Muze	X		90.05m ²
RTK1 Radio Televizioni Valët e Mesme në Bakshi	X		0.40m ²
Tyrbja e Bajraktarëve-Mazgit	X		23.00 (ha)
Monumenti Memorial	X		
Mulliri i Behramajve- Graboc i Epërm	X		~1000.38 m ²
Mulliri I Hysenajve - Graboc i Epërm		X	~1992.93 m ²
Gjithsej	7		

Tabela 4 Monumentet arkitektuale, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore, 2018

Sa i përket trashëgimisë arkeologjike, në Komunë shtrihen disa lokalitete arkeologjike në disa vendbanime.

Sa i përket Zonave të Veçanta të mbrojtura, në Komunë shtrihet zona e veçantë e mbrojtur e Gazimestanit, që mbulon një sipërfaqe prej 23.00 ha.

Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Lokalitet arkeologjik parahistorik shumështrësor -Dardhishtë (Krushec)	X		1.3 ha
Lokalitet arkeologjik e periudhës së vonshme antike-'Maja e Zezë' (Gradina) Graboc i Epërm		X	6.00 (ha)
Lokaliteti arkeologjik''Lugu i Bucakut'' i periudhës mesjetare-Hade		X	Nuk ka gjetje sipërfaqësore
Lokalitet arkeologjik parahistorik Antikë /Baimoc		X	Nuk ka gjetje sipërfaqësore
Lokalitet arkeologjik të periudhës mesjetare ''Çukishtë''-Bakshi		X	Nuk ka gjetje sipërfaqësore

Lokalitet arkeologjik të periudhës parahistorik -Raskovë		X	Nuk ka gjetje sipërfaqësore
Lokalitet arkeologjik të periudhës së ankitetit të vonë-mesjetë e hershme-“Markovac” Plemetin		X	Nuk ka gjetje sipërfaqësore
Lokalitet arkeologjik i periudhës paleokristiane “Lugu i Kishës”-Graboc i Epërm		X	Nuk ka gjetje sipërfaqësore
Lokalitet arkeologjik “ Lagjia e Qurilëve- Kisha – Siboc		X	Nuk ka gjetje sipërfaqësore
Gjithsej		9	

Tabela 12 Monumentet arkeologjike, sipas vendbanimeve dhe emërtimeve, statusit ligjor dhe shtrirjes hapësinore, 2018

Zona të veçanta të mbrojtura, në Komunë konsiderohen:

Vendbanimi, Emri	Status ligjor	Sipërfaqja (ha)
Monumenti Memorial i Gazimestanit	I Mbrojtur	23.00 ³
Tyrbja e Bajraktarit	I Mbrojtur	

Tabela 5 Zonat e Veçanta të Mbrojtura, sipas njërive kadastrale dhe emërtimeve, dhe shtrirjes hapësinore, 2018

Asetet e Trashëgimisë Kulturore të shpallura nën mbrojtje nga komuna

Përpos aseteve të trashëgimisë kulturore të shpallura nën mbrojtje nga niveli qendror, Komuna po ashtu ka shpallur nën mbrojtje asetet vijuese të trashëgimisë kulturore:

Vendbanimet	Monumentet e trashëgimisë kulturore-historike	Sipërfaqja (m ²)
Obiliq	Monumenti i martirëve të lirisë	~234.34 m ²
	Kisha në Obiliq	~3508.24 m ²
	Objekti i stacionit hekurudhor	~216.27m ²
	Shtatorja e atdhetarit Aziz Zhilivoda	~1400.84m ²
	Busti i komandantit Adem Jashari	~00.2m ²
	Busti i dëshmorit të kombit Fahri Fazliu	~10 m ²
	Shtatorja e Heroit “Xhavit-Hazirit”	200.15m ²
Mazgiti Ultë	Monumenti i Ferid Currit	~324.45 m ²
Hade e Re	Pllaka përkujtimore e dëshmorëve	92.35m ²
Hamidi	Xhamia (nga shek.-XVIII)	~1470.24m ²
	Shtëpia Muze në Hamidi	~247.75 m ²
	Lapidari i lirisë	~411.40 m ²
Siboc	Varrezat e dëshmorëve	~350.00m ²
Graboc	Pllakë përkujtimore e dëshmorit Faik Mjeku	~1121.79 m ²
	Pllakë përkujtimore e dëshmorit Fejzullah Graiçevci	~77.91 m ²
	Mulliri i ujit (i Behramajve)	~1000.38 m ²
Shipitullë	Monument i luftës (UÇK)	~335.55 m ²
Milloshevë	Xhamia (nga shek.-XVIII)	~374.65m ²
	Shtëpia e Kulturës	~3556.89 m ²
Baimoc	Kisha ortodokse	~1829.05m ²

³Vërejtje: 1. Monumenti Memorial i Gazimestanit dhe 2. Tyrbja e Bajraktarit sipërfaqe prej me 23.00(ha) janë të përfshira, në një zonë të veçantë të mbrojtur.

	Shtëpia e Kulturës	~411.72 m ²
Breznicë	Objekti i AMF-së	~344.80 m ²
	Pllaka përkujtimore për "Hoxhë Breznicën"	~392 m ²
Plemetin	Qendra rinore/ Shtëpi e Kulturës	~365.35m ²
	Pllaka përkujtimore e martirëve të lirisë	57.90 m
Dardhishtë	Shtatorja e atdhetarit "JusufShalaku"	~184.51m ²
	Shtatorja e atdhetarit "Abdurrahman Gërguri"	~96.78m ²
	Pllaka përkujtimore e martirëve të lirisë	~57.71 m ²
Kozaricë	Shtëpia Muze (Shtabi i Zonës Operative të UÇK-së)	~262.64 m ²
Palaj	Mulliri i Palojve	217.64m ²
	Objekti i AMF-së	227.19m ²

Tabela 13 Asetet e trashëgimisë kulturore me vlera lokale

Asetet e Trashëgimisë Kulturore të shpallura nën mbrojtje nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK)

Sipas Ligjit Nr. 04/L-146, për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës, në territorin e komunës të Obiliqit AMKMK, ka përcaktuar statusin e tetë (8) monumenteve nga lufta e fundit nën menaxhimin dhe administrimin e kësaj agjencie.

Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Memoriali i Martirëve të lirisë - Obiliq	X		~234. 34 m ²
Busti i komandantit të UÇK-së " Adem Jashari" - Obiliq	X		~00. 2m ²
Shtatorja e atdhetarit Aziz Zhilivoda	X		~1400. 84m ²
Busti i dëshmorit Fahri Fazliu -Obiliq			~10 m ²
Obelisku i dëshmorit Ferid Currit -Mazgit i Ulët	X		~324. 45 m ²
Lapidari i lirisë - Hamidi	X		~411. 40 m ²
Varrezat e dëshmorëve të UÇK-së - Sibovc	X		~350. 00m ²
Monumenti i luftës së UÇK-së Shipitullë	X		~335. 55 m ²
Pllaka përkujtimore e dëshmorëve Rama-Dardhishtë	X		~380. 52 m ²
Gjithsej:	10		

Tabela 14 Asetet e trashëgimisë kulturore të shpallura nën mbrojtje nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Asetet e Trashëgimisë Natyrore

Veçoritë gjeografike të Komunës së Obiliqit janë të pasura, këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore dhe me peizazhe të bukura natyrore:

Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Trungjet e dushkut, i blirit dhe guri në Sibovc	X		~1478.90 m
Maja e Zezë -Graboc i Epërm		X	~6 (ha)
Bota e kuqe dhe gurët e gjelbër në Graboc të Epërm		X	~2.50 (ha)

Kroi i Mjekiqëve		X	~870.76 m ²
Burimi i ujit mineral në Graboc të Epërm		X	~3.15 ha
Çeshmja e katundit në Palaj		X	~182.13 m ²
Bunari/Çeshmja e Mulla Jahës në lagjen e Hashanëve		X	~185 m ²
Bunari i Pashës		X	~228 m ²
Bunari i Dashnisë			~162.43m
Gjithsej:	9		

Tabela 15 Asetet e Trashëgimisë Natyrore.

Asetet Turistike

Bukuria natyrore, lartësia adekuate, shtigjet e përshtatshme për aktivitete sportive si dhe për fushime kapim në malet e Qyqavicës dhe Kopaonikut (Albanikut) dhe Hotelet me Restorante e bëjnë Komunën e Obiliqit të përshtatshme për zhvillim të turizmit dhe promovimin e trashëgimisë historike/kulturore si dhe asaj natyrore:

Vendbanimi, Emri	Statusi ligjor		Sipërfaqja (ha)
	I mbrojtur	I propozuar	
Zona Hoteliere në Milloshevë-Babimovc	X		
Vendbanimi Graboc i Epërm, trashëgimi kulturore-natyrore		X	38.50 (ha)
Vendbanimi Sibovc, trashëgimi natyrore		X	20.00(ha)
Vendbanimi Kozaricë, trashëgimi natyrore		X	24.50 (ha)

Tabela 16 Asetet Turistike.

Bujqësia

Rreth 48% e territorit komunal është në shfrytëzim për nevoja të bujqësisë që d.m.th. gati gjysma e territorit të komunës së Obiliqit. Prej tyre 6.677 ha janë pronë private dhe 3.854ha janë pronë shoqërore.

Depërtimi i elementeve të klimës mesdhetare përmes luginave të lumenjëve krijon mundësi për rritjen dhe zhvillimin një bimësie të shumtë e të larmishme si ajo e arrave, perimeve, bimëve etero vajore, hardhia etj. Kulturat kryesore bujqësore janë: gruri, elbi, misri, tërshëra, bimët industriale, patatet, dhe perimet.

Nga drithërat, me 1,200 ha në Komunë më së shumti kultivohet gruri, nga pemët, me 150 ha më së shumti kultivohet patatja, me 180 ha nga foragjeret më shumti prodhohet misri i gjelbër dhe nga pemët, ne 8 ha më së shumti prodhohen molla dhe kumbulla.

Drithëra		Perime			Foragjeret							Peme					
Grurë	Misër	Elb	Tërshërë	Patate	Speca	Qepë	Lakër	Presh	Misër gjelbër	Jonxha	Kunguj foragjer	Përzierje bari	Mollë	Kumbull	Lajthi	Vishnje	Mjedër
1,200	1,100	20	20	150	48	6	2	1	180	40	22	10	8	8	5	4	6


Tabela 17 Prodhimtari bujqësore ha

Përshtatshmëria e tokës bujqësore (boniteti)

Komuna e Obiliq ka një tokë bujqësore të kualitetit të lartë, pjesa më e madhe e sipërfaqes mbi 60% i takon përshtatshmërisë së tokës bujqësore klasës I-IV, ndërsa pjesa tjetër i takon kualitetit V-VIII.

Sipërfaqja e tokës bujqësore është 6,852 ha, ndërsa 4,261 ha tokë e punueshme, 74.39 ha janë pemishte, kullosa/livadhe 326.78 ha, djerrina 29.05 ha si dhe 190.3 tokë e zhveshur.

Në Komunë nuk ka tokë bujqësore në pronësi komunale, apo shoqërore, gjersa në pronësi private janë rreth 8,082 ha nga e cila 6,853 ha shfrytëzohen për kultivime bujqësore.




Harta 5. Shtrirja e tokave bujqësore sipas klasave tëbonitetit të tokave bujqësore

Pylltaria

Pyjet, në territorin e Komunës, zënë një hapësirë prej 1.153 ha ose marrin 11% nga sipërfaqja e tërësishme e saj. Në pjesën perëndimore shtrihen pyje të ulëta që mbulohen nga brezi i pyjeve kserotermofile dhe mezotermofile të dushqeve dhe lloje të tjera si: Shpardi-Quercus Frainetto, Qarri - QurqusCerris, Shkoza e zezë Carpinus Orientalis, Ahu - Fagus Moesiaca.

Industria

Komuna e Obiliqit është qendër e zhvillimit ekonomik të sektorit energjetik në Kosovë. Ndër bartësit kryesor të zhvillimit ekonomik në komunën e Obiliqit sot janë prodhimi i energjisë elektrike në Termocentralet TC-A dhe TC-B dhe zhvillimi i aktiviteteve minerare në minierat e thëngjillit. Veprimtarinë ekonomike mbi këtë bazë e ushtron Korporata Energetike e Kosovës - KEK sh.a.. Minierat, TC-të dhe lokacionet e deponive të cilat janë prona të KEK sh.a. Zona e KEK-ut, gjendet mes luginës së lumit Sitnicë në lindje me lartësi mbidetare prej rreth +525 metra dhe një vargmal që zgjerohet në jug me lartësi mbidetare që shkon në +750 metra, kurse në anën perëndimore vazhdon të rrethohet me luginën e Lumit Drenica me lartësi mbidetare të shtrirjes prej rreth +550 metra. Të dyja minierat aktivitetet e tyre i kanë zhvilluar në të njëjtën zonë duke avancuar në drejtime të kundërta. Ngjitur me TC A, gjendet një zonë e braktisur industriale ku kanë qenë në veprim impianti i gazifikimit të thëngjillit dhe azotikut deri para më shumë se 10 viteve.



Harta 6 Shtrirja hapësinore e zonave industriale dhe ekonomike

TC A ka 5 blloqe të cilat janë ndërtuar në dy faza (nga 1962 deri 1964 dhe nga 1970 deri 1975). TC B ka dy (2) blloqe që janë ndërtuar nga 1983 deri 1984. Dy termocentralet janë të ndryshme në kuptim të ndikimeve mjedisore për shkak të dallimit në moshë dhe teknologjisë.

Në vitin 2005 ishte e domosdoshme të ndërmerren masa ristrukturimi, ngase dy mihjet e hapura sipërfaqësore të Bardhit e Mirashit ndërthureshin në masë të shtuar. Që atëherë të dyja mihjet e hapura sipërfaqësore zhvillohen si një minierë e vetme. Sido që të jetë, minierat edhe më tej quhen sipas emrave të tyre origjinal. Kanë filluar aktivitetet minerare në dy miniera të reja në Sibovcin JP (në veri të Bardhit) dhe në sektorin Sitnica, afër fshatit Kryshefc.

Transporti

Rrjeti rrugor në komunë ka një zhvillim shumë të volitshëm që i mundëson lidhje të shpejta me rrugë nacionale dhe rajonale. Nëpër komunën e Obiliqit kalon rruga nacionale që lidhë kryeqytetin, Prishtinën me Mitrovicën, ndërsa brenda territorit të komunës së Obiliqit kalojnë 7.8km të kësaj rruge nacionale. Autoudha "Ibrahim Rugova" e cila ka hyrjen dhe daljen në fshatin Mazgite përshkon qytetin e Obiliqit në pjesën perëndimore të territorit të komunës si dhe përveç lidhjes me Shqipërinë përmes saj bëhet qarkullim më i mirë dhe i shpejtë për në aeroportin "Adem Jashari". Përgjatë territorit të komunës së Obiliqit kalojnë

gjithsej 4.4 km të autoudhës. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe rrugët regjionale të cilat lidhin Obiliqin me komunën e Fushë Kosovës, Podujevës dhe Vushtrrisë. Brenda territorit të komunës së Obiliqit kalojnë gjithsej 21.2 km të kësaj rruge regjionale. Rrugët lokale - lidhin gjithsej 18 zona kadastrale. Nga gjithsej 1,663 segmente rrugore në territorin e komunës së Obiliqit në gjatësi të përgjithshme prej 244.1 km, rrugë të asfaltuara janë 114.123 km. Kurse të trajtuara me zhavorr ose rrugët të rendit të IV-të janë 60 km rrugë nëpër fshatra e lokalitete. Rrjeti rrugor i Komunës së Obiliqit përfshinë autoudhë, rrugët nacionale, rajonale dhe lokale. Përgjegjëse për menaxhim, mirëmbajtje dhe ndërtim të autoudhëve, rrugëve magjistrale dherajonale, është Ministria e Infrastrukturës, ndërsa përgjegjëse për rrugët lokale dhe ato në vendbanime është Komuna.

Kategoria	Përgjegjësi
1 Autoudhë	Ministria e Infrastrukturës
2 Rrugë nacionale	Ministria e Infrastrukturës
3 Rrugë rajonale	Ministria e Infrastrukturës
4 Rrugë kryesore lokale dhe në vendbanime	Komuna

Tabela 18 Kategoritë e rrugëve

Infrastruktura e energjisë elektrike

Në komunën e Obiliqit ka një rrjet i shtrirë mjaft dendur dhe ky rrjet është në pronësi të ndërmarrjeve energjetike të cilat menaxhojnë me rrjetit kombëtar si KEK-ut, KOSTT-it dhe KEDS-it.

Kjo dendësi e rrjetit ka ndikim si në aspektin mjedisor po ashtu edhe vizual, pasi që në këtë komunë ndodhen dy termocentralet:

TC Kosova A 220/110/35 kV

TC Kosova B, 400/220 kV.

Këto nënstacione janë pika te forta të sistemit elektro-energetik të Kosovës, prej nga dalin një numër i madh i linjave 400 kV, 220 kV dhe 110kV.

Pastaj në territorin e komunës së Obiliqit janë të shtrira mihjet sipërfaqësore nga të cilat bëhet furnizimi i termocentraleve me thëngjill, nënstacionet Kosova B dhe Kosova A.

Konsumi i komunës së Obiliqit furnizohet nga nënstacionet 35/10 kV dhe atë: **Mazgiti, Bardhi dhe Fushë Kosova.**

Duhet theksuar se me rrjetin e nivelit energjetik 400/220/110 kV menaxhohet nga KOSTT, ndërsa që rrjeti distributive është nën menaxhim të ndërmarrjes shpërndarëse KEDS. Ndërsa që për furnizimin e mihjeve sipërfaqësore MS Bardhi dhe asaj Mirashi, pastaj furnizimet e pajisjeve për nevoja të elektranave si dhe mbarë konsumin brenda nënstacioneve është nën pronësi të KEK-ut.

Gjendja ekzistuese e rrjetit të transmisionit që shtrihet në komunën e Obiliqit

Rrjeti i transmisionit në komunën e Obiliqit përbëhet nga:

Linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV

Nënstacion 400/220 kV

Nënstacion 220/110 kV

Nënstacionet 110/35) kV.

Linjat 400 kV që kalojnë nëpër komunën e Obiliqit janë:

Linja 400 kV numër 445/1 NS Kosova B-TC Kosova BG1,

Linja 400 kV numër 445/2 NS Kosova B-TC Kosova B,

Linja 400 kV numër 420 NS Kosova B-NS Ferizajt 2,
Linja 400 kV numër 437/1 NS Kosova B-NS Peja 3,
Linja 400 kV numër 407 NS Kosova B-NS Nish,
Linja 400 kV numër 408 NS Kosova B-NS Tiranë.

Linjat 220 kV që kalojnë nëpër komunën e Obiliqit janë:

1. Linja 220 kV numër 2306 NS Kosova B-NS Kosova A,
Linja 220 kV numër 267 NS Kosova B- NS Kosova A.
Linja 220 kV numër 2304 NS Kosova B- NS Prishtina 4,
Linja 220 kV numër 2305 NS Kosova B- NS Prishtina 4,
Linja 220 kV numër 205/1 NS Kosova B- NS Podujeva,
Linja 220 kV numër 2298 NS Kosova B- SSH Drenas,
Linja 220 kV numër 293/1 NS Kosova B- SSH Drenas,
Linja 220 kV numër 290 NS Kosova B-TC Kosova B.

Linjat 110 kV që kalojnë nëpër komunën e Obiliqit janë:

- Linja 110 kV numër 1114 NS Kosova A-NS Prishtina 1,
Linja 110 kV numër 118/1 NS Kosova A-NS Prishtina 1,
Linja 110 kV numër 1139/1 NS Kosova A-NS Prishtina 3,
Linja 110 kV numër 112 NS Kosova A-NS Lipjani,
Linja numër 1807 NS Kosova A-NS Prishtina 5,
Linja numër 1808 NS Kosova A-NS Prishtina 5,
Linja 110 kV numër 1801 NS Kosova A-NS Bardhi.
Linja 110 kV numër 163/1 NS Kosova A-NS Bardhi.
Linja 110 kV numër 125/1 NS Kosova A-NS Vushtrria 2,
Linja 110 kV numër 163/2 NS Bardhi-NS Mitrovica 2.

Nënstacionet 400/220 kV, 220/110 kV dhe 110/35 kV.

1. NS Kosova B 400/220 kV, kapaciteti $3 \times 400 \text{ MVA} = 1200 \text{ MVA}$
2. NS Kosova A 220/110 kV, kapaciteti $3 \times 150 \text{ MVA} = 450 \text{ MVA}$
3. NS Bardhi 110/35 kV, kapaciteti total $3 \times 40 \text{ MVA} = 120 \text{ MVA}$

Energjia termike

Sektori i amvisërisë dhe ai i shërbimeve janë sektorët më të mëdhenjtë të konsumit të energjisë termike. Momentalisht, Komuna e Obiliqit nuk ka sistem të ngrohjes qendrore, dhe rrjedhimisht amvisëritë dhe të tjerët detyrohen të shfrytëzojnë thëngjillin apo drurin si lëndë djegëse për ngrohje. Ngrohja e bazuar në rrymë, në Obiliq përshkak të kostos dhe të intensitetit jo stabil të rrymës elektrike, është rast më i rrallë.

Në drejtim të zgjidhjes së problemit me ngrohjen, Komuna në vitin 2019, ka hartuar një Studim të fizibilitetit për kogjenerimin të ngrohjes qendrore. Studimi i fizibilitetit ka rezultuar se për termofikimin e qytetit të Obiliqit burimi më i përshtatshëm i energjisë termike është ndërtimi i një sistemi **Ngrohtore qendrore dhe Stacion këmbyes**, duke u furnizuar me energji termike nga termocentrali "Kosova B" nëpërmjet sistemit të kogjenerimit.

Në ndërkohë, sipas të gjeturave në Studimin e fizibilitetit, është duke u punuar edhe Projekti për kogjenerimin e ngrohjes qendrore në Obiliq.

Infrastruktura e ujësjellësit

Në Komunën e Obiliqit ekzistojnë dy (2) sisteme vijuese për furnizim me ujë cilësorë të pijes: Sistemi i Batllavës që menaxhohet nga KUR "Prishtina" e që furnizon 70 % të zonës urbane të Obiliqit dhe tetë (8) vendbanime tjera rurale me ujë, një (1) sistem tjetër (puset në "Obiliq i Vjetër") që menaxhohen nga KUR "Prishtina" që furnizon 30 % të zonës urbane të Obiliqit dhe pesë (5) vendbanime tjera rurale, dhe disa vendbanime nga burimet nëntokësore nga bunarët individual, të cilat nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijes dhe nuk janë në përputhje me AI 2/99 MSHMS.

Furnizimi me ujë nga këto dy sistemet është e cilësisë së mirë në këto vendbanime. Sasia e furnizuar, përkundër kufizimeve, është në nivel të kënaqshëm. Reduktimet më të shpeshta bëhen gjatë stinës së verës. Njëri prej shqetësimeve është rrjeti i ujësjellësit në qytet, për shkak të vjetërsisë, dhe ekziston mundësia permanente që uji të kontaminohet.

Vendbanimet e mëposhtme që furnizohen me ujësjellës janë: Obiliqi, Obiliqi i Vjetër, Mazgiti i ultë, Mazgit i epërmi, Millosheva, Llazareva, Bakshia, Baimofci, Breznica, Plemetini, Hamidi, Sibovci, Hade, Dobrosellë, Leshkoshiq, CërkvënaVodicë, dhe Kryshefc.

Furnizimi me ujë në komunën e Obiliqit bëhet përmes Ujësllësit Rajonal të Prishtinës, nga ujësjellësi komunal dhe në disa vendbanime furnizimi me ujë bëhet nga burimet nëntokësore (nga bunarët dhe puset). Furnizimi i vendbanimeve me ujë nga ujësjellësi rajonal i Prishtinës dhe nga ai komunal bëhet në 13 vendbanime apo 72 % të vendbanimeve të komunës. Mirëpo, edhe pse rrjeti i ujësjellësve shtrihet në 13 vendbanime të komunës, megjithatë e tërë popullata e këtyre vendbanimeve nuk furnizohet me ujë nga rrjetet e ujësjellësve.

Sipas informatave nga institucionet komunale të Obiliqit, 95% e popullatës furnizohet me ujë të pijshëm. Në këto vendbanime uji është i kualitetit të mirë. Ujësjellësi komunal ka kapacitet furnizues 42 l/sec. Sasia e furnizimit përkundër restriksioneve është në nivel të kënaqshëm. Restriksionet më të shpeshta janë gjatë sezonit veror. Shqetësim paraqet rrjeti i ujësjellësit në qytet që është i vjetër dhe gjithnjë ekziston rreziku për kontaminimin e ujit të pijshëm.

Furnizimi me ujë nga burimet nëntokësore (bunarët ose puset) bëhet në 5 vendbanime apo 27% të vendbanimeve të komunës. Burimet nëntokësore të ujit për pije (bunarët ose puset) kanë kualitet të mirë të ujit dhe i përgjigjen standardeve minimale për ujë të pijes, përveç në lokalitetet që janë afër stabilimenteve të KEK-ut siç janë Hade, Lajthishtë dhe Hamidi. Vendbanimet të cilat furnizohen me ujë nga puset (bunarët) janë: Sibovc, Hamidi, Hade, Baimofc dhe Breznicë (dhe në Kozaricë).

Sipas institucioneve komunale janë bërë disa investime në shtrirjen dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësve në Komunën e Obiliqit. Ato investime dhe projekte të realizuara janë:

Instalimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Hamidi nga Plemetini me gjatësi 3 km', me donator CDF, viti 2001,

Rrjeti i ujësjellësit CërkvënaVodicë Hade -Leshkoshiq me gjatësi rreth 12 km', donator USAID.

Renovimi i rrjetit të ujësjellësit brenda qytetit të Obiliqit, me gjatësi 2 km', donator CDF, viti 2001/2002,

Rrjeti i ujësjellësit Obiliq, Milloshevë, Raskovë, Bakshi me gjatësi 11 km, donator CDF,

Synim prioritar i komunës është instalimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Sibovc, Breznicë, Kozaricë dhe Baimofc.

Infrastruktura e Ujërave të Zeza

Infrastruktura e rrjetit të kanalizimit të ujërave të ndotura, e cila përfshin tubacionet kryesore, d.m.th. primare, sekondare, pusetat etj., është e projektuar dhe ndërtuar gjatë viteve 1970, 1985, 1990, 2000, 2011, e cila ka përfshirë fillimisht pjesën urbane të qytetit. Sot, punimet për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit bëhen në vazhdimësi. Rrjeti i kanalizimit përveçgrumbullimi të ujërave të ndotura urbane grumbullon

edhe ujërat atmosferike. Shkarkimi i ujërave të ndotura bëhet në tetë (8) pika shkarkuese pa trajtim paraprak në lumin "Sitnicë".

Derdhja e ujërave të zeza-sanitare nëpër sipërfaqe të hapura në ato vendbanime që nuk kanë qasje në rrjet të kanalizimit dhe shkarkimi i ujërave të zeza-sanitare të pa trajtuara në lumenjtë "Llap", "Drenicë" dhe "Sitnicë", janë probleme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Andaj, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza-sanitare, është çështje që kërkon zgjidhje të shpejtë.

Ky rrjet ka shtrirje në 17 vendbanime apo 95% të vendbanimeve të tërë komunës, por në të nuk ka qasje e tërë popullata e këtyre vendbanimeve. Sipas të dhënave nga institucionet komunale të Obiliqit rreth 90% e popullatës ka qasje në rrjetin e kanalizimit. Ky rrjet shtrihet në Obiliq të Ri, Obiliq të Vjetër, Mazgit 1, Mazgit 2, Kryshefc, CërkvënaVodicë, Plemetin, Muzakaj, Raskovë, Bakshi, Llazarevë dhe Baimofc, Sibovc, Kozaricë, Hamidi, Shipitullë, Hade. Rrjeti shumë i vjetër i kanalizimit dhe derdhja e ujërave fekale të papërpunuar në lumin Sitnica, janë probleme që kërkojnë zgjidhje të ngutshme. Andaj renovimi i rrjetit dhe ndërtimi i impiantit për përpunimin e ujërave fekale i cili do të shfrytëzohet edhe nga komunat fqinje, shihen si zgjidhje të këtyre problemeve.

Infrastruktura e varrezave

Në Komunë aktualisht shtrihen gjithsejtë 20 hapësira të varrezave në 14 vendbanime të ndryshme që mbulojnë një sipërfaqe të përgjithshme prej 19.42 ha.

Baimofc	Breznicë	CërkvënaVodicë	Grabofc Epërm	Plemetin	Hade	Hamidi	Kryshefc	Leshkoshiq	Mazgit	Millosevë	Obiliq	Raskovë	Sibovc	Gjithsejtë
0.75	0.8	1.48	0.16	3.05	1.4	0.50	0.75	0.9	1.75	0.78	6.85	0.15	0.65	15.98

Tabela 6 Vendbanimet me varreza dhe sipërfaqja e tyre (ha).

Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Përshkrimi aktual i sistemit të organizuar të menaxhimit të mbeturinave të ngurta komunale, pajisjeve dhe mekanizmi teknik në këtë sektor na shërben për të pasur një pasqyrë të përgjithshme të proceseve që lidhen me llojet e mbeturinave dhe të krijimit të një baze për identifikimin, dhe përcaktimin e aspekteve në të cilat nevojitet të bëhen ndryshime. Përshkrimi i bazuar në informata nga kompania, si dhe nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të të gjithë sistemit të shërbimeve që përfshin operimin, pajisjet, impiantet, kostot dhe cilësinë e shërbimeve që ofrohen. Të gjitha shërbimet që lidhen me mbeturinat e ngurta komunale menaxhohen si shërbime publike në nivel rajonal nga dy kompani:

Kompania rajonale për mbeturina "Pastrimi" në Prishtinë, e cila e menaxhon shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave deri në deponi. Këtë shërbim në nivel lokal e kryen njësi operative e KRM që vepron në Komunë.

Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës KMDK e cila e menaxhon Deponinë rajonale të Prishtinës në Mirash në të cilën deponohen mbeturinat e ngurta komunale që grumbullohen dhe transportohen nga rajoni i Prishtinës.

Organizimi i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale është i bazuar në këto skema:

Hedhja e mbeturinave në pikat e grumbullimit (PGM)

Banorët, bizneset dhe institucionet i hedhin (dorëzojnë) mbeturinat e ngurta komunale si të pandara (pa selektuara) në pikën më të afërt të grumbullimit. Pikat e grumbullimit të mbeturinave janë pajisje adekuate, kontejnerë me vëllim 1.1 m³, shporta prej 120 l ose pajisje jo adekuate siç janë kosha nga llamarina (bure) prej vitit 200 l të vendosura në sipërfaqe të vogla publike, si dhe mënyra e grumbullimit e quajtur “derë me derë” nëpërmes të qeseve të plastikës. Numri i kontejnerëve që disponon kompania në territorin e Komunës është rreth 240, që nuk i mbulon të gjitha pikat për grumbullimin e mbeturinave, gjendja e kontejnerëve nuk është e mirë, janë të vjetruar dhe pjesërisht të shkatërruar. Në pikat e grumbullimit ku janë të vendosur pajisjet për grumbullimin e mbeturinave, shpesh herë ka hedhje të mbeturinave jashtë pajisjeve, si dhe mbushje të tepërta të kontejnerëve për shkak të dinamikës jo të mjaftueshme për zbrazen e tyre.

Shërbimi i grumbullimit menaxhimit dhe transportit të mbeturinave deri në deponi

Mënyra e shërbimit të organizuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është i organizuar në formën e bazuar të zonave të banimit brenda Komunës. Shpeshtimi i grumbullimit, numri dhe lloji i kontejnerëve është i definuar për tre sektorë të banimit: Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit kolektiv dhe qendra e qytetit bëhet për çdo ditë;

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit individual brenda qytetit bëhet një herë në javë dhe;

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponi kryhet gjatë ditës, kompania në disponim i ka dy kamionë special, sasia ditore e mbeturinave komunale të grumbulluara dhe transporti i tyre në deponi është rreth 15.500 kg. ose 341.000 kg. për një muaj. Në sistem të mbledhjes së mbeturinave përfshihet e gjithë komuna me 18 fshatra në sistem individual dhe atë kolektiv. Të gjitha shërbimet që lidhen me mbeturinat e ngurta komunale menaxhohen si shërbime publike në nivel rajonal nga dy kompanitë vijuese:

4. Kompania rajonale për mbeturina (KRM) “Pastrimi” në Prishtinë, e cila e menaxhon shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave deri në deponi; dhe Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës (KMDK) e cila menaxhon deponinë rajonale të Prishtinës e ndodhur në fshatin Mirash, në të cilin deponohen mbeturinat e ngurta komunale që grumbullohen dhe transportohen nga rajoni i Prishtinës.

Në sistemin e organizuar të ofrimit të këtij shërbimi janë të përfshira nëntë (9) vendbanime ose 1085 ekonomi familjare, nëse shprehet në përqindje i bie 45 % e vendbanimeve, ose 20 % e ekonomive familjare. Në vijim po i paraqesim informacionet për vendbanimet e mbuluara me shërbim të organizuar, % e ekonomive familjare të mbuluara me këtë shërbim, dinamikën dhe sasinë e mbeturinave që deponohen në deponi.

Në njëmbëdhjetë (11) vendbanime tjera ku nuk funksionon shërbimi i organizuar i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, hedhja e mbeturinave bëhet nëpër lëndina, hapësira të pashfrytëzuara, për gjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale dhe si pasojë e këtij veprimi vjen deri të krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin. Deponia rajonale e Prishtinës gjendet në Mirash në minierën e shterur të linjtit, e cila është e dizajnuar dhe ndërtuar si deponi sanitare e tipit rajonal që me shërbimet e deponimit të mbeturinave i mbulon këto komuna: Prishtinën, Lipjanin, Obiliqin, Drenasin dhe Fushë-Kosovën. Deponia ka një sipërfaqe prej 50 ha. Deponia është në një gjendje jo të mirë, e cila nuk plotëson standardet elementare.

Në njëmbëdhjetë (11) vendbanime tjera ku nuk funksionon shërbimi i organizuar i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, hedhja e mbeturinave bëhet nëpër lëndina, hapësira të pashfrytëzuara, për gjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale dhe si pasojë e këtij veprimi vjen deri të krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin. Deponia rajonale e Prishtinës gjendet në Mirash në minierën sipërfaqësitë të shterur të linjtit, e cila është e dizajnuar dhe ndërtuar si deponi sanitare e tipit rajonal që me shërbimet

e deponimit të mbeturinave i mbulon këto Komuna: Prishtinën, Lipjanin, Obiliqin, Drenasin dhe Fushë-Kosovën, ka një sipërfaqe prej 50 ha me kohë zgjatje për 15 vite, kapaciteti total i deponisë është 3.5 milionë m², ndërsa kapaciteti mujor 6000 t. Deponoja e posedon edhe lagunën për ujëra të zeza në kapacitet prej 4000 m³.

Deponinë rajonale të Prishtinës në Mirash e menaxhon Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës e regjistruar si kompani aksionare me emrin Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh. A. - Prishtinë.

Në përgjithësi deponitë sanitare të menaxhuara nga KMDK sa i përket gjendjes së tyre nuk kanë ndryshime të mëdha ndërmjet vete dhe pa përjashtim janë në gjendje të keqe, si pasojë e mos menaxhimit të duhur të tyre, e sidomos në gjendje të vështirë është deponia në Mirash. Arsyeja kryesore, por jo e vetmja, është se KMDK nuk ka mundur të i arkëtoj në tërësi borxhet nga KRM, të cilat kanë pjesëmarrje të madhe në biznesin e KMDK.

Ndërmarrja ka pesë (5) punëtorë në deponi, që punojnë me një buldozer total të amortizuar. Mbetjet transportohen nëpërmjet një rruge të vogël të deponisë, shkarkohen aty dhe shpërndahen me buldozer. Shumë pjesë të deponisë nuk janë të disponueshme, si rezultat i përmytjes. Punëtorët thjesht i mbulojnë këto zona duke hedhur mbetje të tjera mbi to. Nuk ekzistojnë pajisjet bazë dhe makineritë, siç është për shembull kompaktori (ngjeshësi).

Performanca mjedisore e deponisë është katastrofike për shkak të çdo aspekti të emetimeve potenciale. Mjedisi rrethues i deponisë vuan nga ndotja e mbetjeve, liqeta që rrjedh nga deponia në ujërat nëntokësorë, emetimet e pakontrolluara të biogazrave, e gjithashtu vetë ndezjet janë bërë dukur e shpeshtë në deponi në kohë të thatë të verës, duke shkarkuar përqendrime të larta të gazra të ndryshme që shkaktajnë dioksina dhe furane të llojllojshme.

Analiza SWOT

Analiza SWOT

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundësi për përmirësim.

Zonat me Probleme Mjedisore

Ky seksion bënë një përmbledhje të analizës së mësipërme të kushteve mjedisore në Obiliqit dhe vë në dukje:

- Zonat që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor (zonat rreth termocentraleve dhe deponive të hirit);
- Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilave mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, nëse nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

Diskutim i grupeve të faktorëve në analizën SWOT.

Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor

Të gjithë lumenjtë dhe prrockat, vuajnë degradim dhe ndotje mjedisore të shkaktuar nga Termocentralet (TC) sidomos nga fenolet dhe depozitimi i vazhdueshëm i mbetjeve të ujërave industriale dhe nga ujërat e zeza dhe i lëndëve të ngurta. Pastrimi i lumenjve të Obiliqit kërkon një menaxhim më të mirë të mbetjeve të ngurta si trajtim i ujërave industriale nga (TC) izolim i mënjëhershëm i deponive të hirit deri në rehabilitimin përfundimtar të tyre, sidomos në vendbanimet e mëdha, si dhe sigurimin e kolektorëve të duhur gjatë rrugës.

Nëse nuk kontrollon rritja e numrit të automjeteve dhe nuk ndërmerren masa për të përmirësuar rrugët, standardet e karburanteve dhe të shkarkimeve, atëherë rritja e parashikuar me katër herë më shumë e mjeteve do të ketë pasoja në cilësinë e ajrit. Masat e ndërmarra nga Qeveria për reduktimin e makinave të vjetra nëpërmjet taksimeve dhe rënia e ritmit të ndërtimeve kanë dhënë efekte pozitive në ndotjen e ajrit, por janë të pamjaftueshme për të siguruar cilësi të ajrit dhe nivel të zhurmave brenda standardeve.

Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore

Bazuar në të gjitha informatat të cilat janë marrë nga kjo fushë me theks të veçantë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës dhe grupi punues për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis nga komunat e Obiliqit kjo fushë (trashëgimin natyrore) analizuar në fazë e analizës së gjendjes dhe parashikohet që: Zonat me vlera natyrore, të ruhen, mbrohen dhe konservohen dhe zhvillohen me projekte kryesore sipas normave për këto zona si peisazhet, habitatet dhe llojet organike që jetojnë në këto zona. Parashikohet që trungjet e vjetra dhe monumente geomorfologjike të shpallën të mbrojtura, të ruhen sensibilizohen, mbrohen dhe konservohen.

Argumente të Analizës SWOT

Përparësitë

Duke qenë se komuna e Obiliqit vuan shumë nga ndotja që vjen si rezultat i industrisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe duke u bazuar edhe në dokumentet e planifikimit nga fusha e mjedisit në komunën e Obiliqit, ekzistojnë hulumtime të natyrave dhe fushave të ndryshme të cilat janë bërë edhe në të kaluarën edhe tani ka një inventarizim bukur të mirë të identifikimit të problemeve mjedisore, ka analiza ndotje të ajrit për ujrat dhe për ekosisteme (nga studentët) ka strategji të zhvillimit ekonomik, analizë hapësinore, plane dhe projekte të zhvillimit komunal dhe mbrojtje të mjedisit si dhe këtë dokument VSM) i cili analizon në mënyrë sistematike ndikimet potenciale mjedisore nga aplikimi i Hartës Zonale Komunale. Duke qenë komunë me një traditë në industrinë e prodhimit të energjisë elektrike, eksploatimit të thëngjillit, por edhe me bujqësi poashtu mjaft të zhvilluar, kjo komunë është në avantazh për shkak të pozitë së saj që afër kryeqendrës Prishtinës, por edhe vetë si komunë si zona ekonomike dhe sociale me potenciale të konsiderueshme të zhvillimit ekonomik, komunikimet (rrjeti nacional dhe ndërkombëtare i infrastrukturës). Pika të forta janë edhe prezenca e kapaciteteve të zhvilluara intelektuale, kapacitetet rinore. Kemi edhe për çdo ditë e më shumë instalimin e teknologjive inovative dhe reduktim të dukshëm të industrive ndotëse. Legjislacioni mjedisor është drejt përafrimit me atë të Bashkimit Europian.

Dobësit

Si pikë e dobët e kësaj komune siç dihet është ndotja në nivel shumë të lartë i të gjitha komponenteve mjedisore dhe popullatës njerzore të Obiliqit dhe komunave për rreth edhe më gjer. Obiliqi si shumica e komunave të Kosovës vazhdon të ballafaqohet me zbrazje të disa vendbanimeve në për shkak të aktivitetit minerar dhe industrial në ato zona dhe presion zhvillimi në disa vendbanime përgjat rrugëve nacionale dhe rajonale. Zbrazja e këtyre vendbanimeve dhe ndikimi i presionit të rritjes dhe zhvillimit në disa vendbanime tjera determinohen kryesisht me mungesën e vendeve të punës, papunësisë mungesa e shërbimeve dhe kulturës së jetesës, faktorë që duhen të manaxhohen.

Në planin administrues niveli i ulët i aftësive në segmente të administratës lokale ngadalëson kapacitetet manaxheriale. Probleme me pronën private të truallit sidomos në zonat ku është planifikuar të bëhet eksploatimi i thëngjillit, privatizimet, prania e hot spoteve mjedisore deponitë e mbeturinave dhe në pikat tjera, mungesa e zbatimit korrekt të legjislacionit, veçanërisht atij mjedisor, krahas zhvillimeve të pa kontrolluara gjate dy dekadave të fundit, janë pjesë e pikave të dobëta në këtë analizë. Pika të dobëta vazhdojnë të mbeten mangësitë në trajtimin e trashëgimisë kulturore, arkeologjike, të ndërtuar dhe natyrore, infrastrukturës, veçanërisht në furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimi i ujërave të zeza, mungesa e pastrimit të ujërave të zeza, dhe atyre industriale që vinë nga TC, menaxhimi i dobët i mbetjeve komunale, etj.

Mundësitë

Mundësitë e Obiliqit janë të mjaftueshme pasi që është në zonë qendrore të Kosovës, afër kryeqendrës Prishtinës, ka zonën industriale të prodhimit të energjisë elektrike si dhe mbështetjen e mundshme të donatorëve dhe qeverise, është e mundur që komuna të

vazhdoj të hartojë dhe zbatojë plane, programe dhe iniciativa të tjera për zhvillimin e studiuar të pjesëve të trajtuar me këtë Plan Zhvillimor Komunal dhe trajtuara si zona për shfrytëzime të ndryshme, trajtimin e hapësirave të zgjeruara ndërtimore të parapara me planë, hapësirave pyjore, peizazheve atyre rekreative dhe përmirësimin e treguesve mjedisorë, vendosja e filtrave në tymtarët e TC-ve. Në Planin e Zhvillimit Komunal është e mundur të rritet ndjeshëm aplikimi i Ligjeve dhe Vendimeve të Kuvendit Komunal në favor të mjedisit dhe shëndoshjes së financave publike komunale. Me qëllim të rritjes së hapësirave publike rekreative është e rekomanduar inkurajimi i biznesit privat në hapësirat rekreative (parqe, salla lojërash, fusha sporti, sipërfaqe për fëmijët). Rritja e cilësisë së transportit publik është një mundësi që duhet të zhvillohet.

Kërcënimet

Mos trajtimi i vendosja e filtrave të tymëtarëve, mos trajtimi i deponive të hirit), mos trajtimi i zonave të mbrojtura mundë të shkaktoj kërcënime serioze mjedisore dhe shëndetësore në komunën e Obiliqit dhe rrethinë.

Humbje e vlerave natyrore, rekreative, shkencore dhe turistike, vendbanime të tëra të mbesin pa asnjë banor, kostoja e shërbimeve të ngritët deri në shkallën që shkakton trazira sociale dhe ekonomike. Problemi i pronësisë së tokës sidomos mungesat e pronave komunale për zhvillime përbejnë një grup problemesh shqetësuese ndikimi i të cilëve do të vazhdojë gjatë. Nëse bazohemi në faktin se blerja e sipërfaqeve për parqe, hapësira shlodhëse kërkon financime të mëdha dhe në kontekstin e buxheteve jo të mëdha të Obiliqit përbejnë një tjetër kërcënim.

Harta Zonale Komunale

Qëllimi i Hartimit të Hartës Zonale Komunale

Harta Zonale Komunale për Komunën e Obiliqit është një dokument me karakter rregullues hapsinor që ka si qëllim të përcaktojë dhe të organizojë zhvillimin urban dhe territorial të kësaj komune. Kjo hartë krijon një planifikim strategjik për zonat e caktuara në Obiliq dhe vendos kushtet e zhvillimit, si dhe kushte të tjera specifike për secilën zonë.

Qëllimi kryesor i hartës zonale komunale është të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm dhe të koordinuar të territorit të Komunës së Obiliqit. Përmes hartës, autoritetet vendore dhe komuniteti vendas kanë mundësinë të planifikojnë dhe të drejtojnë zhvillimin e territorit në mënyrë të qëndrueshme, duke i ndarë zonat në mënyrë të arsyeshme dhe duke përcaktuar kushtet e zhvillimit për secilën prej tyre.

Nëpërmjet Hartës Zonale Komunale, përcaktohen zonat e banuara, zonat industriale, zona bujqësore, zona tërheqëse për turizëm, si dhe zona të tjera të rëndësishme për zhvillimin urban. Për secilën zonë, hartë e caktuar përcakton kushtet e zhvillimit, të cilat mund të jenë në lidhje me lartësinë e ndërtimit, destinacionet e lejuara për ndërtim, përfitimet publike, infrastrukturën e nevojshme dhe të tjera rregulla të veçanta.

Harta Zonale Komunale ndihmon në organizimin e territorit, duke i dhënë orientime të qarta për planifikimin urban dhe zhvillimin e ndërtimit. Ajo siguron koherencë dhe konsistencë në rregullimin hapsinor të territorit, duke ndihmuar në parandalimin e ndërtimeve të parregullta dhe të paplanifikuara.

Gjithashtu, Harta Zonale Komunale ndikon në promovimin e zhvillimit ekonomik dhe social të Komunës së Obiliqit. Përmes planifikimit të qëndrueshëm të zhvillimit urban dhe të drejtimit të investimeve në zonat e caktuara, hartë e caktuar krijon mundësi për rritjen e infrastrukturës, krijimin e vendeve të reja të punës dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së komunitetit lokal.

Me përfundimin e Hartës Zonale Komunale, autoritetet vendore dhe komuniteti vendas kanë një instrument ligjor dhe planifikues të rregulluar për të drejtuar zhvillimin e territorit në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. Harta Zonale Komunale është në shërbim të qëllimit të përgjithshëm të mirëqenies së përgjithshme të komunitetit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Komunës së Obiliqit.

Shkalla që HZK-ja Ndikon në Planet e Tjera

Harta Zonale Komunale si një dokument me karakter Rregullativ dhe strategjik multsektorial ku përfshihen gjitha fushat si dhe ndërveprimet dhe sinergjitë mes tyre vlerësohet të ketë pasur një vështrim të plotë të planeve sidomos të PZHK-së aktuale e cila është akoma në fuqi si dhe planeve të ndryshme të cilat janë zhvilluar në nivel të Kosovës ose Planeve dhe Projekteve të cilat janë bërë më herët në Komunën e Obiliqit si për Planin hapësinor për zonën me interes të veçantë " fusha e mihjes së re". Të gjitha këto planet e më hershme si ato para viteve të 90-ta ashtu edhe Planet Rregulluese Urbanistike për zonën urbane janë marrë në shqyrtim dhe vlerësohet se gjendja në terren ka ndryshuar si rezultat i aktivitetit në ndërtim.

Disa nga aspekte Kryesore të Gjendjes Aktuale Mjedisore

Duke u bazuar në gjitha vështrimet tona nga të më hershme por edhe nga këto të dhëna më poshtë duke ju referuar gjendjes mjedisore të tanishme në komunën e Obiliqit. Qëllimi kryesor i diskutimit të dhënave bazë është të identifikojë gjendjen mjedisore në ballafaqim me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të HZK-së Obiliqit. Impaktet potenciale të zhvillimit të HZK-së mund të vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e Planit nëpërmjet indikatorëve të gjendur/të supozuar sasiorë ose cilësorë. Esencialisht, gjendja mjedisore në komunën e Obiliqit karakterizohet nga përshkrimi i receptorëve mjedisore, siç kërkohet nga Direktiva e VSM, të përshkruara më poshtë:

- Popullsia dhe Shëndeti publik;
- Biodiversiteti, Fitodiversiteti dhe Zoodiversiteti;
- Zonat e mbrojtura të natyrës;
- Cilësia e ajrit
- Bezdisjet si zhurma, kundërmimi pamjet e vrazhda etj.;
- Faktorët klimatikë, ndryshimet klimatike;
- Uji në përgjithësi;
- Toka bujqësore dhe peizazhi;
- Asetet materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);
- Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike)

Popullsia dhe Shëndeti publik

Zhvillimi i popullsisë është një fushë mjaft me rëndësi për planifikime dhe zhvillime të ardhshme. Të gjitha zhvillimet në hapësirë bëhen në interes të vetë popullatës. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës, duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme. Në bazë të rezultateve preliminare të regjistrimit të popullsisë numri i banorëve në Komunë është rreth 26,000 banorë. Sipas të dhënave të zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës⁴ të vitit 2011, Komuna e Obiliqit ka 20 vendbanime, ku jetojnë 21.549 banorë.

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe vendbanimit, Prishtinë, 2013

Shëndeti

Ndikimet në shëndetin e banorëve relevante për VSM, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë (komponentë mjedisorë të tilla si ajri, uji apo tokë nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit me njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para së gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisorë. Dendësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja e hapësirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, përkeqësimin e parametrave mjedisorë të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit.

Ne komunën e Obiliqit, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF dhe QMF. Ndërsa ato sekondare ofrohen nga QKUK Prishtinë.

Çështje Ekzistuese Mjedisore të Lidhura me Popullsinë dhe Shëndetin

Një gamë çështjesh, si më poshtë, janë identifikuar që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Mbrojtja e shëndetit publik nga sëmundjet që vijn si rezultat i ndotjes së lartë
- Mbrojtja e mbulesave vegjetative;
- Mbrojtja e korridoreve të qarkullimit të shtazëve dhe bimëve;
- Mbrojtja e zonave të llojeve të bimëve mjekuese;
- Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;
- Ruajtja e burimeve të ujit dhe kaptazheve;
- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zoonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;
- Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore të pellgut;
- Ndërtimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të zeza si dhe menaxhimi i mbetjeve.

Veçori Natyrore Kryesore të Komunës dhe Zonat që Ndikohen

Në kapitullin e gjendjes ekzistuese është elaboruar mjaftueshëm sa i përket veçorive natyrore të komunës së Obiliqit.

Me rritjen e standardit jetësor dhe teknologjik është paraqitur nevoja për më shumë energji në gjithë vendin në raport me eksploatimin e thëngjillit dhe shfrytëzimit të hapësirave të reja për eksploatim të thëngjillit, kështu ka ardh deri tek zvogllimi i territorit të Obiliqit për zhvillime tjera. Zhvillimet dhe ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara nga ndotja dhe nga ndikimi i madh që vien nga TC-të e KEK-ut. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcënuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustron në disa nga shifrat që mundë të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytëzimi i tokës në vitet e më hershme dhe

tani (shih tabelën e shfrytëzimit të tokës). Poashtu toka shfrytëzohet në mënyr racionale shumëfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të toke bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethe, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një tërësie peizazhesh e gjelbërimi.

Zoonimi i territorit të komunës së Obiliqit

Bazuar në veçanti si koha e zhvillimit, tipologjia e vendbanimeve, arkitekturën, popullsinë, infrastrukturën shoqërore, gjeomorfologjinë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Obiliqit. Gjatë zonimit vërehet qart se janë rrespektuar gjitha normativat ligjorë ku e detyrojnë përtorimin e standardeve të zonimit sipas nomenklaturës HILUCS dhe HSRLC, ndërsa me HZK janë trajtuar si më poshtë:

Zonat e ndërtimit në vendbanime:

- Zonat e zhvilluara me ndërtim:

Duke u bazuar në normat e planifikimit hapësinor HZK ka identifikuar dhe trajtuar zonat ku është duke u zhvilluar ndërtimi sot nëpër vendbanime siç shihet edhe nga harta e Zhvillimeve Hapësinore në HZK.

- Zonat e pazhvilluara me ndërtim:

HZK-ja me kujdes ka identifikuar dhe trajtuar duke u bazuar në trendët demografike të paraqitura në HZK, informatat e pleshmërisë së tokës pasurive nën e mbitokësore dhe informatat mjedisore edhe zonat ku mundë ndërtohet në të ardhmen nëpër vendbanime siç shihet edhe nga harta e Zhvillimeve Hapësinore në HZK.

- Zonat turistike

HZK ka identifikuar dhe jep kushte të gjithë llojet e turizmit të mundshëm në komunën e Obiliqit të prezantuar në hartën e turizmit në veçanti turizmi industrial dhe ai kulturor.

Zona të Mbrojtura

HZK-ja ka evidentuar gjithashtu zonën ku përfshihen zonat karakteristike me vlera të trashëgimisë kulturore - historike, peizazhike, mjedisore e turistike të Komunës. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat cenojnë identitetin e zonës. Objektet ekzistuese të zonës mund të restaurohen vetëm në kushte të cilat i japin institucionet kompetente, duke mos cenuar identitetin e tyre të shpallën të interesit komunal me HZK.

Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industriale

Përgjithësisht zona industrial planifikohet të jetë lokale, regionale dhe ndërkombëtare dhe do zhvillohen kryesisht ku tashmë është krijuar një bërthamë e një zone industriale ose aty ku vërtet ekzistojnë kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio-ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me HZK dhe propozuar masat mjedisore.

Pyllëzimi, Zhvillimi i Pyjeve, Zonat e Gjelbërta dhe Rekreative

Zhvillimet në komunën e Obiliqit nuk janë shoqëruar edhe me zhvillimin rritjes së fondit të gjelbërt apo hapësirave të gjelbërta, pyje të reja, krijimin e zonave rekreative. Në të vërtetë, shumë nga zonat pyjore, hapësirave të blerta dhe hapësirat rekreative janë cenuar

deri te shkalla e zhdukjes si pasojë prerjeve ilegale, djegieve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës, sipërfaqe të mëdha të cilat shfrytëzohen për eksploatim te thengjillit. Hapësira pyjore dhe masat janë planifikuar në HZK. Deri tani shumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund “të dilet për të pushuar” në vendbanime. Kohët e fundit janë bërë përpjekje për të përmirësuar gjendjen në komunë dhe rifituar hapësirat pyjore, zhvillim të pyjeve ekzistuese dhe hapësira tjera të blerta në vendbanime. Në HZK dy objektiva janë esenciale:

- (I) Rritja e hapësirave të gjelberta me drunjë të lartë dhe stabil të përshtatshëm për zonat me ndotje të lartë industriale në gjithë territorin e Obiliqit.
- (II) Sigurimi i korridoreve të gjelbërta që do të zhvillohen të bashkëshoqëruara me ndërtimin e rrugëve të reja dhe atyre ekzistuese, korsive për këmbësorët dhe biçikletat dhe tampon zonave të zhvillimet industriale për gjatë zonave të TC-ve.

Çështje Mjedisore që Lidhen me Mjedisin Fizik

- Rehabilitimi i zonave të deponive të hirit qoft me masa biologjike apo me eliminim të tyre, zonave ku eksploatimi llogaritet i terminuar.
- Zhvillimi i hapësirave të rrezikuara nga erozioni të prezantuara në HZK me hartën e erozionit (erozioni i fortë) duhet të ndalohet rreptësishtë në të gjitha planet në vazhdim
- Zonat në të cilat ka shkarje rrëshqitje të dheut të merren masa teknike;
- Zhvillimi i zonës industriale zona e TC-ve duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hapësirat e banimit dhe me tamponet të gjelbërta si masa biologjike;
- zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas rivlerësimeve mjedisore;
- Zhvillimi i Pyjeve, hapësirave të gjelbërta, shiritave gjelbërues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan në Hartaën Zonale Komunale dhe në planet Rregulluese të Hollësishme dhe projekte duke vlerësuar raportet e ndërtimit.

Biodiversiteti, Flora dhe Fauna

Obiliqi si komunë industriale e prodhimit të energjisë elektrike po përballet me problemin e humbjes së biodiversitetit sidomos të llojeve organike të zvarranikëve dhe gjitarëve po ashtu edhe llojet bimore. Faktori kryesor që ka shkaktuar kërcënim serioze për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore padyshim është faktori njeri, ndërkaq shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit në masë të madhe dhe ujit dhe gjuetia e pakontrolluar janë vetëm disa nga faktorët tjerë që vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë më të madhe ekosistemin natyror është një nga problemet me emergjent për natyrën e Obiliqit.

Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre ka ardhur kryesisht si pasojë e shfrytëzimit pa kriter të zonave pyjore deri te “zhveshja komplet e disa pjesëve.

Sipas shënimeve të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe atë: Burim i ujit mineral në Graboc të Epërm Burim/krua në qendër të fshatit Caravadić (Palaj); Trung druri i vetëm bliri (*Tilia spec.*), i vjetër rreth 200 vjet, në lagjen Nicak (Sibovc), dhe Grup trungjesh

druri të bungut (3x Quercus spec., 1x Quercus cerris), diku rreth 300 vjeçar, në lagjen e Megjuanëve (Sibovc).

Tipet e Habiteteve

Disa nga habitatet në komunën e Obiliqit janë të klasifikuara të mbrojtura në nivel qendror dhe lokal (disa zona të identifikuara me HZK). Ato klasifikohen si më poshtë:

- Pyjet dhe zonat e mbrojtura natyrorë;
- Ligatinat;
- Lumenj;
- Kullosat;
- Livadhe

Çështje Mjedisore të Lidhura me Biodiversitetin, Florën e Faunën

Ka mjaft kërcënime potenciale në menaxhimin e biodiversitetit, florës dhe faunës të komunës së Obiliqit. Çështjet në vijim janë identifikuar për zhvillim të mëtejme:

- Ekosistemet ujore (lumenjt “Sitnica”, “Drenica” dhe “Llapi”) të gjithë këta lumenj vuajn nga ndotja shumë e lartë sidomos lumi Sitnica nga prania e fenoleve dhe ujrave tjer industrial. poashtu janë të fragmentuara, të degraduara dhe, siç janë, kanë humbur habitate për specie të rëndësishme për vendin. Gjendja e tanishme nuk siguron dot nivele të pranueshme të habitateve natyrorë;
- Rritja e volumeve të ujit sipërfaqësor për pasojë ndërtimeve dhe deponimit të mbetjeve të ngurta në zonat e vendbanimeve. Kjo mund të rritë përmbytjet dhe/ose erozionin duke shkaktuar humbje direkte të habitateve;
- Masa për të ruajtur biodiversitetin duke i marrë në konsideratë, në fazat e hershme, në plane të reja zhvillimi;
- Koordinimi me njësi të tjera të qeverisë qendrore me qëllim sigurimin e një brezi të gjelbërt rrugëve nacionale dhe rajonale.
- Janë shumë të nevojshme ndërtimi i “urave ekologjike” për mbi kalim ose nënkallim të rrugëve nga shtazët në mënyr që komunikimi i shtazëve të realizohet nga një ekosistem në tjetrin.

Planifikimi i Përdorimit të Tokës dhe Çështje të Sigurimit të Shërbimeve

Për të vlerësuar tokën si burim natyror i pa rinovueshëm dhe rolin që ka në hapësira banimi fillimisht po japin definicionin dhe funksionet bazë të saj. Toka përcaktohet si pjesa e sipërme e kores tokësore, veçanërisht komplekse, që luan rol të rëndësishëm në mjedis në zhvillimin social dhe ekonomik të cilat janë vitale për jetën. Direktiva kuadër e tokës (BE) identifikon shtatë funksione bazë të saj të cilat janë:

- Prodhimi i biomasës, përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë;
- Mbajtjen, filtrimin dhe transformimin e ushqyesve, substancave dhe ujit;
- Mbajtëse e biodiversitetit;
- Mjedis fizik dhe kulturor për njerëzit dhe aktivitetet humane;
- Burim materiale;

- Si depozitë karboni;
- Arkiv për trashëgiminë gjeologjike dhe arkeologjike.

Shumë nga zhvillimet e fundit në komunën e Obiliqit nuk kanë bërë një përdorim të efektshëm të tokës. Shumë nga zhvillimet e paplanifikuara nëpër vendbanime, mund të thuhet se i kanë përkeqësuar problemet e infrastrukturës dhe kanë çuar në degradim mjedisor. Shumë nga kanalizimet e furnizimit me ujë dhe të ujërave të ndotura tashmë gjenden në tokë me pronësi private, për të cilat të drejtat e kalimit e përdorimit nuk janë plotësisht të përcaktuara, duke e kufizuar kështu mundësinë e hyrjes për mirëmbajtje.

Gjithashtu, pa ndonjë plan, apo edhe vlerësim të resurseve, janë aprovuar shumë projekte të reja. Nuk është e qartë se a është bërë vlerësimi i furnizimit të mjaftueshëm me ujë dhe energji i këtyre zhvillimeve të reja.

Komuna duhet të siguroj infrastrukturën dhe shërbimet për vendbanimet. E kombinuar me një kërkesë për infrastrukturë dhe mobilizim më të dobët të resurseve financiare, kushtet mjedisore në komuna vazhdojnë të jenë një problem.

Si truall ndërtimi toka në territorin e komunës merr një rëndësi të posaçme; për efekt të mungesës së fondeve dhe planifikimeve, për gjatë 20 vjetëve të fundit, toka pronë publike është zvogëluar dhe prona private po dominon. Ritmet e çmimit të sipërfaqeve të konsideruara si truall kanë qenë të larta. Statuti privat dhe çmimi vështirëson sot komunën e Obiliqit të gjejë hapësira për vepra publike. Kjo do të vazhdojë edhe më tutje duke kufizuar shpesh implementimin e HZK-së në vepra publike (rrugë, lulishte, parqe).

Çështje Mjedisore që Lidhen me Përdorimin e Tokës

- Përdorimi i tokës për ndërtim është në rritje dhe raporti ndërtim/sipërfaqe e gjelbërt është i disfavorshem duke krahasuar me normat europiane për entitetet me specifika të njëjta;
- Planifikimi i zonave ndërtimore nuk duhet të prekë sipërfaqe të gjelbërta veç në raste të jashtëzakonshme dhe duke i rikompensuar ato, nuk duhet të planifikohet shtrirja në drejtim të zonave të mihjeve të planifikuara;
- Harta Zonale Komunale parashef masa specifike për zonat me përdorim apo shfrytëzim të përzier për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve nga zhvillimet biznesore të cilat zhvillohen në këto zona.

Duke pasur parasysh këto specifika, ne kapitullin 7 paraqiten masa të përshtatshme për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra. Për me tepër, në seksionin 7.4 paraqiten kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin e ndërtimeve, që përfshijnë kriteret e forta mjedisore-shëndetësore, kriteret e trashëgimisë kulturore, kriteret peisazhike dhe ato inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Rreziqet Natyrore në Mjedisin Fizik

Komuna e Obiliqit rrezikohet nga tërmetet. Mbështetur në hartat e rrezikut sizmik në formë probabilitare, komuna përfshihet në zonën, ku lëkundjet e tokës që janë me intensitet 7 dhe 8 ballë Merkal (PGA=0.2 g).

Me rritjen e ndërtimit dhe degradimit të pyjeve, rreziku i përmbytjeve do të rritet shumë.

Kjo gjë përshkruhet më poshtë ne seksionin mbi menaxhimin e mbeturinave të lëngshme dhe ujërave nga reshjet.

Adaptimi dhe Zvogëlimi i Rrezikut të Katastrofave, përmirësimi i informacionit dhe reagimi për zbutjen e efekteve të çdo katastrofe natyrore duhet parë me prioritet edhe atë në funksion të:

- Menaxhimit të Rrezikut të katastrofës;
- Forcimit të shërbimeve hidrometeorologjike;
- Caktimit të kodeve të ndërtimit për aktivitetin sizmik;
- Sigurimin e individëve dhe bizneseve nga katastrofat natyrore.

Cilësia e Ajrit

Është e lidhur në mënyrë përmbajtjesore me shëndetin e njeriut, me zhvillimin industrial, (Termocentralet), djegia e karburanteve, fosileve si dhe rritja drastike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit në qytetin e Obiliqit dhe vendbanimet tjera, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze. Paralelisht me problemet shëndetësore si rezultat i ngrohjes globale paraqesin brenga të mëdha sociale.

Për pos ndikimeve të mëdha në ajër që vinë nga zhvillimet industriale në këtë komunë, në mënyrë të përmbledhur po rendisim disa subfaktorë të cilat kanë ndikim në cilësinë e ajrit në komunën e Obiliqit si:

- Mungesa e transportit publik;
- Mungesa e ngrohjes së qytetit;
- Rritja e lartë dhe përdorimi i në çdo kohë i makinave private;
- Shumica e automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje me Euro I apo II;
- Një pjesë e madhe e tyre punojnë me naftë dhe një pjesë e madhe e tyre janë të prodhuara në vitet e 80-ta dhe 90-ta dhe janë të amortizuara;
- Nga të gjitha rrugët që kalojnë nëpër territor të komunës së Obiliqit, shumica janë të asfaltuar;
- Djegiet e mbeturinave në deponitë e egra;
- Djegia e thëngjillit vetvetiu dhe përdorimi i tij për ngrohje;
- Djegiet e pyjeve dhe mbetjeve të biomasës.

Një tjetër problem që lidhet me cilësinë e ajrit është edhe cilësia e karburanteve që përdorin automjetet. Shumë gjeneratorë me naftë që përdoren për të kompensuar ndërprerjet e energjisë janë gjithashtu kontribuues në këtë cilësi të dobët të ajrit, mbasi punojnë me naftë të cilësisë së dobët. Megjithatë lidhur me këta të fundit, ndikimi i tyre në cilësinë e ajrit të komunës së Obiliqit, përfshirë zhurmat, është minimal.

Zhurma dhe Kundërmimi (Bezdisjet)

Zhurma dhe kundërmimi janë gjithashtu probleme mjedisore të cilat vazhdimisht mundë ti atakojnë popullatën duke i shkaktuar bezdisje të herë pas hershme në disa pjesë dhe vendbanime, për rreth TC-ve, kurse në disa pjesë dhe vendbanime tjera në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithnjë e më shumë duke e rritë intensitetin. Vendbanimet të cilat janë

vazhdimisht nën ndikim të zhurmës janë ato të cilat shtrihen përgjatë hekurudhës, rrugëve nacionale, rajonale dhe rrugëve lokale, kurse forma tjetër e bezdisjes e cila vjen nga kundërmimi vjen nga plehrat e kafshëve në vendbanime të cilat hudhen vend e pa vend, nga fermat dhe mini fermat e kafshëve të cilat janë të ndërtuara pa standarde, nga deponitë e egra të mbeturinave dhe nga kanalizimet.

Megjithatë zhurma dhe kundërmimi është në të gjitha rastet përtej vlerave limit që përcakton udhëzimi "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara" dhe limitet e përgjithshme për nivelin e zhurmave të OBSH. Një tjetër dukuri për t'u ven në dukje është niveli konstant i zhurmës gjatë 24 orëve në zonat e banimit ku limiti i nivelit të zhurmës në orët e natës nuk duhet të kalojë 45 dBA, ndaj vlerave mbi 60 dBA.

Burimet Ujore dhe Furnizimi me Ujë

Komuna e Obiliqit ka burime të ujë mirëpo në mungesë të mjeteve për rregullimin e ujësllësit pjesa më madhe e banorëve të komunës që jetojnë në zonat rurale, furnizohet me ujë të pijshëm nga burimet ndryshme individuale (puse të hapura, kroje malore, lumenjve) i cili nuk trajtohet në aspektin e analizave laboratorike dhe nuk është i verifikuar profesionalisht nga instituti i shëndetit publik përveç ujësllësit të qytetit. Komuna është e pasur me rezerva të ujit fale tri pellgjeve ujore: (pellgu i lumit Sitnica, lumit Drenica dhe, lumit Llap) si dhe pellgje të tjera me të vogla të cilat kanë konfiguracion me të vogël por me kualitet të mirë për ujë të pijshëm. Burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore në territor dhe cilësia e tyre në Komunën e Obiliqit ka shumë lumenj, por më të rëndësishmit janë: lumi Sitnica, lumi Drenica dhe lumi Llap.

Çështje Mjedisore që Lidhen me Ujin e Pijshëm

- Ujërat janë vazhdimisht të kërcnuara nga aktiviteti minerar dhe industrial;
- Ka raste kur cilësia e ujit komprometohet kryesisht nga ndotjet që pëson në linjat e transmetimit (ndotja nga ujërat e zeza, për shkak të intersektimeve të shumta të tubacioneve të ujit të pijshëm me ato të ujërave të zeza);
- Përdorimi për qëllime të tjera veç përdorimit familjar, është i madh duke ulur sasitë e nevojshme për popullsinë;
- Burimet ujore nëntokësore, sidomos ato deri në 20 m thellësi janë të rrezikuara nga ndotja sipërfaqësore për shkak të përshkueshmërisë së lartë të shtresave mbrojtëse.

Grumbullimi i Mbeturinave

- Grumbullimi i mbetjeve të ngurta do të bëhet në deponinë rajonale;
- Përfshirja të gjitha vendbanimeve në kuadër të rrjetit të infrastrukturës së grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave të ngurta;
- Mbyllja e deponive të hirit dhe deponive ilegale të mbeturinave të cilat gati në të gjitha rastet janë deponi spontane dhe të paligjshme dhe ndodhen kryesisht në periferi të vendbanimeve rurale.

Menaxhimi i Mbetjeve të Lëngëta dhe Kullimi i Ujërave të Shirave

Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura në Obiliq është si vijon:

Kështu shumë nga vendbanimet në Komunën e Obiliq nuk kanë menaxhim efektiv të ujërave të ndotura. Janë ndërtime të paligjshme që derdhen drejt e në lumenj, të cilët shpesh

janë standardit dhe rrjedhin, duke shkaktuar ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura përbën ndoshta rrezik të madh mjedisor për Obiliqin dhe sigurisht shkakton ndotje të madhe.

Duhet vënë në dukje se Qeveria e Kosovës ka parapa impiant të karakterit rajonal për trajtimin e ujërave të zeza konfiguracioni i terrenit rajonit nuk paraqet ndonjë përparësi në këtë funksion përpos në segmente të caktuara, andaj HZK duke u bazuar edhe në Planin nacional ka parapar një impiant.

Furnizimi me Energji

Furnizimi me energji bëhet nga KEK-u i cili ndodhet në territorin e komunes ku është hartuar HZK, ndërprerjet e vazhduara të energjisë elektrike kanë qenë shqetësuese vite më parë edhe se me trend të zvogëluar por prapë paraqesin një shqetësim. Kjo sillte dhe vazhdon të sjell si pasojë përdorimin e gjeneratorëve me naftë, që rendonte ndotjen e ajrit dhe që po vazhdon kohë pas kohe.

Aktivitetet Ekonomike dhe Sociale

Ekonomia në Komunën e Obiliqit është në gjendje mjaft të vështirë pasi që në këtë komunë tani shumë pak kemi mundësi për zhvillim të industrive dhe ekonomive tjera. Shumica e ndërmarrjeve janë tregtare, pak prodhuese, të cilat punojnë me kapacitete të vogla. Këto ndërmarrje nuk kanë mundësi të rritjes së kapacitetet prodhuese dhe numrin e punëtorëve. Procesi i privatizimit nuk ka dhënë rezultate të pritura. Mungesa e mjeteve financiare, kushtet e pavolitshme të kreditimit, politika fiskale joadekuate, stimulimi jo i mjaftueshëm në bujqësi janë problem për bujqësi e gjithashtu direkt në ekonomi. Industria është në nivel të ulët dhe të ardhurat nga kjo sferë janë të ulëta.

Punësimi është një prej sfidave për autoritetet vendore si dhe nuk shihet ndonjë përpjekje për hapjen e kapaciteteve të cilat do të punësonin një numër më të madh të punëtorëve e veçanërisht të rinjve dhe grave, si kategori më të prekura. Migrimi drejt qytetit apo depopullimi i zonave rurale, në mënyrë direkte po ndikojnë në zvogëlimin e numrit të fermave sidomos në zonat ku është planifikuar për mihjet e reja. Një ndër problemet është edhe se të rinjtë nuk duan të mirën me bujqësi. Të rinjtë më tepër janë të orientuar të migrojnë jashtë vendit, kurse të vjetrit nuk mundën me punuar në bujqësi në mënyrën e duhur.

Komuna e Obiliqit ka resurse për zhvillimin e pemëtarisë perimtarisë, blegtorisë, bletarisë, për prodhimin e mishit, shpezëtarisë si dhe duhet të kemi parasysh se ka edhe sistemin e ujitjes se tokave dhe tokat nën komasacion të cilat mundësojnë kultivimin kulturave intensive të cilat mundësojnë zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë. Pozita gjeografike e komunës na jep mundësi të komunikimit të njerëzve të mallit dhe kapitalit me disa komuna të zonave tjera pasi që kjo komunë ka pozicion qendror.

PARIMET, OBJEKTIVAT DHE KRITERET MJEDISORE

PARIMET, OBJEKTIVAT DHE KRITERET MJEDISORE QË KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të HZK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal në vendbanime të ndryshme të komunës së caktuara.

Parimet e Përgjithshme për Planifikim Hapësinor

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbledhen në dhjetë pika si më poshtë:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejzazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim i shëndetshëm mjedisor, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe përgatitjen e sheshit;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe aksesit i publikut në informacion; dhe
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër të hartimit të HZK-së parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme (siç janë paraqitur edhe në këtë material):

- Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar;
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës;
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve- aksesit nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;
- Rehabilitimi i tokës bujqësore;
- Rizhvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllëzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturo – historike dhe natyrore të Obiliqit ;
- Ruajta e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

Objektiva Strategjike

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

- Zhvillimi i mëtejshëm i vlerave, ku të gjithë aktorët e kryera të drejtën e tyre për të ditur, për t'u dëgjuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën dhe tendencat e tij. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;
- Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, eliminimin e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;
- Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj);
- Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë (rritja e sigurisë, shtim i mundësive për mënyrën aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, HZK-ja përpiqet të zbatojë disa parime dhe modele zhvillimi të pranuar gjerësisht, si psh. Komuna e Obiliqit komunë policentrike, ku qytetari gjen shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevojë të udhëtojë për të siguruar shërbimet veç në qendrën administrative.

HZK-ja parashikon zhvillimin e komunës si një tërësi me vendbanime, lagjet, e deri tek zonat e vogla të banimit. Në këtë fazë, duke qenë plan i zhvillimit komunal, do jepen kufijtë, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standardet e parashikuara për tërë komunën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim, dhe më pas puna do vijojë në nivelin e Planeve Rregulluese të Hollësishme që detajojnë rregullimin dhe zhvillimin për çdo zonë banimi dhe zona tjera. Plani do përpiqet të përfshijë konceptin e formulës së menaxhimit të pronës në mënyrë adekuate pa dallime të pronarëve gjatë destinimeve në zona ndërtimi, gjelbërimi etj.

HZK-ja me kushtet dhe masat për mbrojtje të mjedisit parashihet një zhvillim të qëndrueshëm edhe në aspektin mjedisor, duke synuar që zhvillimet e reja të infrastrukturës, zonat industriale, etj., nuk i cenojnë korridoret e qarkullimit të shtazëve ose janë marrë masa të duhura për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, pyllëzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve dhe shumë mundësi të rritjes së sipërfaqeve të gjelbra brenda vendbanimeve. Në këtë aspekt mund të përmendim. Parashikohet krijimi i një mundësie qarkullimit me biçikleta përgjatë

disa rrugëve e sidomos në disa vendbanime të mëdha. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktike të këtyre synimeve të HZK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisorë të komunës.

Gjithashtu plani synon të integroje dhe përmirësojë situatën aktuale komunale, si psh. zgjerimi i vendbanimeve në drejtimin më të favorshëm në kuptimin e shtrirjes në tokë me plleshmëri të dobët dhe me përdorim të përzier.

Një tjetër aspekt mjedisor i Planit është rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisore, ndërmarrje që krijojnë mundësi për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, për çlodhje dhe argëtim.

Në mënyrë të përmbledhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin e Planit mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Krijimi i një komune të qëndrueshme dhe të shëndetshme;
2. Identifikimi dhe krijimi i habitatve të reja, dhe korridoreve të gjelbëra;
3. Përmirësimi i cilësisë së ajrit, përfshirë reduktimin e zhurmave;
4. Kursimi i energjisë dhe pakësimi i emisioneve të gazeve serrë;
5. Cilësia e ujërave sipërfaqësore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivës në kuadër për Ujin të BE-së;
6. Pakësimi i sasisë së mbetjeve dhe menaxhimi i integruar i tyre;
7. Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me biçikleta;
8. Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë arkeologjike dhe arkitekturore;
9. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;
10. Mbrojtja e mjedisit natyror në pyjet dhe malet;
11. Ripërdorimi i disa tokave të ndotura në vend të tokave të reja.

Veprime Operacionale në Mbështetje të Objektivave Strategjike

Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbra në komunën e Obiliqit :

1. Krijimi i projekteve për zbatim në zonat të cilat do të mbrohen me këtë plan;
2. Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të parapara me HZK ;
3. Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për rreth vendbanimeve;
4. Krijimi i korridoreve të reja ekologjike sipas Planit të ri dhe zonave të Obiliqit zgjatimi dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në korridorin përgjatë lumenjve;
5. Krijimi i hapësirave të gjelbërta dhe kopshteve në Obiliq, etj;
6. Kthimi i zonave të degraduara në sipërfaqe të gjelbra;
7. Gjelbërimi i kopshteve të shtëpive private;
8. Gjelbërimi me peme dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
9. Ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qellim të shumëfishtë (rritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit të pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore).

Veprime operacionale për përmirësimin e sistemit të transportit dhe shtimit të përmbajtjeve:

1. Ndërtimi i një rrjeti rrugor që lidhin Obiliqin (me interes të veçantë me Prishtinën) dhe me rajonin;
2. Përmirësim i gjendjes së rrugëve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundësisë;
3. Krijim i rrjetit të plote rrugor në vendbanimet e mëdha me përmbajtje edhe për biçiklistët dhe këmbësorët;
4. Përmirësim i sistemit, orareve dhe cilësisë së autobusëve;
5. Përmirësimi i projektimit të rrugëve me parashikimin e trotuareve të plota dhe shiritave/korsive për biçikletat sipas standardeve europiane të rrugëve;

Kriteret Mjedisore që Kufizojnë Zhvillimin Komunal

Më poshtë paraqiten disa kriteret mjedisore që duhet të kufizojnë zhvillimin komunal, të grupuara në katër kategori kryesore, përkatësisht (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetësore, (2) kriteret e trashëgimisë kulturore, (3) kriteret e peizazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Kriteret e Forta Mjedisore-Shëndetësore

Këto kategori kriteresh përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (I) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. zonat e mbrojtura të natyrës), (II) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (III) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike).

(I) Zonat me vlera të veçanta mjedisore zona të tilla nuk ka.

(II) Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

- Shtretërit e lumenjve dhe pjesët buferike rreth tyre (lumi Krivareka, lumi Hogoshtit, dhe disa rrjedha të rëndësishme ujore);
- Basenet nëntokësore ujëmbajtëse;
- Zonat me pjerrësi më të madhe së 15 apo 20%.

Nuk lejohen ndërtimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmbajtjeve (qofte dhe shume të rralla), mund të shkaktojnë erozion të brigjeve, si dhe të cenojnë regjimin hidrologjik të sistemit ujor.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndërtimet në zonat me pjerrësi të madhe pasi në mjedis argjilor këto ndërtime mund të shkaktojnë (ose përkeqësojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Në këtë fazë të Planit Zhvillimor Komunal është vështirë të përcaktohen me detaje këto zona, por gjatë hartimit të këtij plani është punuar një planë me pjerrtësi dhe gjatë zhvillimeve të ardhshme mund të super punohet me informata tjera dhe të shfrytëzohet si bazë për plane rregulluese dhe projekte tjera.

(III) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. Deponia e Mirashit dhe deponit e hirit) përfshijnë:

- Deponia e egra përgjatë lumenjve dhe kanalizimet që derdhen drejt për drejt në lumenj;
- Deponit e hirit;
- Thertore dhe objektet tjera të veprimtarisë ekonomike;
- Ndërmarrja e riparimit të automjeteve;

- Deponitë e veturave “varrezat e veturave”.
- “Varrezat e kafshëve”

Këto zona duhet të jenë objekte të studimeve për vlerësimin e situatës mjedisore mbi bazën e te cilit do të mund të gjykohej mbi nivelin e ndotjes së ujit dhe tokës dhe masat eventuale që duhen ndërmarrë për rehabilitimin.

Kritere të Trashëgimisë Kulturore

Komuna e Obiliqit ka objekte të trashëgimisë kulturore që duhen ruajtur për vlerat e tyre kulturore dhe potencialin turistik në të cilat nuk duhet të lejohet zhvillimi i pakontrolluar.

Vlerat e trashëgimisë kulturore duhen të konsiderohen rast pas rasti me qëllim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor.

Lista e monumenteve të kulturës do duhet rishikuar dhe lehtësuar ndjeshëm. Disa prej monumenteve të kulturës janë cenuar, tjetërsuar apo zhdukur. Disa prej monumenteve kane qene shpallur për motive qartësisht politike dhe lista duhet avancuar.

Ka disa zona tradicionale me vlere konservimi që mund të mbrohen. Duke pasur vlera të ndërtimit tradicional, këto zona turistike duhet ruajtur me karakter të veçantë.

Kritere Peizazhike

Komuna e Obiliqit nuk nifet me vlera të larta peizazhike. Kriteret peisazhike janë më të vështirë për të përcaktuar pasi duhen konsideruar rast pas rasti dhe duhen caktuar në bashkëpunim dhe pajtueshmëri me institucionet tjera.

Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për t’i mbrojtur sa më mirë, intervenimet e njeriut në pikat skenike-atraktive, duhet të minimizohen. Posaçërisht, në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit. Shkaktarët kryesorë të degradimit të peizazhit janë minierat sipërfaqësore (gurthyesit), djegia e pyjeve dhe prerja e pakontrolluar e tyre.

Duke pasur parasysh se Ligji i Planifikimit ngarkon komunat me përgatitjen e planeve hapësinore, ndërkohë që Obiliqi edhe se ka përgatit këtë planë duhet që të gjejë mirëkuptim dhe bashkëpunim me Institucionet tjera kompetente dhe akterët tjerë për nevojën e mos-lejimit të ndërtimeve në këto zona, qofte duke e sanksionuar këtë edhe me akt-normativ.

Kritere Inxhinierike dhe të Infrastrukturës

HZK-ja duke trajtuar shfrytëzimin e tokës, mjedisin, infrastrukturën dhe fushat tjera si ajo e zhvillimit ekonomik dhe social ofron një mundësi të zhvillimeve të qëndrueshme nëse merr në konsideratë posaçërisht sistemin inxhinierik dhe nevojat e infrastrukturës së komunës si pjesë integrale dhe i trajton në sistemin multishtrësorë për të mënjanuar konfliktet eventuale dhe ofruar zgjidhje të qëndrueshme.

Planifikimi i ndërtimit të korridoreve të qarkullimit të nivelit nacional dhe internacional që lidhë Kosovën me Serbinë, duhet kihet parasysh tri elemente kryesore:

- Pajisja me impiante filtrimi dhe pastrimi të ujërave ndotës që shkarkohen, konkretisht me “laguna”;
- Vendosja e barrierave të zhurmës në afërsi të vendbanimeve;

- Të krijohen më shumë rrugë lokale në mënyrë që shkalla e fragmentimit social dhe mjedisorë të jetë më e vogël.

Duke qenë se Transporti mbështet kryesisht në cilësinë e transportit publik me autobusë dhe promovim nëpër vendbanime edhe shfrytëzimin e biçikletave dhe udhëtimin këmbë, HZK-ja duhet të marre parasysh tipin e sistemit rrugor të planifikuar dhe ndërtesat që mund të ngrihen duhet të respektojnë një largësi të mjaftueshme nga sistemi rrugor, përfshi trotuaret apo korsitë e biçikletave sipas rastit.

Në mënyrë të ngjashme, projekti i vendosjes së kolektorit të ujërave të ndotura, trajtimit të përkohshëm të ujërave të ndotura në nivel komunal, të vendbanimeve apo të lagjeve (sipas Planit për Ujin dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura brenda HZK-së) duhet zbatuar atë që është përfshirë në HZK-në, dhe ajo përmbajtje duhet evidentuar në sistemin GIS-it. Edhe ndërtimet e mundshme duhet të respektojnë një largësi të pranueshme. Sistemi ujësjellësit dhe kanalizimit duhet monitoruar për të parandaluar rrjedhjet, rinovuar sipas nevojës dhe futur nëntokë sipas standardeve dhe duke u shënuar problemet në sistemin GIS që shoqëron HZK-në.

Gjithashtu, linjat e transmetimit të energjisë, dhe ato të telefonisë fikse do duhet të rekonstruktohen, avancohen dhe sa më shumë të futen nëntokë dhe të shënohen në sistemin GIS-it që shoqëron HZK-ja. Natyrshëm ndërtesat e reja do duhet të respektojnë distance të pranueshme nga këto linja, sipas kriterëve të dhëna në HZK. Antenat e telefonisë celulare nëpër vendbanime është mire të jenë të grupuara dhe jo të shpërndara, megjithëse kjo çështje është e vështirë të trajtohet në kuadër të HZK-së. Mendojmë që problemi i antenave duhet të jetë objekt i një studimi të veçantë, përfshirë ndikimin eventual në shëndetin e njeriut.

Duke pasur parasysh që mbetjet mbështeten në sistemin e trajtimit të mbetjeve sipas hierarkisë Redukto-Riperdor-Riciklo-Djegje-Vend depozitim duhet që HZK-ja të pasqyrojë këtë parim dhe të planifikojë zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit dhe mundësisht të parashikojë zona që mund të përdoren për djegie apo pikë transiti për të ardhmen, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis.

**NDIKIMET E MUNDSHME
MJEDISORE DHE MASAT
PËR ZBUTJEN E TYRE**

Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet e Mjedisit

HZK-ja është dokument i karakterit rregullativ dhe strategjik zhvillimit të zonave në të cilin percaktohen kriteret zhvillimore socio-ekonomike dhe mjedisore të Komunës së Obiliqit dhe komunitetit të saj nga ana e Grupit hartues të Hartës Zonale Komunale. HZK ka si qëllim transpozimin dhe sendërtimin e Vizionit të paraqitur në PZHK, si dhe objektivave dhe prioriteteve strategjike në një sistem të zhvillimit të qëndrueshme komunal në kuptimin hapësinor. Në një proces të tillë të rëndësishëm, ky itinerar do të mbështetet nga hartimi i planeve tjera të vendbanimeve dhe zonave ndërtimore të niveleve më të ulëta dhe kodeve me instrumente të veçanta zhvillimi hapësinor, sipas gjithë komponentëve të vet: ekonomikë, socialë, mjedisorë dhe organizativ. Këta instrumente përbëjnë një ndërthurje të programeve të veprimit me nismat investuese, me qëllim orientimin e zhvillimit komunal në zonën e përfshirë në studim.

HZK merr në konsideratë dhe përgjithësisht është në përputhje me planet e ndryshme të nivelit më të lartë, si dhe në linjë edhe me shtyllat kryesore të zhvillimit të Planeve Sektoriale, Planet dhe projektet Sektoriale që hartohen edhe si rezultat i këtij plani duhet të bëjnë ose të parashikojë të përfshijë vlerësime të kostove dhe të identifikojë ose përfshijë identifikimin e masave të nevojshme që duhen ndërmarrë për implementimin e këtyre propozimeve. Propozimet për zhvillimin e zonave, rrugëve etj, përfshihen si në propozimet për përdorimin e tokës, ashtu edhe për ndarjen në faza, pasi duhet që të ruhen apo të gjenden sipërfaqe toke për zhvillimin e zonave, ndërtimin e rrugëve etj, për sa kohë që mundësia e aksesit shihet si mekanizmi kryesor që drejton zhvillimin.

Çështje tjetër që HZK trajton janë zonat me vlera mjedisore dhe ambientale si dhe zonat me vlera të trashëgimisë kulturore si dhe janë marrë masa adekuate për mbrojtjen e këtyre zonave me rëndësi të veçantë. Si rezultat, HZK do të shërbejë edhe si një proces i cili mundëson adresimin e shumë prej problemeve mjedisore sociale, ekonomike dhe organizative të cilat kërkojnë zgjidhje të duhur. Kryesisht duhen investime në infrastrukturë dhe përmirësim i menaxhimit komunal me qëllim që tu jepet përgjigje shumë prej problemeve mjedisore të hapësirës komunale të marrë në studim, ndërsa procesi i planifikimit të zhvillimit të zonave dhe shfrytëzimit të tokës duhet zbatuar sipas këtij plani, me qëllim që të parandalohet shtrirja e mëtejshme nëpër zonat bujqësore dhe zonat me vlera tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Kjo nevojë për planifikim dhe menaxhim në nivel vendbanimesh të shumta bashkërendimi dhe veprimi në mes tyre është identifikuar si çështje e rëndësishme edhe në raportet e HZK-së, sipas së cilës gjithashtu propozohen masa për mbrojtjen e zonave ekzistuese të gjelbra dhe ujërave brenda dhe rreth territorit komunal dhe ka përgatitur planin e masave për zhvillimin e tyre të qëndrueshëm. Këtu përfshihen zonat e ujërave sipërfaqësore, përgjatë lumenjve, dhe nëpër vendbanime.

Trajtimi i Çështjeve Mjedisore në Hartimin e Hartës Zonale Komunale

Në çdo fazë të zhvillimit HZK-së është vënë në konsideratë edhe vlerësimin mjedisor. Megjithatë nuk është qëllim kryesor për HZK-në, të dalurat e fazës së parë të studimit të HZK-së (Klasifikimi i zonave) përmbajnë të dhëna dhe komente të konsiderueshme mbi gjendjen dhe problemet e mjedisit në Obiliq. Gjatë fazave të zhvillimit

të HZK-së merren në konsideratë çështje mjedisore apo të ofrimit të shërbimeve dhe diskutojnë gjendjen dhe shkakun e problemeve mjedisore në komunë.

Zhvillimet e planifikuara të cilat kanë ndikim në mjedis janë marrë në konsideratë duke i ruajtur të gjitha komponentët mjedisore në aspektin strategjik të zhvillimit të komunës. Gjatë planifikimit gjithmonë janë ruajtur korridoret e qarkullimit të shtazëve dhe bimëve nga një ekosistem në tjetrin, janë ruajtur ekosistemet të cilat kanë një rëndësi të veçantë për komunën dhe për rajonin, janë marrë në konsideratë ruajtja e zonave të mbrojtura me vlera ambientale dhe kulturore.

Analiza e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të HZK-së

Gjatë analizës është vlerësuar se Kushtet e përgjithshme dhe masat të cilat janë marrë për mbrojtje të mjedisit gjatë planifikimit nuk do të kenë efekte negative ekonomike apo shëndetësore dhe mjedisore. Për këtë arsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikëpamja sasiore shkalla e ndikimit që do të ketë plani mbi mjedisin apo shëndetin. Megjithatë, prirjet e këtij ndikimi, të cilat janë edhe objekt i VSM, janë të parashikueshme. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor të planit, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky plan. Tabela e mëposhtme shërben si një listë e kontrollit të kriterëve mjedisore sipas të cilave është bërë vlerësimi i këtij plani. Kjo listë tregon nëse HZK-ja e ka marrë në konsideratë problemin, e po të jetë kështu, nëse i ka dhënë përgjigje. Kolona e fundit shpjegon nëpërmjet shenjave si më poshtë:

- * = Ka përgjigje të plotë për problemin;
- + = Ka nevojë për masa të mëtejme;
- - = Nuk është trajtuar, duhet të trajtohet me HZK.

Tabela nr. 5. Konsiderata Mjedisore dhe Shëndetësore të HZK-së

Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në HZK ?	Si është trajtuar problemi në HZK ?	Treguesi
1. Përfshirja e konsideratave mjedisore	Po	Gati në gjitha fazat është trajtuar sipas parimeve mjedisore	*
2. Përfshirja e konsideratave shëndetësore	Po	Përshkruhen në seksionet e mëposhtme.	+
3. Marrja parasysh e objektivave ndërkombëtarë, kombëtarë dhe lokalë për mjedisin dhe shëndetin gjatë formulimit të HZK-së	Po	Përshkruhen në seksionet e mëposhtme.	*
4. Përfshirja në sintezë e Konsideratave Mjedisore	Po	Janë përfshirë në Kushtet Zhvillimore dhe masat në HZK.	*

5. Konsideratat mjedisore në Opsione	Po	Kur është diskutuar masat e marrura ndaj kushteve zhvillimore dhe kushteve të veçanta si dhe kushteve të paraqitura të zonave mbishtresore.	*
6. Kushteve zhvillimore dhe kushteve të veçanta si dhe kushteve të paraqitura të zonave mbishtresore të HZK-së			
a. Mbështetje për kushtet zhvillimore dhe kushtet e veçanta	Po	Kushtet zhvillimore dhe kushtet e veçanta pragmatike prirjet ekzistuese dhe ato strategjike të zhvillimit komunal dhe socialo ekonomik të Obiliqit. Problemi është që kjo rritje të bëhet mbi bazën e kriterëve të forta mjedisore, dhe të mos shtrihet në tokat bujqësore, pyjet përreth, hapësirat ujore dhe me potencial vërshimi si dhe jo në afërsi të zonave të mbrojtura.	*
b. Afirmon rolin e Obiliqit në nivel të Kosovës, dhe në nivel ndërkombëtar krahas ofrimit të mundësive infrastrukturore dhe energjetike që ka kjo komunë si dhe pozites gjeografike të sajë në nivel qendror.	Po	Orienton Komunën e Obiliqit si qendër dhe si pikë fokale për të gjitha anët e vendit në kuptimin e zhvillimit të infrastrukturës dhe prodhimit të energjisë	*
d. Përforcimi i kapacitetit të Komunës për të rritur rolin e migrimit dhe për t'u siguruar banorëve të rinjë mundësi punësimi.	Po	Kjo propozohet të bëhet nëpërmjet përcaktimit të kushteve zhvillimore të përshtatshme për zhvillimin e vendbanimeve që kanë trendë rritje dhe ofrimit të kushteve edhe në vendbanimet tjera.	*
e. Integrimi i kushteve zhvillimore të zonave rurale në komunë dhe ulja e shkallës së përjashtimit ekonomik dhe social të banorëve të tyre.	Po	Është marr në konsideratë dhe në kuadër të kushteve lejohet zhvillimi i aktiviteteve ekonomike duke i pasur në konsiderat kushtet mjedisore.	*
f. Fuqizimi dhe zgjerimi i vendbanimeve brenda kufijve ndërtimor të planifikuar duke pas parasysh mundësin e vogël për zgjerim të ndërtimeve, për shkak të zonave me interes nacional të mihjeve janë dhën kushtet zhvillimore të mjaftueshme si dhe masat për mbrojtjen e shëndetit publik.	Po	HZK ka si qëllim të ndihmojë zhvillimin dhe rigjenerimin e vendbanimeve në sistemin policentrik. Ai përfshin propozime mjedisore në formën e ruajtjes së zonave të gjelbra edhe përtej kufijve ndërtimor të vendbanimeve	+
g. Harmonizimi dhe baraspeshimi i zhvillimeve nëpër nën qendra komunale.	Po	HZK ka si qëllim zhvillimin e nën qendrave të tjera për të ulur stresin në një zonë qendrore. Si i tillë, HZK	*

		propozon zhvillimin e një serie funksionesh nëpër këto nën qendra.	
h. Fuqizimi i zonave ekonomike ekzistuese, si dhe zonave të reja ekonomike përgjatë akseve rrugore në përgjigje të potencialeve dhe nevojave të reja ekonomike.	Po	HZK ka si qëllim të mbështesë por dhe orientojë dhe përkufizoj zhvillimet aktuale. Koncepti mbështet në faktet që gjendja tashmë e krijuar është e patjetërsueshme, kështu duhet sanuar duke orientuar zhvillimet dhe përkufizuar zonat.	*
i. Të gjitha potencialet ekonomike janë vë në shërbim të zhvillimit të komunës, duke vu theksin në mundësit zhvillimore në zonat ekonomike për bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha.	Po	HZK ka për objektiv të gjejë mundësi që zonat e njohura ekonomike në komunë të mund të shfrytëzohen racionalisht dhe të ofrohen mundësi atraktive, përmenden masat si impiantet për trajtim të ujërave industriale dhe tampon zonat si bariera biologjike.	*
j. Ruajtja e shtretërve dhe rrjetit të lumenjve në tërësi (me theks të veçantë lumi Sitnica, Drenica dhe Llap.	Po	HZK poashtu ka për objektiv mbrojtjen e disa zonave ujore brenda hapësirës së Obiliqit, dimesionimi i zonës sipas kriterëve mjedisorë, dhe zgjidhja e një problemi të fortë mjedisor të zonës	*
k. Ruajtja ujërave nëntokësore të cilat ndodhen në Obiliq	Po	HZK jep masa duke trajtuar në pjesën e analizave të gjendjes ekzistuese, është trajtuar edhe në masat të cilat janë vë si rezultat i ofrimit të shërbimeve komunale.	*
m. Përmirësimi i shërbimeve publike dhe aksesit ndaj transportit në zonat rurale		Po, por duhet arritur një ekuilibër mes aksesit të përmirësuar dhe inkurajimit të zhvillimit të mëtejshëm të ndërtimeve rurale në zonat ku kjo gjë mund të mos jetë e dëshirueshme.	*
7. Ndikimet në klimë			
a. Përshtatja me ndrrimet (mutacionet) klimatike globale.	Jo	Ka trajtim të ndrrimeve (mutacioneve) klimatike globale. Ndërsa ende nuk ka strategji nacionale të aprovuar për masat që duhet marr për tu përshtatur me ndryshimet klimatike globale. Në studimin mjedisor janë integruar objektivat dhe instrumentat e zbatimi të cilat shkojnë në këtë drejtim si ai i uljes së CO ₂ , NO _x dhe SO ₂ të komunës.	-
b. Marrja parasysh e ndrrimeve lokale.	Po	Përfshihet si tregues mjedisor, por nuk trajtohet në mënyrë parësore, pasi që shumë nga aktivitetet që do të ndërmer komuna nuk mëvaren vetem nga komuna.	+
8. Demografia			

a. Problemet me zhvillimin demografik	Po	Njeh faktin se kjo është ende e vështirë për t'u parashikuar saktë. Megjithatë, mund të ketë nevojë për më shumë studim, për t'i lënë hapësirë ndryshimeve të mundshme. Merr parasysh faktin që popullsia mund të rritet jo edhe aq shumë deri në vitin 2025. HZK-ja i mban larg presionit demografik zonat me ndjeshmëri mjedisore.	*
9. Zhvillimi dhe shfrytëzimi i Tokës			
a. Planifikimi komunal dhe Drejtimi i Zhvillimit	Po	Njeh nevojën për pranimin e zhvillimit aktual, përveç zonave ku mund të shkaktohen probleme mjedisore	*
b. Kapacitetet mjedisore në zonat dhe vendbanimet e propozuara për zhvillim	Po	Vlerësohet se i gjithë territori i komunes por edhe me gjerë është i rrezikojnë kapacitetin e saj mjedisor dhe ekologjik. Zona e propozuara për zhvillim industrial apo ekonomik shtrihet në tokën jo bujqësore dhe propozohet Plan Rregullues i Hollesishem dhe VSM të veçantë për aspektet tjera mjedisore, ndërsa në vendbanimet brenda konceptit policentrik vërehen tendencat e shtrirjes në kategorinë tokë e kualitetit të lartë të konvertuara vonë në zona informale, por edhe këtu tentohet të ruhet sa ma shumë tokë bujqësore dhe kompaktësim sa ma i madh i zonës ndërtimore.	*
c. Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave të reja rekreative	Po	Njeh problemin e mungesës së tokës për këtë qëllim vetëm brenda vendbanimeve dhe propozon mbrojtjen e zonave të gjelbra dhe parqeve duke krijuar një kurorë të gjelbër të përbërë nga disa zona dhe sisteme kodrinore malore të mbrojtura. Megjithatë, për të gjithë këta elemente, përfshirë dhe zonat që gjenden brenda vendbanimeve (zemrat e gjelbërta) dhe në zonat jashtë tyre janë të përcaktuara kufijtë. Duhet marrë vendimet përkatëse për shpalljen zona të interesit komunal, dhe duhet aprovuar Planet e Menaxhimit lidhur me zhvillimet brenda këtyre kufijve.	+
d. Zhvillimi i parqeve të reja brenda vendbanimeve	Po	Edhe se pjesërisht e thamë më lartë se njohim problemin e mungesës së tokës	*

nënqendrave		brenda zonës së vendbanimeve nënqendra. Në disa vendbanime janë paraparë edhe disa zona të blerta të ashtuquajtura si “zemrat e gjelbërta” në të cilat mundë të zhvillohen parqe dhe hapësira për zhvillim të bujqësisë intensive. HZK propozon një varg masash për rritjen e sipërfaqes së gjelbër. Masat duhet të konkretizohen me veprime për çdo kategori zonashë në vendbanime.	
e. Mbrojta e pyjeve, peizazheve dhe zonave të mbrojtura natyrore	Po	Njihen problemet dhe bëhen propozimet adekuate për pyjet dhe hapësirat e gjelbra. Duhet çuar përpara statusi i tyre dhe duhet hartuar dhe aprovuar Plane menaxhuese përkatëse, ndërsa parqet ekzistuese duhet trajtuar në mënyrën adekuate në tërë territorin e komunës.	*
f. Kushtet zhvillimore të zonave të reja komunale	Po	Nxitet ky zhvillim veçanërisht në fushën e hapësirave dhe terreneve sportive, për të lehtësuar presionin në disa vendbanime. Me zhvillime të reja janë tashmë të gjitha vendbanimet me elemente të domosdoshme urbane.	*
g. Zhvillimet industriale	Po	HZK i përputhet me parimet strategjike ku aktivitetet ekonomike që shkaktojnë ndotje nuk do të lejohen dhe do të dekurajohen. Ka një problem me trajtimin e zhvillimeve aktuale për këtë lloj industrie.	+
i. Shërbimet dhe lehtësirat Publike (shkolla, stadiume sportive)	Po	Propozon norma dhe nevojën për standarde në tërë territorin e komunës.	*
h. Pyjet, malet dhe parqet/zonat e mbrojtura	Po	Trajtohen si zona të mbrojtura për pyje dhe parqe. Përmes masave dhe kushteve dekurajohet me forcë ndërtimi në këto zona për pos kur është definuar me këtë planë. Duhet të trajtohen zonat prioritare edhe nga pikëpamja e peizazheve pra e pikave panoramike me rëndësi peizazhike dhe turistike për komunën.	+
k. Forma e vendbanimeve dhe dendësia	Po	Kushtet e propozuara me HZK në kodin e zoonimit për lartësinë e ndërtimeve. Ato bazohen në ruajtjen e formës së vendbanimeve, mbushjen e zonave me densitet të ulët, dhe identifikimin e zonave ku do të lejohet zhvillimi i ndërtimeve në lartësi.	*

I. Mbrojtja e detajuar e Zonave të Gjelbra			
m. Zonat përgjat Lumenjëve	Po	Të ndalohet degradimi i mëtutjeshëm i brigjeve të lumenjve dhe shkarkimet e TC-ve në lumenj eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, të kthehen në korridore të gjelbër, por ndërkohë duhen përcaktuar kufijtë e shtretërve të lumenjve dhe të hartohet Plan Menaxhimi dhe Monitorimi mjedisor	+
n. Parqet dhe zonat e mbrojtura			
a) Kombëtare	Po	Në komunën e Obiliqit parqe të tilla nuk ka.	*
b) Të reja	Po	Sugjerohet një seri Parqesh dhe zonave të rëndësishme komunale, por mbetet problemi i Planeve të Menaxhimit të tyre pasi që kufijtë janë caktuar me HZK.	*
o. Brezi i gjelbër	Po	Në zonat përgjatë rrugëve regjionale, zonat industriale dhe zhvillimet tjera.	*
p. Pjesa e brendshme e vendbanimeve	Po	Jepen standardet për zonat lokale. Njihet problemi i mungesës së hapësirës për rritjen e sipërfaqeve të gjelbra apo për zona komunitare si sheshe, kënde lojërash, etj. dhe bëhen propozime në lidhje me instrumentet planifikues në planet e detajuara vendore.	*
10. Rreziqet natyrore apo humane			
a. Rreziqet natyrore në tërësi	Po	Trajtohen në përgjithësi, por ka nevojë për vëmendje më të madhe.	+
b. Rrëshqitjet e tokës	Po	Trajtohen në mënyrë specifike, sepse jepen standardet kufizuese për pjerrësitë.	+
c. Përmytjet	Po	Tregohen masat e duhura që duhet të ndermirrën për parandalimin e dëmeve që prodhojnë vërshimet	*
d. Tërmetet	Po	Në kodet e ndërtimit, por nuk gjen zbatim retrospektiv tek ndërtesat ekzistuese. Nuk ka detyrime për ndërtime me dalje emergjente në rast tërmeti.	+
c. Të ardhurat e ulëta	Po	Një problem është strehimi në ndërtesa të reja të ligjshme është i mundshëm vetëm për grupet me të ardhura të larta. Rekomandon nevojën që të ndërmerren politika sociale të strehimit.	*

d. Cilësia	Po	Kërkohej miratimi dhe respektimi rigoroz i kodeve të ndërtimit.	*
e. Shkalla sizmike	Po	Rekomandon kritere projektimi në përputhje me nivelin 8 në shkallën MSK-64 ₂₁ , pasi ky është një rrezik i njohur. Do të ishte mirë të sugjeroheshin projekte sipas Shkallës Evropiane Makrosizmike (EMS) për të respektuar standardet Evropiane.	+

Masat e Nevojshme në HZK për Mbrojtjen e Mjedisit

Në tabelën e mësipërme janë analizuar dhe janë dhënë disa rekomandime të mëtejshme. Kriteret që janë shënuar me shenjën * nuk diskutohen më tej, pasi nuk konsiderohen si problematikë. Tabela e mësipërme përmban një përmbledhje të gjitha problemeve mjedisore dhe shkallën në të cilën plani u jep përgjigje secilit prej tyre.

Kushtet Zhvillimore të përgjithshme dhe kushtet zhvillimore, përfshirë Zhvillimin e Qendrave

Gjatë gjitha fazave të planifikimit vërehet se i është kushtuar rendësi e veçantë të ruajtjes së tokës pasi që zgjerimi i ndërtimeve pa kontrollë dhe pa kritere sidomos përgjatë rrugëve dhe në zonat nën komasacion është problem i përmasave mjaft serioze.

Me HZK paraqiten kushtet e propozuar të tokës për vitin 2031, kurse në zonat e mihjes dhe ato të komasacionit i trajton si zhvillime jo konforme të cilat do të trajtohen me vendime tjera. Këtu prezantohen edhe kufijtë e rij ndërtimor edhe zhvillime tjera. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës me pjellshmëri, tokës së pasur me resurse dhe pyjeve. Kemi të prezantuar edhe zonat e shënuara me ngjyrë e cila potencialisht mund të paraqesin pikat e nxehta mjedisor.

Konfliktet e mundshme për hapësira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe tjera për komunën, të cilat do të vireshin më pas në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale, gjë që pranohet edhe në Hartën Zonale Komunale. Janë organizuar takimet e para me komunitetin për të filluar këtë proces. Zhvillimi i Obiliqit besohet se do të vazhdojë, e në fakt sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë Komuna e Obiliqit, aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo do të ishte e dëshirueshme dhe është në të mirë të Kosovës, duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimi efektiv komunal, komuna e Obiliqit ka mundësi të akomodojë një numër të konsiderueshëm të popullësisë me zgjerimin e kufijve ndërtimorë me zgjerimin e kapaciteteve industriale të prodhimit të energjisë pasi që përfitimi më i madh vjen nga kjo degë e ekonomisë sidomos për vendet që janë në zhvillim. Burimet ujore janë të mjaftueshme. Thën qart Plani i njeh të gjitha këto probleme dhe përpiqet në mënyrë realiste të punojë brenda këtyre kufizimeve.

Ndikimi në klimë

Për faktin se komuna e Obiliqit është komunë ku prodhohet energjia elektrike nga Termocentralet që për burim energjie kanë thëngjill linjitin. Ndikimi i aktivitetit industrial në këtë Komunë është kryesori i cili ndikon në klimën e rajonit pasi që dihet se nga ky aktivitet lirohen sasi të konsiderueshme të CO_x, SO₂ dhe NO_x. Megjithatë marrja e masave me HZK duke vendosur filtrat adekuat të tymëtarëve, rritja e fondit të gjelbërt, duke propozuar edhe tampone të gjelbërta në rrethinen e Termocentraleve dhe në gjithë territorin e komunes me qëllimin e rregullimit të mikroklimës në rajon duke absorbuar dhe duke neutralizuar ndotësit e liruar nga TC-të.

Mbrojtja e Pyjeve, Zonave të Gjelbra Ekzistuese dhe Zhvillimi i Zonave të Reja

Zonimi i propozuar nga HZK-ja krijon mundësinë për struktura të gjelbra, kryesisht për përdorim të ndryshëm, pyllëzim, ripyllëzim etj. Duhet hartuar udhëzues për:

- Projekte pyllëzimi konform planit;
- Projekte ripyllëzimi dhe mirë mbajtje konform planit;
- Numrin e këtyre strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Përdorimin e tyre, të themi për grupe/festa të mëdha, gjë që do të kishte ndikime negative;
- Arkitekturën e tyre për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues;
- Shërbimet e infrastrukturës për ofrimin e energjisë, ujit dhe menaxhimit të mbeturinave, me qëllim shmangien e ndikimeve vizuale dhe ndotjet e mundshme.

Cilësia e Ajrit

HZK-ja mundet të adresojë problemet e cilësisë së ajrit në mënyrë konkrete. Propozimi që në bashkpunim me nivelin qendror dhe KEK-un të vendos filtrat adekuat dhe të ndërtoj tampon zonat e gjelbërta, deri te eliminimi i deponive të hirit ti izoloj ato zona duke i mbuluar me mbules vegjetative me bimë të përshtatshme dhe stabile për hirin. Pastaj ndërtimi i rrugëve cilësore do të ulë trafikun nëpër vendbanime të mëdha, duke sjellë përmirësim të cilësisë së ajrit, ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2023 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SO_x, NO_x, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte për çlirimet në ajër nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli i cilësisë së karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të biçikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve)ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. PM10 mund të reduktohet nëpërmjet përdorimit të teknikave më të mira të ndërtimit dhe shtrimit të më shumë rrugëve. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së keqe të ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së sëmundshmërisë me qëllim vlerësimin sasior të dëmit në shëndet dhe kostos ekonomike që sjell ndotja e ajrit për Komunën. HZK-ja nuk e ka adresuar problemin e zhurmave. Megjithatë, disa nga masat e parashikuara në këtë dokument si shtimi i numrit tampon zonave, diversifikimi i transportit publik, futja e korësive të biçikletave, furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike dhe shmangia e përdorimit të gjeneratorëve, krahas masave

administrative komunës së Obiliqit për pakësimin e zhurmave në një kategori të mjediseve publike që aktualisht janë aktualisht problematike, do të ndikojë në uljen e nivelit të zhurmave, krahasuar me vlerat aktuale.

Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta

Vlerësohet se deponitë e hirit dhe deponitë e vjetra të mbeturinave do të mbushet kurse deponitë e hirit do të rehabilitohen përkosisht me mbulesë vegjetative. Duhet bërë identifikim i vendit për ngritjen e një deponie të përhershme të mbeturinave dhe impiant për riciklim. Plani ka bërë parashikime për ndërtimin e transdeponive. Kjo zgjidhje kërkon edhe ndërtimin e stacioneve të transferimit. Duhet, pra, një plan i) për identifikimin e një vendi për ngritjen e deponie të përhershme, ii) pastrimin e fushës aktuale të grumbullimit të mbeturinave; iii) për menaxhimin më të mirë të mbetjeve të ngurta në komuna iv) për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, të ndërtimit dhe atyre klinike; dhe v) rekomandimin e rregullimeve institucionale dhe financiare për të arritur këtë.

Propozimet për Rrugë

HZK-ja propozon një sistem rrugësh lokale dhe ndryshim ose zgjerim të traseve të rrugëve rajonalesi dhe jep kushtet dhe masat për mbrojtjen e qytetarëve nga trafiku si dhe parashe shiritat mbrojtës dhe tampon zona përgjate rrugëve. Meqë komuna e Obiliqit është një territor afër kryeqendres së Kosovës Prishtinës, vjen në shprehje edhe infrastruktura tjetër e cila diktohet nga niveli nacional dhe e cila ka impaktet më të larta mjedisore. Me probleme të përafërta përballen edhe rrugë të tjera të propozuara, të cilat kalojnë nëpër zona të gjelbra në të cilat janë masat adekuate për ruajtjen e tyre.

Ndikimi i zonave industriale, ekonomike, komerciale në mjedis

Obiliqi aktualisht zotëron disa zona industriale në qytet duke përfshirë edhe zonën e prodhimit të energjisë elektrike. Zona shtesë me aktivitete ekonomike janë zhvilluar përgjatë aksit rrugor të rrugës Obiliqi Prishtinë dhe në disa pjesë të ndryshme në afërsi të kësaj zone, kurse zona më e madhe me aktivitete ekonomike komerciale dhe industriale të lehta është e zhvilluar për gjat gjitha akseve rrugor.

Vlerësohet se zbatimi rigoroz i masave të parapara me HZK dhe zbatimi i objektivave të VSM-së do të ketë ndikime pozitive në gjitha aspektet në komunën e Obiliqit. Vlerësimi i këtyre objektivave do të mund të bëhet përmes një sistemi monitorimi, i cili do të ndjekë ecurinë e tyre gjatë gjithë kohës që shtrihet zbatimi i këtij Plani shumë të rëndësishëm për këtë Komunë. Përputhja e objektivave të VSM me zhvillimin e aktiviteteve të gjithanshme dhe shumëllojshme ekonomike –sociale është një moment i rëndësishëm për mjedisin dhe shëndetin publik. Bujqësia, industria e prodhimit të energjisë, ajo e pijeve sikurse edhe ajo e ndërtimit në qytet kryesisht të banimit kolektiv, turizmi industrial me shërbimet e tij por edhe elementë të tjerë të lidhur me to, si trafiku, cilësia e karburanteve dhe e automjeteve të transportit, duhen monitoruar në mënyrë rigoroze nga institucionet përkatëse. Realizimi i këtyre projekteve dhe plotësimi i objektivave të VSM do të sjellë një përmirësim në jetën e banorëve dhe të të ardhurve si në infrastrukturë, mjedis, shërbime dhe për shëndetin publik përmes rritjes së cilësisë së ajrit, ujit të pijshëm etj.

Është shumë me rëndësi që me këtë Plan është bërë një kufizim i përdorimit të tokës për aktivitete të ndryshme ekonomike dhe industriale si dhe janë dhënë disa masa dhe janë

parapar disa hapsira si tampn zona që shërbejn si barierë dhe filter për partikulat dhe emitmet tjera që vinj si rezultat i aktiviteteve ekonomike dhe industriale. Zonat industriale dhe zonat tjera të karakterit ekonomik dhe komercial janë të kufizuara dhe të destinuara me PZHK, kurse kushtet tjera zhvillimore, ndërtimore dhe kushtet e veçanta dhe masa mbrojtëse kundër ndotjes dhe ndikime tjera bezdisëse për këto zona jepen pikrisht me Hartën Zonale Komunale. Kurse me Ligjin për VNM dhe Udhëzimin administrative për Leje Mjedisore Komunale (LMK) parashihet të bëhen Vlerësime të Ndikimit në Mjedis për secilin objekt dhe veprimtari ekonomike dhe industriale i cili bjen në kategorit e parapara më Ligjin për VNM dhe Udhëzimin Administrativ për LMK.

Zonat e banimit

Zonat e banimit janë të kategorizuara sipas tipologjive të mëposhtme:

Zona e banimit kolektiv me afarizëm me HZK kjo zonë përfshin një hapësirë të konsiderueshme dhe shtrihet në zonën urbane të Qytetit të Obiliqit ku kanë një etazhitet maksimal B+P+7. Ato janë të karakterizuara nga blloqe banimi të organizuara me hapësira të kufizuara, rrugë të gjera dhe hapësira të përbashkëta të gjera të parapara me këtë Plan, kurse me Hartën Zonale Komunale do të jepen kushte tjera zhvillimore dhe kushtet e veçanta dhe masa tjera mbrojtëse. Në këto zona lejohet edhe afarizmi dhe aktivitetet tjera komerciale por jo industriale. Këto zona dhe aktivitetet tjera komerciale dhe afariste do të jenë konform me objektivat e VSM-së dhe masat do të jenë adekuate për kufizimin e zhurmës, ndotjes dhe elementeve tjera të dëmshme të cilat kanë ndikim në shëndetin publik. Këto zona sipas Planit do të përmbajn hapësira të gjelbërta me një fond më të madh se në zonat tjera të mbulueshmërisë me gjelbërim. Është me rëndësi që kryesisht ky lloj destinimi është i shtrir përgjat rrugëve kurse në pjesën e pasme kufizohen me pjesën tjetër të banimit.

Banim kolektiv kjo zonë rezidenciale përfshin një hapësir mjaft të madhe mire të kufizuar në zonën urbane të qytetit të Obiliqit. Kjo zonë karakterizohet kryesisht me banim me aktivitete të kufizuara komerciale si shitore dhe minimarkete të vogla që shkojnë në shërbim të banimit, por që nuk kanë ndikim në ndotje dhe në ndotjen akustike dhe bezdisjet tjera. Kjo zonë karakterizohet me parqe të mdha dhe sheshe publike të cilat do të jenë atraktive për banorët dhe do të jenë në favor të mjedisit jetësor.

Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe cilesia e strehimit brenda qytetit

Disa pjesë të strukturave ekzistuese urbane të Obiliqit janë duke vuajtur nga perkeqesimi i banimit si shkak i ndotje së lart që vie nga KEK-u, që ndikon në kushtet e jetesës së popullsisë urbane. Cilësia e ulët e strehimit mund të jetë një dekurajim për tërheqjen e atyre që duan të emigrojnë në zonën urbane. Plani Zhvillimor Komunal propozon masa për zhvillimin e objekteve banesore të reja në zonën periferike por edhe në zonën qendrore të kombinuara me stimuj për rikonstruim urban të banimit ekzistuese brenda qendrës. Qendra e qytetit ka përmbajtje historike është një kategori e veçantë që ka turizmi dhe tregtia mund të sigurojë nxitje për investimet private. Për të ruajtur karakteristikat e tyre pozitive, si hapësirat e hapura publike, llojin e ndërtimit, si dhe t'i pranojnë ato si pjesë të historisë së qytetit dhe identitetit të qytetit, Plani prezanton parimin minimal të ndërtimit, e cila mundëson zëvendësimin i njësisë me një ndërtim të ri në gjurmë të saktë të ish ndertimit, por me kate shitesë. Plani nxit rigjenerimin e qytetit në qendër të qytetit në aspektin e aksesit të përmirësuar, hapësira të hapura, vendet e parkimit dhe mjedisin e ndërtuar. Përmirësimi i imazhit të qytetit dhe rigjenerimin e hapësirës së hapur


edhe të bëhet përmes vazhimit e mëtejshëm të projekteve komunale. Natyrisht ritmi për përmirësimin e banimit do të varet nga ecuria e përgjithshme e ekonomisë së qytetit të Obiliqit.

Krijimi i një rrjeti të hapësirave të gjelbra dhe të hapura


Plani parashe zhvillimin e një rrjeti të integruar hapësirë të hapur që i referohet gjithë qytetin. Hapësira e gjelbër në shkallë të gjerë të qytetit, të krijojë një entitet të vazhdueshëm fizik dhe mjedisore. Plani synon të maksimizoj qasje në shkallë të gjerë hapësirave të gjelbra, duke siguruar një koleksion të korridoreve të gjelbra dhe promovimin e biçikletave dhe këmbësorëve zonave. Për më tepër, hapësira nivel lagjeje të hapura do të duhet të rehabilitohet si kopshte xhep, në zonat e banimit të periferi të qytetit dhe në komplekset e banimit kolektive të banimit. Plani mbron kanaleve të ujit që ekzistojnë sot në periferi të qytetit. Pas zgjerimit të banimit dhe integrimin e zonave tjera të qytetit, këto kanale mund të zhvillohet në hapësira të gjelbra lineare dhe zonat rekreative që do të lidhin lagjet dhe dukshëm të përmirësuar imazhin dhe mikroklimë e zons së banimit dhe pritjet do të jenë rigjenerimi i mjedisi urban dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe mikroklimës urbane.

Ndikimi i HZK-së në Ekosistemet Natyrore

Në disa zhvillime të cilat janë planifikuar ka disa ndikime të cilat janë të kthyeshme dhe të riparueshme. Në HZK janë propozuar masa kundër zhurmës dhe masa kundër ndotjes në pjesët ku ndjeshmëria në ekosisteme është e lartë. Ekosistemet ku atakohen janë ekosisteme pyjore në disa korie (zabele) dhe në disa pjesë ekosisteme lumore në të cilat hudhen ujrat e termoelektranave dhe ujrat tjera ndikimi është shumë i madh në gjitha populacionet të cilat jetojnë në ekosistemet lumore. Ndërkaq HZK parashe edhe projekte të cilat kanë ndikim pozitiv në ekosisteme siç shihen në hartat më posht.



Harta 8. Ndikimi i HZK-së në ekosistemet natyrore



Harta. 9. Parashikimi i ndikimeve të HZK-së në aspektin hapësinor.

Efektet kumulative

VSM-ja nuk do të kufizohet vetëm në analizën e elementeve individuale të planit, por duhet të bëjë gjithashtu edhe një vlerësim të përgjithshëm në vazhden e të gjitha aktiviteteve dhe politikave të cilat përfshihen në Hartën Zonale Komunale të Obiliqit.

Komponentët mjedisore	Elementet e HZK-së						Vlerësimi i efekteve kumulative
	Vendosja e filtrave në Termocentralet dhe rehabilitimi i deponive të hirit	Brezat mbrojtës për Autoudha Rrugët e planifikuara dhe Hekurudha ekzistuese	Kushtet zhvillimoe dhe masat e zonave të planifikuara të ndërtimeve	Precizimi i Zonave ekonomike dhe Industrial dhe Kushtet dhe masat	Masat për tampon zona dhe masa tjera natyrore dhe teknike kunder ndotjes	Pyllëzimi	
Shëndeti i popullatës njerzore	+	0	+	0	0	+	Pozitive
Burimet natyrore dhe Ekosistemet	0	-	+	0	+	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Toka	+	0	+	-	+	+	Pozitive
Uji	+	0	-	0	+	+	Pozitive
Ajri	+	-	0	0	+	+	Pozitive
Biodiversiteti	0	-	0	0	+	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Faktorët klimatik	+	0	0	0	0	+	Pa ndonjë efekt domethënës

Tabela 7. Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të HZK-së në komponentët mjedisore.

Në këtë Raport ndikimet mjedisore kumulativ përcaktohen si një kombinim i ndikimeve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit. Gjatë implementimit të zhvillimeve të planifikuara të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit. Kur vlerësohen impaktet mbi token, ajrin dhe faktorët klimatikë, biodiversitetit impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- ajrin, shkarkimet e ndotësve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- burimet natyrore si burimet ujore, minerale dhe resurseve tjera të cilat kombinohen;
- token, zona toke bujqësore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integritetit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen si efekte;

- faktorët klimatik, shkarkimet e gazeve serrë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatik, impaktet kumulative si shumë e impakteve të gjithë veprimeve të PZHK-së janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore:

- shkarkimet limiteve të ndotësve
- menaxhimin e mbetjeve inerte dhe
- sasia vjetore më e lartë e shkarkimit të gazeve serre.

Në vlerësimin e impakteve mbi ujin, natyrën, trashëgiminë kulturore dhe peizazhin, efekteve kumulative zakonisht nuk mund të shprehën si një shumë e impakteve të gjithë veprimeve për të arritur synimet e HZK-së. Kur vlerësohen efektet kumulative në aspektet e përmendura me sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në efektet kumulative janë shumë të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe ne distance) dhe kohës (afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjate, përkohësisht dhe permanent) të efekteve.

Nëse vlerësohen efektet mbi shëndetin njerëzor, efekti komulativ të HZK-së shprehen si efekte të kombinuara komulative dhe zakonisht referohen për:

- zvogëlimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të bezdisjes akustike;
- zvogëlimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis; dhe
- masat e marra në HZK që lehtësojnë veprimtari çlodhëse dhe rekreative në një mjedis.

Kur vlerësohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të HZK-së shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për të arritur synimet e HZK-së janë positive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse efektet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë. Në vlerësimin e efekteve komulative në Biodiversitet të llojeve organike në zhvillimet e planifikuara shprehën si efekte të kombinuara duke rritur impaktin në biodiversitet, mirëpo me masat që janë marr me HZK efekti do të jetë më i zbutur deri te efekti pozitiv për biodiversitetin.

Probleme të Mjedisit në Obiliq dhe Përgjigja që Jepet përmes Kushtet dhe Masat me HZK-së

Tabela e mëposhtme bënë një përmbledhje të problemeve mjedisore që u identifikuan në Kapitullin 6 dhe të shkallës në të cilën HZK-ja i u përgjigjet atyre, duke sugjeruar njëkohësisht edhe masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

Tabela 8. Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas HZK-së

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja me HZK	Propozimet e HZK-së 2023-2031	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
1. Cilësi e ajrit.	Aktiviteti industrial nga i prodhimit të energjise elektrike nga TC e KEK-ut, aktiviteti ndërtimor i pakontrolluar; Deponit e hirit erozioni nga ererat ne keto deponi, Rrugë të ndërtuara pa kriteret; Rritja e shpejtë e numrit të automjeteve; Karburante të cilësisë jo të mirë; Ngrohjet individuale dhe me lënd djegëse të pa kontrolluar nga autoritetet mjedisore komunale.	Të gjitha shkaqet e përmendura e ulin cilësinë e ajrit edhe pse kjo komunë vazhdimisht bën përpjekje për ta rritur findin e gjelbërt dhe membulesë vegjetative poashtu është e pasur me lumenj.	Sëmundjet e organeve respiratore të evidentuara në QKUK dhe në spitalet rajonale të Kosovës për grup-moshat mbi 18-vjet është rreth 14.26 %, ndërsa në Obiliq me rrethinë është rreth 30 %, poashtu edhe me sëmundjet tjera kardiovaskulare.	Do të vazhdojë të përkeqësohet me rritjen e aktivitetit industrial, me rritjen e numrit të automjeteve. Mundet vetëm të ngadalësohet. Mund të balancohet vetëm nëpërmjet masave për filtrimin e ndotësve në TC dhe nga metalet e rënda.	Vendosja e filtrave në tymtaret e TC-ve, ropozimet për kontroll të cilësisë së ajrit, pyllëzim, propozimet për tampon shirita gjelbërues Propozimet për transportin publik dhe çiklizmit ka si qëllim ngadalësimin e rritjes së numrit të makinave private dhe reduktimin e ndotjes së ajrit të disa zonave të komunës. Rrugët e reja të cilat duhet të lehtësojë trafikun nëpër vendbanime.	Duhet merren masa teknike me filtra te ajrit, Duhet të bëhen studime mbi pyllëzimin; Duhet të bëhen studime mbi transportin; Përdorimi i karburanteve më të pastra (përmbajtje e sqfurit të bjerë); Përmirësimet e rrugëve nga Komuna e Obiliqit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës.	Studim për të përcaktuar ndikimin dhe koston e cilësisë së dëmshme të ajrit në shëndetin publik dhe në ekonominë në tërësi; Përmirësimi i teknikave të ndërtimit për të pakësuar ndotjen; Shtrimi i rrugëve, përmirësimi i trafikut edhe futja e korsive të biçikletave; Edukim më i mirë i publikut mbi shëndetin dhe cilësinë e ajrit; Përmirësimi i furnizimit me energji-zbutja e kërkesës nëpërmjet burimeve alternative të energjisë dhe përdorimit të gjeneratorëve; Vendosja e kriterëve strikte për pyllëzimin; Vendosja e kriterëve strikte për cilësinë e zonave të gjelbra (cilësia e mbulesës së tokës, dhe e mbulesës bimore).

<p>2. Cilësi jo e mirë e ujit të lumenjve</p>	<p>Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura industriale dhe fekale dhe mbetjeve industriale që shkaktohet nga mungesa e sistemit të grumbullimit dhe trajtimit adekuat të ujërave të ndotura, prania e lart e fenoleve.</p>	<p>Ndikim në shëndetin e popullatës njerëzore, humbje e florës dhe faunës ne ekosisteme ujore (mikrozoobentosit dhe makrozoobentosit); Ndotja e rezervave të ujërave nëntokësorë.</p>	<p>Ndikon në sëmundjet infektive, sëmundjet tjera të cilat lidhen me përdorim të ujit dhe përmes zinxhirit ushqimor.</p>	<p>Do të përkeqësohet më tej dhe mund t'i kthejë lumenjtë në kanale të hapura fekale eutrofizim total.</p>	<p>Kushtet zhvillimore dhe masat në HZK në përputhje me studimin e Planit hapësinor të Kosovës. Vendi i identifikuar për impiantin për trajtim të ujërave të ndotura për regjion të Prishtinës është në përputhje me Planit hapësinor të Kosovës pjesa e trajtimit të ujërave të ndotura. Trajtimi i përkohshëm dhe sipas zonave i ujërave të ndotura.</p>	<p>Përgatitja e Projekteve për Sektoriale për Trajtimin e ujërave të zeza të Obiliqit dhe ujërave industriale nga zonat industriale e KEK-ut.</p>	<p>Zëvendësimi i tubacioneve të vjetra dhe të vogla që do të shoqërohet edhe me minimizimi i rrjedhjeve. Maksimizimi i lidhjeve. Rregullimi i lidhjeve të paligjshme. Reduktimi i përdorimit të gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve për ujërat e ndotura, lidhja me kolektorin kryesor të fshatrave dhe ndërtimi i impiantit të planifikuar.</p>
<p>3. Cilësi dhe sasi jo e kënaqshme e ujit të pijshëm</p>	<p>Humbje në sistem të furnizimit, tubat jo të cilësisë së duhur dhe mungesa e kontrollit të ujërave, mungesa e ujëmatësve</p>	<p>Ndotja e ujërave nëntokësore dhe atyre sipërfaqësor</p>	<p>Shpërthim i sëmundjeve gastro-enterike, por lidhja e qartë nuk është provuar nga të dhënat shëndetësore.</p>	<p>Do të përkeqësohet me rritjen e përmasave të disa vendbanimeve dhe të kërkesave. Është i nevojshëm zhvillimi i</p>	<p>Kushtet zhvillimore dhe masat në HZK përputhet me studimet më të mëhershme për cilësinë dhe sasinë; Në HZK janë parashikuar edhe përfshirja e infrastrukturës për shkak të</p>	<p>Duhet përgatiten projektet Sektoriale përkatës dhe trajtohet mundësia e financimit.</p>	<p>Zvogëlimi i humbjeve në rrjet. Shmangia e intersektimeve me linjat e ujërave te zeza. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme. Përgatitja e projekteve për të shkuar drejt furnizimit të vazhdueshëm me ujë; Mbrojtja e burimeve mbi sipërfaqe, eliminimi i shfrytëzuesve individual të</p>

				burimeve të reja. Një ndikim i kthyeshëm nëse merren masat e duhura.	interferencave që ka.		burimeve ujore.
4. Mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave	Mungesa e një sistemi reduktim-ripërdorim-riciklim për mbetjet e ngurta në nivel të Komunës së Obiliqit ; Grumbullimi i mbetjeve në komunë nuk është plotësisht i rregulluar pasi shumë prej tyre hidhen në lumenj dhe zona të tjera. Nëse vazhdohet me këto ritme, Obiliqi do të ketë disa deponi ilegal brenda viteve të ardhshme. Mbetjet ndërtime, dhe ato të tjera përzhien me mbetjet komunale.	Komuna gjeneron sasi të konsiderueshme të mbetjesh të ngurta. Por edhe mbetje industriale. Në disa vendbanime të Obiliqit pamjet e mbeturinave mbeten të shëmtuara. Në komuna, sidomos në shtretërit e lumenjve dhe përroskave. Këto mbeturina mund të jene burim sëmudjesh veçanërisht në	Djegia e mbeturinave shton ndotjen e ajrit. Personat që jetojnë pranë këtyre deponive dhe herë pas here kontrollojnë mbetjet janë të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze për shëndetin. Rrezik potencial nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme në	Sasia e mbetjeve do të rritet njëherazi me zhvillimet e reja; Duhet përmirësuar mbledhja e mbeturinave në komuna. Rreziku se mund të ketë rritje të hedhjes së paligjshme të mbeturinave; Disa pika grumbullimi të përkohshëm ende nuk janë organizuar.	HZK sugjeron adoptimin e një sistemi të integruar të administrimit të mbetjeve të ngurta, bazuar në itinerarin reduktim-riciklim-rikuperim. HZK propozon zhvillim të largimit dhe rehabilitimin e deponive të hirit por edhe fuqizim të deponisë së mbeturinave në të cilat mbeturinat do të grumbullohen dhe selektohen dhe do të bëhen të	Duhet përgatitet Projekti Sektorial përkatës me mundësi financimi; Për pikat e grumbullimit të përkohshëm të mbetjeve. Ky projekt sektorial do të eksplorojë opsione të ndryshme të trajtimit dhe deponi të përkohshme dhe transportit	Grumbullim më i mirë në vendbanime dhe nivel komunal. Vënie në jetë e strategjive për reduktimin e mbetjeve dhe për riciklimin. Ndarje më e mirë e materialeve të rrezikshme. Për të shmangur hedhjet e paligjshme, organizimi mund të bëhet nga komuna për një numër të mjaftueshëm kamionësh, dhe të menaxhohet me transport nga deponia e përkohshme drejt asaj regjionale njëjtë të menaxhohet me pagesë për tone për hedhjen e mbeturinave në Deponin e

	<p>Problem në vete janë Hot-spotet mjedisore si Deponit e hirit të KEK-ut, deponia e mbeturinave në Mirash</p>	<p>stinën e nxehtë. Poashtu kjo ndotje ndikon edhe në ndotjen e gjithë zinxhirit ushqimor në Obiliq</p>	<p>zona afër dhe në disa raste edhe brenda vendbanimeve të komunës së Obiliq.</p>		<p>gatshme për deponim për ato që deponohen kurse tjerat do të riciklohen.</p>	<p>drejtë deponisë regjionale.</p>	<p>regjionale duke krijuar sistem pagesash nga ata që hudhin mbeturina. Zbatimi i projekteve për pika grumbullimi në sistemin e stacioneve të transferit .</p>
--	--	---	---	--	--	------------------------------------	--

<p>5. Rehabilitimi /Inkapsulim i pikave te nxehta te ndotjes</p>	<p>Aktiviteti i KEK-ut Deponitë e hirit të Termocentralit Kosova A ndodhen në afërsi të fshatit Mirash, pastaj si pik e nxehtë në Komunën e Obiliqit konsiderohet të jetë edhe deponia e mbeturinave në Mirash ku mbeturinat në këtë deponi sillen edhe nga disa komuna tjera dhe se kto mbeturina shkaktojn ndotje</p>	<p>Ndotja e tokës dhe ajrit nga përbërje të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe biodiversitet</p>	<p>Në vartësi të lendeve ndotëse, mund të shkaktojnë një game të gjerë sëmundjesh</p>	<p>Mund përkeqësohet edhe më tepër nëse vazhdon prania e deponive te hirit dhe sanitare ne Mirash. Aktivitetet njerëzore dhe ekonomike kanë bere qe në shumë vende të ketë deponi të egra të cilat nëse nuk eliminohen dhe rehabilitohen do te kenë pasoja për shëndetin publik.</p>	<p>Propozohet të studiohen të gjitha hapësirat, zonat me rrethinë ku janë zhvilluar industritë të vogla ose edhe sot ku pjesërisht funksionojnë në territorin e komunës së Obiliqit që kanë përdorur ose gjeneruar kimikate të rrezikshme për shëndetin, para, gjatë edhe pas viteve 90-ta dhe mbi bazën e shkalles se rrezikut të behën ndërhyrja teknike</p>	<p>Te mblidhet informacione më të thelluara për këtë gjendje, për nivelin dhe llojin e ndotjes, për ndikimet në tokë, ujë ajër ekzistencën e lidhjeve të territoreve te ndotura me kërcënimet për shëndetin, llojin e kërcënimit të bëhen analiza ne terren dhe laborator</p>	<p>Plani i menaxhimit dhe rehabilitimit të pikave të nxehta bazuar edhe në studim, analizë dhe VNM të detajuar; Masat adekuate për shëndetin e njerëzve; Masat tjera për konsolidim të tokës, mbrojtje të ujit dhe cilësisë së ajrit dhe Biodiversitetit dhe ekosistemeve tjera.</p>
---	---	---	---	--	--	---	--

<p>6. Shtrirja e ndërtimeve</p>	<p>Nevojat për banim; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar brenda dhe rreth vendbanimeve sidomos nëpër terrene me tokë të pëlleshme bujqësore sidomos në tokën me komasacion dhe ato kodrinore.</p>	<p>Humbje e tokës së pëlleshme dhe gjelbërimit e pemëve të ndryshme, humbje e shtresës së sipërme të tokës, rrjedhje dhe mundësi për rrëshqitje/ përmbytje. Humbje e vlerave estetike. Humbje e vlerave peizazhistike të territorit komunal.</p>	<p>Jo i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm; Por shtrirja pa përcjellë me infrastrukturë normal që shkakton edhe pasoja në shëndet; Edhe rrëshqitjet e mundshme të tokës dhe përmbytjet mund të shkaktojnë dëme serioze për jetën dhe pronën. Edhe humbja e gjelbërimit ka ndikimin e vetë në shëndetin e njeriut</p>	<p>Do të vazhdojë të zhvillohet me këto trende shkon në drejtim të përkeqësimit dhe do të jetë e pakthyeshme?</p>	<p>Planifikohet kufiri ndërtimor për të gjitha vendbanimet; Standardet dhe normat e planifikimit të përdorura në HZK bëhen automatikisht të vlefshme; Për të gjitha vendbanimet në Komunë. Parqe, zona të gjelbra dhe tampon zona për rreth TC-ve dhe zonave me nen ndikim te ndotjes nga TC-të të disa vendbanimeve</p>	<p>HZK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor rreth vendbanimeve statusin e zonave ku nuk lejohet ndërtimi; HZK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të ndërtimit të marrin statusin e parkut, zonës së gjelbër dhe tampon zonës</p>	<p>Të përgatitet ekipi dhe një plan i Menaxhimit të ndërtimeve; Të përgatiten projekte për gjelbërim, parqe dhe tampon zona. Moratoriumi për ndërtimet duhet të shtrihet edhe në gjitha zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor. Është e nevojshme të hartohen plane rregulluese edhe për vendbanimet në konceptin e zhvillimit policentrik.</p>
--	---	--	---	---	--	---	--

<p>7. Degradimi i pyjeve,</p>	<p>Prerja e pakontrolluar dhe ilegale e pyjeve; Djegiet e pyjeve; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i disa vendbanimeve.</p>	<p>Ndotja e ajrit; Ndotje e ujit, mungesë e atraksioneve pyjore si për rezidentët ashtu edhe për vizitorët. Erozioni në shkallë të lart dhe prishjen e balancit natyror.</p>	<p>Ndotja e ajrit edhe e ujit kanë ndikim dhe pasoja në shëndet;</p>	<p>Do të vazhdojë me degradimin e mëtejshëm i pyjeve; Të ketë ndotje; Humbje të habitateve dhe ekosistemeve të rëndësishme për komunën dhe për Kosovën</p>	<p>Revitalizimi i pyjeve ekzistuese; Propozohen mbulim me fidanë të reja sipërfaqet e zhveshura; Dhe parqe tjera të reja në disa vendbanime. Gjellbërim dhe tampon zona gjellbëruese.</p>	<p>Projekte konkrete pyllëzimi, revitalizimi, sanimi për pyjet e Obiliqit në zonat e parapara me HZK.</p>	<p>Ngritja e një mekanizmi bashkëpunues në nivel të komunës dhe ministrive për këto projekte; Kushtëzimi i projekteve të reja të infrastrukturës me gjellbërim dhe tampon zona; Aktivizim i gjykatave, policisë inspektorëve në mënyrë cilësore. Në ish vend depozitimet legale dhe ilegale masat rehabilituese dhe ri gjellbërim ose gjellbërim.</p>
<p>8. Humbje e trashëgimisë së ndërtuar</p>	<p>Zhvillimet me trende të ndryshme nëpër vendbanime nuk janë në harmoni me arkitekturën ekzistuese.</p>	<p>Humbja e disa nga karakteristikat unike të vendbanimeve, cenim i identitetit dhe e kujtesës historike.</p>	<p>Të dhëna të pa disponueshme por aspekti psikologjik dhe shpirtëror mendohet se do jetë prezent.</p>	<p>Do të vazhdojë dhe ndoshta do të përshpejtohet, duke qenë i pakthyeshem.</p>	<p>Identifikon zonat brenda të cilave ju caktohet edhe zona mbrojtëse sipas normave teknike të planifikimit të cilat do të ruhen. Propozon masat për ruajtjen. E orienton presionin për ndërtime drejt vendbanimeve dhe zonave më pak të pasura me këtë lloj trashëgimie</p>	<p>Identifikimi i instrumenteve ekonomike dhe të valorizimit të territorit (psh, itinerare apo shtigje kulturore) që mund të bëhen mbështetje për komunitetet autoktone të Obiliqit që banojnë në këto vendbanime dhe zona.</p>	<p>Përditësimi, zgjerimi dhe mbajtja/pasurimi i listës së monumenteve të kulturës, e cila është përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe institucione tjera qendrore dhe lokale për të mirëmbajtur zonat, ndërtesat që kanë vlerë të trashëgimisë së ndërtuar</p>

9. Rrezik për tërmete, rrëshqitja e tokës, vërshimet dhe element tjerë rreziku	Obiliqi bën pjesë në zonë sizmike aktive të nivelit mesatar; Ka erozion dhe shkarje dheu në Obiliq edhe burime tjera rreziku.	Ndikimet mundë të jenë të mëdha në degradim të tokës dhe humbje të mëdha materiale.	Mund të rezultojë katastrofik	Komuna nuk ka një strategji të menaxhimit të risqeve natyrore ose tjera të shkaktuara	Në kodet e ndërtimit, por nuk specifikon nevojat e ndërsjellta HZK jep edhe masa dhe kushte ne kuadër të zonave mbishtrësore.	Komuna duhet të ndërtojë brenda standardeve të larta anti-sizmike	Studim i terreneve për qëndrueshmëri sizmikenë rast se do të duhet të ndërtohet ndonjë pikë karburanti, duhet pasur parasysh raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit, i cili duhet të ketë standarde shumë të larta.
10. Rreziqe nga Zjarret.	Shkatërrimi i pyjeve, rrezikimi i pasurisë dhe pronës së qytetarëve, ndotja e ajrit.	Shkatërrimi i pasurisë qytetare duke djegur pronën dhe pasurit tjera të paluajtshme.	Rrezikimi i jetës së qytetarëve dhe pasurisë.	Rreziku do të mbetet i njëjtë.	Bënë identifikim të zonave me probabilitet të zjarrndezës dhe krijon kushte që zjarret të menaxhohen më lehtë.	Duhet ndërhyrje bonifikuese në ndërtesat me përmbajtje amianti.	Duhet behën studime të mëtejme mbi shkaqet e zjarrvënës, kohen dhe lokacionet më të atakuara.
11. Rënie e biodiversitetit dhe humbje e florës dhe faunës.	Aktiviteti i KeK-ut dhe Mijet siperfaqësore, rritja e disa vendbanimeve por edhe zhvillimet me karakter ndërtimi po shkaktojnë humbje në pyje dhe habitat. rritje e ndotjes, Zhvillimi i	Nuk njihet plotësisht, por ka probleme të përgjithshme të humbjeve ekologjike. Rënie e efektit zbutës të florës për gjurmën e karbonit në disa zona të	Humbje e zinxhirit ushqimor, Aspekti kulturor, shkencor dhe rekreativ. Ndikim negativ në gjendjen psikologjike të	Do të vazhdojë të përkeqësohet.	Përkufizimi i ndërtimit është propozim i drejtpërdrejtë, dhe ulja e zhvillimit të çrregullt të vendbanimeve do të sjellë edhe uljen e humbjes në biodiversitet.	Projekte të asistuara nga BE, me qëllim fuqizimin e monitorimit të mjedisit në komunë duhet zhvilluar studime të situatës.	Nevoja për të pasur një studim bazë dhe inventarizim për Obiliqin me qëllim identifikimin e humbjeve në biodiversitet dhe mundësitë për përmirësimin e situatës..

	infrastrukturës ndikon drejtpërdrejt.	komunës	banorëve.				
12. Zonat e ndikimit të aktiviteteve në Obiliq	I gjithë territori i komunes dhe gjitha komponentet mjedisore janë nën ndikim të aktivitetit të KEK-ut.	Ndotje e lumenjve dhe tokës.	Nuk dihen në hollësi por nënkuptohen.	Ndotja e ajrit do të shtrihet në një zonë më të madhe me zgjerimin e vendbanimeve dhe përkeqësimin e ndotjes.	HZK, në kuadër të Zonave Mbishtresore i jep kushtet dhe masat por problemet janë të njohura, sidomos rritja vendbanimeve dhe zhvillimet tjera industrial dhe ndërtimore.	Projekte të asistuar nga MMPHI, BE etj për identifikimin e nivelit të ndikimit dhe zonës së veprimit lokal, komunal, kombëtar ose edhe ndërkombëtar	Nevoja për të pasur një studim bazë për Obiliq me qëllim identifikimin e ndikimit të aktiviteteve në zona dhe mundësitë për përmirësimin e situatës

13. Ndotje akustike në Obiliq	Aktiviteti industrial i prodhimit te energjise elektrike nga KEK-u Qarkullimi i dendur dhe kaotik rrugor vlen të ceket me theks rrugët rajonale mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, numri i lartë i automjeteve private për shkak të mos efiçensës së transportit publik, ushtrimi i aktiviteteve argëtuese jashtë standardeve, cilësia e ulët e automjeteve,	Nivel i lartë i zhurmës në vendbanimet ne afersi tge KEKut dhe pran arterieve kryesore rrugore.	Efekte kronike dhe akute në sistemin e dëgjimit, dhe dëmtim i sistemit nervor.	Rritja e vazhdueshme ose mos disiplinim i problematikës.	Krijim i një rrjeti më të disiplinuar dhe më të mirë rrugor; Përmirësim i transportit publik; Krijimi i barrierave me bimësi aty ku është e mundur anës rrugëve si dhe pengesa tjera të përshtatshme.	Edukimi qytetar për mos shkaktimin e ndotjes akustike. Aplikimi ne ndërtesat ekzistuese dhe te reja te materialeve izolues te zhurmave.	Masa të karakterit rregullator për standardet e mjeteve që lëvizin në komunë dhe penaltitetet ndaj shkaktuesve të zhurmave në vendbanimet e Obiliqit .
--------------------------------------	---	---	--	--	---	---	--

MONITORIMI

MONITORIMI

Për të mbajtur nën kontroll zbatimin e dokumenteve zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve është monitorimi. Është shumë me rëndësi raportimi në instancat përgjegjëse nga organet kompetente komunale gjatë zbatimit të dokumenteve të planifikimit dhe dokumenteve tjera. Në Ligjin e “Vlerësimit Strategjik Mjedisor”, kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në fazë të hershme pasojat negative të paparashikuara dhe me qëllim marrjen e masave korrektuese.

E njëjta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktivës së BE-së për VSM-në. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen dublikimet në procesin e monitorimit, mund të përdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPHI-ja nëpërmjet AMMK-së Agjencisë Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës, e cila zbaton monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal .

Me qëllim që HZK-të të zbatohen me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë përcaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe siç e parashtruar edhe me sipër; është kërkesë ligjore, që të monitorohet zbatimi i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

Për të qenë sa më racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre tregueseve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbutëse të HZK-së. Plani Monitorimit përmbledh shumë tregues që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kësaj ndërmarrje kërkon angazhimin e mjaftë institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatës monitoruese nën drejtimin e Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës.

Mbështetur në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Obiliqit ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryen në kuadrin e zbatimit të HZK-së. Këtu përfshihen qoftë Planet, projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i HZK-së në Plane Rregulluese të Hollësishme për vendbanimet policentrike, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Obiliqit edhe pse e ka Drejtorinë për Mbrojtje të Mjedisit poashtu sikur se gjitha komunat e Kosovës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerëzore dhe financiare gjithë këtë veprimtari. Megjithatë ajo, duke angazhuar zyrtar brenda kësaj Drejtorie dhe struktura të tjera në vartësi të saj mund të kryej një pjesë të programit të monitorimit si cilësinë e ndërtimeve, pyllëzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zgjerimit të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, ecurinë ndërtimit të rrugëve të reja përfshirë ato për qarkullimin me biçikleta dhe të tjerë indikatorë që janë paraqitur në programin e monitorimit të HZK-së.

Komuna e Obiliqit rezultatet e monitorimit, sipas ligjit për VSM-n, duhet të publikoj në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjerë të mjedisit duhet të procedohet sipas

ligjeve që mbulojnë fushën VSM, VNM për monitorimin dhe rezultatet ti përcillen komunës së Obiliqit dhe Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor ti publikoj në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

Tabela 9. Monitorimi

Receptoret mjedisor	Objektivat e Mbrojtjes së Mjedisit	Synimi	Indikatori	Raportimi	Institucioni pergjegjes
Shendeti banoreve	Promovimi për krijimin e një komune të qëndrueshëm dhe të shëndetshme	<ol style="list-style-type: none"> 1. Cilësia e ajrit me parametra të BE-së. 2. Cilësia e dheut dhe produkteve bujqësore dhe ushqimore. 3. Cilësia e burimeve të ujit të pijshëm konform stand. të BE ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore destinuar për ujë të pijshëm 4. Cilësia e ujit të pijshëm konform standardit 5. Dendësia e popullsisë e qëndrueshme në vendbanimet me trend të rritjes së popullsisë 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Cilësia e ajrit kundrejt standardit të BE 2. Cilësia e dheut dhe produkteve bujqësore dhe ushqimore kundrejt standardit të BE. 3. Cilësia e burimeve të ujit të pijshëm, kundrejt standardit të BE. 4. Cilësia e ujit të pijshëm në përputhje me standardin 5. Dendësia mesatare për këto vendbanime. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rap. Vjetor 2. Rap. Vjetor 3. Rap. Vjetor 4. Rap. Vjetor 5. Rap. Vjetor 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejt. Mbrojtjes së Mjedisit e Obiliqit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktur. 2. Drejt. Shërbimeve Publike Obiliq 3. Komuna e Obiliqit
Biodiversiteti	Ruajtja e llojeve të cilat janë në rrezik të zhdukjes nga aktiviteti njerëzor	<ol style="list-style-type: none"> 1. ndalimi i gjuetisë së egër 2. marrja e masave për mbledhësit e bimëve mjekuese 3. Rehabilitimi i sipërfaqeve të pyjore në zonat pyjore dhe ato të gjelbra në zonat e banimit 5. Krijimi i korridoreve të gjelbra dhe tampon zonave 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sipërfaqet e reja të krijuara, sip. m² 2. Sipërfaqe të reja, m² 3. Sipërfaqet të rehabilituara, m² 4. Sipërfaqet e kthyera në zone të gjelbër, pjese e korridorit dhe tampon zona; m² 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raportim 1 here vit 2. Raportim 1 here ne vit. 3. Raportim 1 here ne vit 4. Raportim 1 here ne vit 5. Raportim 1 here ne vit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. komuna e Obiliqit dhe MMPHI 2. komuna e Obiliqit dhe MMPHI 3. komuna e Obiliqit dhe MMPHI 4. komuna e Obiliqit dhe MMPHI & MBPZHR 5. komuna e Obiliqit dhe MMPHI & MBPZHR dhe Ministria e Infrastrukturës
Ajri	Përmirësimi i	1. Ulja e niveli të ndotjes së ajrit	1. Arritja e vlerave të	1. Raportim 1	1. AMMK dhe komuna e

	cilësisë së ajrit	për: NO _x ; CO ₂ ; O ₃ , PM10. 2. Rruge te asfaltuara rishtas 3. Ulja e nivelit te zhurmave ne zonat e ndjeshme ndaj zhurmave 4. Aplikimi në banesat e reja i materialeve termizolues dhe mbrojtje akustike	standardit për cilësinë e ajrit lidhur me treguesit mbi norme 2. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara rishtas 3. Respekt i niveleve te lejuara te zhurmës gjatë ditës dhe natës 4. Ulja e niveli të zhurmave në mjediset e banimit	here ne 6 muaj 2. Raportim 1 here ne vit 3. Raportim 1 here ne 6 muaj 4. Raportim 1 here ne vit	Obiliqit 2. Komuna e Obiliqit 3. Komuna e Obiliqit 4. Komuna e Obiliqit
Faktoret klimatik	Kursimi i, energjisë dhe pakësimi i emisioneve te gazeve serre	1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat. 2. Promovimi i paneleve diellor për gjenerim energjie në ndërtesat rezidenciale dhe sociale dhe energjia e krijuar nga era	1. Sipërfaqja e objekteve (m ²) me izolim adekuat 2. Sipërfaqja (m ²)e paneleve te instaluar dhe sipërfaqja e ngrohur nga energjia e erës (m ²)	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. Komuna e Obiliqit 2. Komuna e Obiliqit
Uji	Cilësia e ujërave sip.në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivës të BE-së për ujin.	1. Shmangia e shkarkimeve te ujërave te ndotura ne Lumenj 2. Sigurimi i mos hedhjeve të mbeturinave në lumenj. me qellim ruajtën e niveleve minimal të ndotjes	1a. Vëllimi i ujërave qe shkarkohen ne Lumenj; 1b. Vëllimi i ujërave mbi normat e lejuara qe shkarkohen në Lumenj; m3. 2. Sipërfaqja e ndotjes (m ²) vëllimi i mbeturinave (kg ose m ³) ,lloji mbeturinave shkruhet emir i saktë i mbeturinave të forta të gjetura në shtrat të lumit	1. Dy here ne vit 2. Dy here ne vit	1. Komuna e Obiliqit , AMMK. 2. Komuna e Obiliqit dhe AKMM
Menagjimi i mbeturinave	3) Pakësimi i sasisë se mbetjeve dhe menaxhimi qëndrueshëm i	a.1. Pakësimi në burim dhe riciklimi i mbetjeve a.2. Vendosja e sistemit me disa kontejnerë për ndarjen ne burim te	a.1. Sasia e mbetjeve urbane/person/vit dhe sasia(ton) e mbetjeve te ricikluara.	a.1. 1 here ne vit a.2. 1 here ne vit b.1. 1 here ne vit	a.1. Komuna e Obiliqit , kompania regionale e mbeturinave dhe MMPHI gjegjësisht AKMM

	tyre b) Shndërrimi i pikave te nxehta mjedisore ne sipërfaqe te gjelbra/parqe ose zona rezidenciale	mbetjeve urbane b.1. Rehabilitim/inkapsulimi i pikave te nxehta ne territoret te mbyllura	a.2. Numri i rezidentëve që mbuloohen nga shërbimi me kontejner b.1. m ² te rehabilituara ose inkapsuluara		a.2 Komuna e Obiliqit , kompania regionale e mbeturinave dhe MMPHI gjegjesisht AKMM b.1. Komuna e Obiliqit , kompania regionale e mbeturinave dhe MMPHI gjegjesisht AKMM
Rruget dhe Transporti	Reduktimi i intensitetit te trafikut nëpërmjet promovimit te transportit publik, qarkullimi me biçikleta ku mundet me ndodhë	1. Zgjerimi i rrjetit rrugor për trafikun publik 2. Zgjerimi i rrjetit te korsive për biçikleta 3. Ndërtimi i rrugëve të reja me hapësira të përshtatshme trotuaresh (përfshirë korsitë e biçikletave). Zgjerimi i trotuareve gjate rehabilitimit te rrugëve ekzistuese. 4. Rehabilitim/asfaltimi i rrugëve lokale	1. Km rruge shtese qe mbuloohen nga trafiku urban. 2. Km korsitë shtese për lëvizje me biçikleta. Numri i biçikletave në qarkullim. 3. Km rrugë te reja dhe të rehabilituara. m ² trotuare dhe korsitë biçikletash te shtuara. 4. Km rruge lokale te rehabilituara ose/dhe asfaltuara	1.1 here ne vit 2. 1 here ne vit 3. 1 here ne vit 4. 1 here ne vit	1. Komuna e Obiliqit, MMPHI 2. Komuna e Obiliqit . 3. komuna e Obiliqit dhe MMPHI 4. komuna e Obiliqit .
Trashëgimia kulturore	Shtimi dhe mbrojtja e vlerave te kulturore, përfshirë ato arkeologjike dhe arkitekturore	Rehabilitimi, mirëmbajta dhe ruajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore	1. Numri i objekteve/ndërtesave me status mbrojtës 2. Numri i objekteve/ndërtesave te restauruara	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. Komuna e Obiliqit Instituti për mbrojtjen e Monumenteve 2. Komuna e Obiliqit Instituti për mbrojtjen e Monumenteve
Trashëgimia natyrore dhe zonat e mbrojtura	Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë natyrore, llojeve	Promovimin e vlerave natyrore rekreative, turistike dhe shkencore të këtyre zonave dhe rëndësisë së llojeve te cilat janë në "Listën e	Gjetja e formave për sensibilizim dhe kërkime shkencore me te shumta.	1 here ne vit	Komuna e Obiliqit , Ministria e MMPHI dhe instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës

	të cilat janë në "Listën e Kuqe" të Evropës	Kuqe".			
Peizazhi, pyjet dhe toka	<ol style="list-style-type: none"> 1. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik 2. Mbrojtja e mjedisit natyror ne hapësirat për rreth vendbanimeve 3. Ripërdorimi i tokave te ndotura 4. Mirmbajtje dhe zhvillim i pyjeve 5. Kultivim i pyjeve të reja 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shtimi i hapësirave të reja dhe nëmurit të pemëve e shkurreve. 2. Dhënie e statusi mbrojtje dhe hartimi i një plani menaxhimi mjedisor i këtyre hapësirave. 3. Rehabilitimi i tokave te ndotura(pikat e nxehta mjedisore) dhe vënia në efciensë për zona të gjelbëra/parqe ose rezidenciale 4. Zhvillimi i pyjeve ekzistuese 5. Pyllëzimi I hapësirave të zhveshura 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sipërfaqet ne m2 dhe numri i pemëve të mbjella 2. Progresi i zbatimit te planit 3. Sipërfaqe toke e ndotur e rehabilituar (m²) dhe e vënë në përdorim sipas HZK. 4. Sipërfaqe toke së zhvilluar pyjore (ha) 4. Sipërfaqe e toke së re pyjore (ha) 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Një here ne vit 2. Një here ne vit 3. Një here ne vit 4. Një here ne vit 5. Një here ne vit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Komuna e Obiliqit 2. Komuna e Obiliqit 3. Komuna e Obiliqit 4. Komuna e Obiliqit dhe MBPZHR 5. Komuna e Obiliqit dhe MBPZHR

PËRFUNDIME

Ky dokument është një përshkrim i problemeve mjedisore në komunën e Obiliqit, si dhe sugjerime për zbatimin e Hartës Zonale Komunale (HZK). Problemet kryesore janë ndikimi negativ i aktivitetit të Korporatës Energjetike të Kosovës, keq-menaxhimi i resurseve natyrore dhe hapësirave publike, si dhe prerja e pa kontrolluar e pyjeve. Popullata ka një traditë të kujdesit për mjedisin dhe hortikulturën, por duhen marrë masa për të përmirësuar situatën.

HZK synon rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të komunës së Obiliqit, si dhe zhvillimin e zona të reja banimi dhe shërbimesh të qëndrueshme. Plani synon të ruajë trashëgiminë e ndërtimit dhe të nxitë një peizazh me pamje më të këndshme. Për të përmirësuar mjedisin, parashikohen masat e filtrave në tymtarët e termocentraleve dhe kontributi në mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve.

Hyrja në fuqi e HZK-së do të sjellë përfitime në përdorimin më efikas të tokës dhe synimin për zhvillim të qëndrueshëm. Objektivat strategjike të planit përfshijnë komunën e Obiliqit si një vendbanim të qëndrueshëm dhe shëndetshëm me peizazhe dhe ekosisteme interesante. Planifikimi hapësinor bazohet në parime të përgjithshme të planifikimit të qëndrueshëm dhe përfshin përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.

Gjatë zbatimit të HZK-së duhen marrë parasysh kriteret mjedisore, kulturore, peizazhike, inxhinierike dhe të infrastrukturës. Veprime operative të planifikimit përfshijnë krijimin e projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura, pyllëzimin dhe gjelbërimin e zonave të parapara, përmirësimin e sistemit të transportit, zhvillimin e rrjetit rrugor dhe trajnime të ndryshme për mbrojtjen e vlerave mjedisore.

Rekomandimet që dalin nga VSM-ja për komunën e

1. Studimi për mbulesën vegetative me drunjë të lart stabil dhe të përshtatshëm për tampon zonat e propozuara nga HZK-ja.
2. Studim për rehabilitimin e deponive të hirit të Termocentralit A dhe B të Korporatës Energjetike të Kosovës.
3. Studime mbi gjendjen e biodiversitetit dhe habitatet natyrore në komunën e Obiliqit.
4. Definimi i korridoreve ekologjike gjatë realizimit të rrugëve të planifikuara dhe të ndërtuara, siç është rasti me propozimin e urës kaluese të shtazëve në autostrada.
5. Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave me potencial rrezatimi, valëve elektromagnetike dhe trajtimin e rrezatimit jonizues në zonat e goditura me bomba në luftën e fundit, për të parandaluar ndotjen në komunën e Obiliqit.
6. Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve dhe planifikimi i masave dhe projekteve për trajtimin e erozionit dhe vërshimeve.
7. Definimi i zonave ekonomike duke marrë parasysh impaktin mjedisor dhe hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për to, për të siguruar zhvillim miqësor ndaj mjedisit.
8. Krijimi i një ekipi me përfaqësues nga niveli komunal dhe qendror për të marrë vendime për ndërprerje të prodhimit të energjisë elektrike gjatë kohërave me "qetësi klimatike" dhe përdorimi i energjisë së importuar deri sa të instalohen filtrat e duhura në tymtarët e Termocentraleve.
9. Hartimi i projekteve për pyllëzim dhe ripyllëzim si masë të rëndësishme mjedisore.
10. Projekte për rehabilitim dhe trajtimin e zonave ndotura nga mbeturinat, përfshirë riciklimin dhe caktimin e hapësirave për deponi transite dhe sistemin e grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave.
11. Definimi dhe trajtimi i zonave sipërfaqësore dhe nëntokësore sipas standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujërat.
12. Konservimi i veçorive natyrore si Monumente të Natyrës, duke i trajtuar si objekte të rëndësishme për natyrën.
13. Definimi i peizazheve, parqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe planifikimi i masave për mbrojtjen e tyre.
14. Projekte për ngrohjen kolektive të qytetit të Obiliqit dhe vendbanimeve rurale.
15. Caktimi dhe trajtimi i zonave të zhurmës.
16. Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë, për të siguruar konservimin e biodiversitetit.

Këto rekomandime synojnë të adresojnë problemet mjedisore dhe të ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës së Obiliqit.

LITERATURA

1. Agjencia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit për vitin 2010;
2. Komuna e Obiliqit . 2019 Plani Zhvillimor Komunal;
3. Drafti i fundit i Hartës Zonale Komunale;
4. Plani Lokal i Veprimet në Mjedis 2012/2017 Komuna e Obiliqit
5. Plani Hapësinor për Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”
6. Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2013;
7. Raporti për gjendjen e natyrës 2015-2017;
8. Raport mbi menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë 2018;
9. Raporti i Mbuleshmerisë së Sipërfaqes së Tokës, CLC 2018;
10. Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2017;
11. Ernest A. LoËe (1997-2001) Eco-industrial Park Handbook for Asian Developing Countries;
12. Agenda 21, UN-Habitat (2009). Planning for Sustainable Cities, UN-Habitat. Nairobi, Kenya.
13. Environment, Health and Safety Resource Centre Limited, 2014, Environmental Impact
14. Assessment Study for the Proposed Eastern Industrial Park Njiru area, Nairobi County
15. Parlamenti Evropian/Direktiva e Këshillit SEA. [www dokument] URL: Aktet Ligjore:
<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001L0042:EN:NOT;>
16. Dalal-Clayton, D., Sadler, B. (2005). Vlerësimi Strategjik Mjedisor: libër i të dhënave dhe udhëzues rreth përvojës ndërkombëtare. Earthscan, SHBA
17. Konventa e UNECE Mbi Qasjen në Informacione, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus), 1998. [ËËËdokument] URL: <http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>
18. Ligji i Kosovës mbi Planifikimin Hapësinor. [WWW dokument] URL: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_14_en.pdf
19. Ligji i Kosovës mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor. [WWW dokument] URL: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-230-eng.pdf>
20. Qendra Rajonale Mjedisore për Evropën Qendrore dhe Lindore, REC. (2000). Analiza Strategjike Mjedisore e Kosovës. Zyra e REC në Kosovë, Prishtinë. URL: <http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF>
21. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia mbi Menaxhimin e Mbeturinave 2011-2020). Prishtinë, 2011;
22. The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, REC. (2000). Strategic Environmental Analysis of Kosovo. REC field office in Kosovo, Pristina. <http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF>
23. The UNECE Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (EspooConvention),1991.WWWdocument]RL:http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html
24. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia për Mjedisin 2013-

2022).

Prishtinë, 2013;

25. American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010. Standartet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press.
26. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;
27. Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches;
28. Qendra Rajonale e Mjedisit. REC.